



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 22 SHTATOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22. SEPTEMBRA 2016. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 04/L-168,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015,
7. Emërimi i një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe
10. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo ramzmatranje Nacrt zakona br.05/L-116 o izmeni i dopuni Zakona br.04/L-101 o penzijskim fondovima Kosova, izmenjen i dopunjen Zakonom 04/L-115 i Zakonom 04/L-168,
5. Prvo ramzmatranje Nacrt zakona br.05/L-114 o inspektoratu obrazovanja Republike Kosovo,
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o regulativnom autoritetu za elektronske i poštanske komunikacije za 2015,
7. Imenovanje jednog člana u Komisiji za imovinske zahteve,
8. Formiranje Ad hoc komisije za izbor jednog člana Nezavisne komisije za medije,
9. Formiranje Ad hoc komisije za izbor dva člana borda Radiotelevizije Kosova,
10. Predlog parlamentarnih grupa o zameni članova parlamentarnih komisija.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Para se t'i hap punimet e seancës plenare dëshiroj të ju uroj fillimin e punimeve të Sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

E kemi filluar në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ismajli ka qenë shumë i zëshëm, i kemi respektuar të gjitha procedurat. Faleminderit!

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përparitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2016.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Ndërkohë e ka fjalën Xhevahire Izmaqu, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, le të bëhet gati zonja Besa Gaxherri.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka tri ditë që opinioni i Kosovës është i tronditur me pamjet e rënda të dëbimit të banorëve nga ndërtesat në lagjen "Dardania". Sigurisht që këtij rasti nuk mund t'i qëndrojmë indiferentë as ne si deputetë të këtij Kuvendi.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në mbledhjen e rregullt e shtroi si çështje këtë ngjarje aspak të mirë për sytë tanë, ku ne i prezantuam shqetësimet tona lidhur me rastin dhe si të tilla do t'i shpalos këtu para jush, të nderuar kolegë dhe të respektuar qytetarë të vendit.

Nga informacionet që kemi mbledhur nga të gjitha ato që janë thanë publikisht në medie, nga të gjitha palët e përfshira në këtë rast, rezulton që kemi të bëjmë me një numër të madh të familjeve të vendosura për banim në këto ndërtesa që nga përfundimi i luftës.

Pamundësia për t'u rikthyer në vendbanimet e tyre të shkatërruara nga lufta dhe nevoja emergjente për strehim ka rezultuar fillimisht në vendosjen e tyre në këto prona.

Strehimi, të nderuar kolegë, është e drejtë njerëzore elementare e garantuar me Kushtetutë, si akti më i lartë juridik i një vendi dhe njëkohësisht garantohet edhe me konventa ndërkombëtare, të cilat Kosova i ka pranuar si të drejta të aplikueshme në kuadër të rendit të saj juridik.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke mos dashur të paragjykoj, e as që kjo fjalë e imja të interpretohet si presion mbi sistemin tonë gjyqësor nga forma si është bërë dhe koha kur është ndërmarrë aksioni, si deputete e këtij Kuvendi kam një varg dilemash sa i takon vendosjes së ligjshmërisë për rastin në fjalë.

Së pari, zbatimi i vendimit të gjykatës për dëbim kolektiv erdhi në kohë shumë të papërshtatshme për banorët, meqenëse tash kemi hyrë në kohë të ftoftë dhe jemi në prag të dimrit.

Së dyti, një numër i madh i fëmijëve, banorë të atyre objekteve, tashmë e kanë filluar procesi mësimorë. Nxjerrja jashtë objekteve të banimit do t'i linte këta fëmijë edhe pa mundësinë e vijimit normal të mësimi.

Së treti, ngase është thënë publikisht, banorët e këtyre ndërtesave tashmë i kanë bërë një shkresë Gjykatës Kushtetuese sa i takon pezullimit të vendimit paraprak të gjykatës në fjalë dhe ende pa e marrë një mendim nga Gjykata Kushtetuese ka vijuar aksioni.

Në këtë logjikë shtrohet një pyetje tjetër: Pse ky vendim i gjykatës, i marrë në vitet 2008-2009, zbatohet tash në vitin 2016?

Në ndërkohë, institucionet ndërkombëtare kanë kërkuar gjithashtu zgjidhjen e domosdoshme të këtij problemi.

Si rrjedhojë, Komuna e Prishtinës gjatë gjithë kësaj periudhe kohore, në vend që të gjejë një zgjidhje të pranueshme për të gjithë, duke e legjitimuar të drejtën e shfrytëzimit të pronës me afat të caktuar, apo sigurimin e strehimit në vendbanim tjetër për banorët e asaj ndërtese, të drejta këto qytetare që burojnë nga ligji dhe detyrimet e pushtetit lokal, e kanë gjetur mënyrën e zgjidhjes së kësaj problematike duke na vënë të gjithëve në pozicione aspak të lakmueshme dhe mbi të gjitha duke u vënë banorët një situatë që, siç e pamë, mund të rezultojë edhe me fatalitet për secilin prej tyre.

Gjatë gjithë kësaj kohe, Komuna e Prishtinës qëndroi indiferente dhe veshëshurdhër, duke i injoruar kërkesat e banorëve dhe duke i akuzuar ata si uzurpatorë, pa dashur asnjëherë ta kuptojë gjendjen e vërtetë të tyre. Fundja, para se ne si organi më i lartë përfaqësues i Kosovës të merremi me këtë çështje, një gjë të tillë do të duhej ta bënte Komuna e Prishtinës, sepse mbi të gjitha ky është problem komunal.

Në papërgjegjësi të plotë, Komuna e Prishtinës provoi të nxirrte pra njerëz në rrugë dhe këtu edhe lind pyetja, kush do t'i strehonte më tutje ata banorë? Komuna apo Kuvendi i Kosovës, që doli të jetë adresa e fundit e këtyre banorëve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Komuna e Prishtinës dhe institucionet tjera përkatëse ligjërisht janë të detyruara që problemet pranë oborrit të tyre t'i zgjedhin vetë. Kjo mbi të gjitha buron nga detyrimet që u dalin si të zgjedhur të qytetarëve të vet.

Natyrisht, sot nuk jam këtu t'i numëroj të metat e qeverisjes komunale të Prishtinës, por për të kërkuar një zgjidhje të favorshme për këta banorë, që siç e pamë ditë më parë, në një moment të vetëm mund të godasin në ndërgjegjen e secilit prej nesh.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në funksion të gjetjes së një zgjidhjes sa më të mirë për banorët qytetarë të Republikës së Kosovës dhe në funksion të vendosjes së ligjshmërisë në përputhje me ligjet në fuqi, ne si Grup Parlamentar i PDK-së rekomandojmë, si në vijim:

Të ndërpritet menjëherë dëbimi i familjeve nga objekti i banimit ku ata janë duke banuar, derisa nuk bëhet kategorizimi dhe identifikimi i secilit rast, duke ndarë rastet sociale, të papunët dhe ata me gjendje të vështirë ekonomike.

E konsiderojmë të rëndësishme, çështje humanitare dhe detyrim ligjor nevojën për shqyrtim të veçantë të rasteve të këtyre familjeve me qëllim të sigurimit të strehimit adekuat në pajtim me ligjet në fuqi.

I rekomandojmë Komunës së Prishtinës, Ndërmarrjes Publike Banesore dhe institucioneve tjera përkatëse, varësisht nga kompetencat e tyre, që me familjarët e këtyre banorëve dhe në kuadër të dispozitave ligjore këtë çështje ta rregullojnë me një marrëveshje,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, në qoftë se ka mundësi, të mos u ndalet fjala deputetëve, do të kishit bërë mirë. Njëqind herë kemi thënë të mos u ndalet asnjëherë.

XHEVAHIRE IZMAKU: ...duke marrë parasysh të drejtën e banimit si e drejtë elementare dhe universale e njeriut.

Ndërsa banorët e këtyre banesave dhe shumë të tjerëve që e kanë problemin e njëjtë, i njoftojmë se Kuvendi i Kosovës është në proces të ndërtimit të një infrastrukture ligjore demokratike dhe në këtë kuadër peticioni i pranuar, pra një kërkesë e nënshkruar nga 10 mijë banorë qytetarë për të bërë ndryshim-plotësimin e ligjit përkatës do të vlerësohet dhe shqyrtohet në ditët në vijim, sigurisht në bashkëpunim me të gjitha grupet parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetët vetë përkufizohen për kohën. Besa Gaxherri e ka fjalën. Ndërkohë ta keni parasysh janë 12 deputetë, në qoftë se dëshironi i lexoj emrat. Mund ta shtojmë kohën në qoftë se seanca pajtohet deri në 45 minuta për t'i përfunduar, por përkufizoni në kohë. Edhe 12 tjerë pas zonjës Gaxherri. Urdhëro, fjala për ju!

BESA GAXHERRI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të pranishëm,

Të nderuar qytetarë,

Ne për çdo ditë po punojmë që ta konsolidojmë shtetin tonë demokratik me kushtetutshmëri, e cila çdo qytetari i ofron barazi dhe siguri, përveç kësaj privilegje unike në botën demokratike për minoritetet e Republikës së Kosovës.

Por, pa dyshim, Kushtetua e vendit tonë ka obligime, të cilat pa dallim duhet t'i respektojë çdo qytetar i Republikës së Kosovës.

Siç e dimë të gjithë, shteti ynë është shtet laik. Feja e objektet fetare janë të ndara nga institucionet dhe objektet arsimore të Republikës së Kosovës.

Reagimi im është në lidhje me të ashtuquajturën Kishë Serbe, e cila është ndërtuar në hapësirat e Universitetit të Republikës së Kosovës në kohën e regjimit të Milosheviqit, kur Kosova ishte nën masat e dhunshme policore dhe ushtarake.

Të gjithë, edhe vetë serbët, të cilët sot janë pjesë të institucioneve të Republikës së Kosovës, e dinë se çfarë qëllimi kishte kjo kishë politike e asaj kohe.

Epoka e aparteidit, e dhunës, e persekutimit deri në gjenocid ka përfunduar.

Pra, serbët e Kosovës e kanë obligim ta respektojnë kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Nuk do të lejohet as kishë e as xhami në oborret e institucione arsimore në Kosovë.

Zoti kryeministër, meqenëse sot nuk qenka këtu, kërkojmë nga ju që t'ia tërhiqni vërejtjen dhe të merrni masa disiplinore ndaj zëvendëskryeministrit Branimir Stojanoviq, i cili duke e shkelur Kushtetutën dhe ligjet e këtij vendi kishte marrë iniciativë që ta përgatisë këtë kishë gjoja për ta hapur, për ta provokuar situatën politike në vend.

Zoti Stojanoviq, me këto gjëra të cilat na kthejnë mbrapa kujtesën e hidhur e të trishtuar, nuk ka lojëra. Ne jemi pajtuar që të ecim përpara, por të kaluarën asnjëherë nuk do ta harrojmë. Askush të mos provojë të na provokojë dhe të na i prekë plagët që na i shkaktuat, e që ende janë të hapura.

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Po ju drejtohem juve, duke ju lutur që të mos bini në provokimet e askujt. Kosova tashmë i ka institucionet e veta, të cilat kanë zgjidhje për çdo problem. Ne këtu jemi zëri dhe vullneti juaj, çdo qytetar i këtij vendi do t'i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për korrektësinë në kohë. Zoti Visar Ymeri e ka fjalën, menjëherë le të përgatitet Pal Lekaj i AAK-së. Tani e kemi 14 veta për diskutim, është mirë të kufizohemi. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", fjalën e ka zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Qytetarë të nderuar të Republikës,

Siç e kemi përcjellë të gjithë në debatin e mbajtur më 3 gusht, në hapësirën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i është dhënë fundi diskutimit profesional faktikisht shkencor për sa i përket marrëveshjes së tradhtisë ndaj shtetit, që është Marrëveshja për demarkimin e kufirit me Malin e Zi.

Ndërkohë që seanca e 1 shtatorit është fundi i kësaj marrëveshje në nivel politik. Tërheqja e Isa Mustafës i pranon në mënyrë implicite dy gjëra, që Marrëveshja për demarkacionin nuk është e mbështetur as shkencërisht as juridikisht, pra që është gabim.

Dhe e dyta, që Marrëveshja për demarkacionin nuk është e pranueshme nga populli i Kosovës, që e bën këtë marrëveshje edhe antipopullore, edhe antidemokratike

Për meqenëse është mbrojtur vazhdimisht nga Mustafa e Thaçi, atëherë kjo tregon se gabimi ka qenë i qëllimshëm dhe i vetëdijshëm, pra cenim i paramenduar i territorit të Republikës. Pra, është krim, vepër penale dhe si e tillë duhet edhe të trajtohet.

Marrëveshja e Thaçit rrezikonte 8 200 hektarë të Republikës së Kosovës në Dukagjin, në vijën kufitare të Kosovës me Malin e Zi. Por, kundërshtimi i përbashkët e dëshmoi që këta 8200 hektarë mbrohen në Prishtinë. Pra, që rreziku i integritetit territorial të vendit vjen nga Ekzekutivi i Kosovës, nga Thaçi e Mustafa.

Para pak më shumë se një vit kishim marrëveshje për demarkacion kur nuk kishim Kuvend, sepse ju kujtohet të gjithëve këtu që marrëveshja ishte nënshkruar kur Kuvendi ishte zyrtarisht në pushim.

Sot kemi Kuvend, por nuk kemi marrëveshje për demarkacion, pra kjo është fitore. Është fitore për Kosovën, sepse republikës iu mbrojt territori.

Dhe kjo fitore vjen falë angazhimit, angazhimit të të gjithëve, pra “Vetëvendosjes” AAK-së, “Nismës”, deputetëve kundërshtues të koalicionit qeverisës, ekspertëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme, por, mbi të gjitha, popullit të Kosovës, qytetarëve të angazhuar në petition e protesta, në aksione e debate. Ishte ky faktori kryesor, sepse ishte kjo pra dëshmia që Thaçi-Mustafa, e ata pak persona tjerë që e mbështetnin këtë marrëveshje janë të vetëm, ndryshe nuk do të zmbropseshin.

Bashkërendimi e ndali këtë marrëveshje. Gjithnjë bashkimi e ndal të keqen, sepse këta uzurpatorë të kriminalizuar dhe të korruptuar janë pak, por të lidhur ngushtë. Largimi i tyre vjen kur shumica bëhet bashkë kundër krimit, kur bëhen bashkë ata që janë kundër krimit, e kundër krimit nënkupton kundër regjimit të krimit, pra kundër këtij regjimi deri në largimin e tij, deri në zhbërjen e kësaj Qeverie dhe kësaj qeverisje me mendje kriminale, e që besa të angazhuar në agresion ndaj territorit dhe ndaj sovranitetit të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Pal Lekaj e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati, në emër Grupit Parlamentar të Listës serbe, zoti Slavko Simiq.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Sot këtu kam dalë para jush, para Qeverisë, që po më duket për çdo ditë e më shumë po zbehet, dhe as këtu nuk po e respekton Parlamentin e Kosovës, që të bisedojë për një temë që është jetike për Kosovën, e që quhet “Trepça”.

“Trepça” nuk është veri apo jug, “Trepça” është e Kosovës. Gjiganti metalurgjik “Trepça” është ende pa status të definuar dhe për këtë shkak po shkon drejt falimentimit. Kjo po ndodh, jo për shkakun se ajo nuk ka mundësi ta mbajë veten, sepse ka edhe për më shumë, ka mundësi ta mbajë Kosovën sikur që ishte në gjendje ta mbante thuajse edhe krejt ish-Jugosllavinë.

Por, falimentimi po rrezikohet nga kjo Qeveri, nga fakti se Qeveria e mëhershme dhe kjo e sotmja nuk e kanë qasjen e duhur në raport me këtë gjigant. Ashtu siç para disa viteve e kishte bërë të qartë Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Uashington se Kosova është shtet sovran dhe se Qeveria e Serbisë nuk ka juridiksion mbi kompleksin e minierave të “Trepçës”, njëjtë do të duhej që edhe ne si Kuvend i Kosovës dhe si Kosovë t’ua bëjmë me dije të gjithëve se “Trepça” i takon Kosovës dhe qytetarëve të saj, e askujt tjetër.

Për të përgjigjemi ne, për të mund të nënshkruajmë kontrata, mund të bëjmë koncesione vetëm ne si Kosovë dhe askush tjetër. Si Grup Parlamentar e ritheksojmë, ashtu siç e kemi thënë edhe më parë, që të sqarohet çështja e aseteve bërthamë të “Trepçës”.

Ekziston një brez i tërë metalogjenik, i cili në qarqet profesionale njihet edhe me emrin “Brezi Metalogjenik i Trepçës”, ku gjenden minierat e xeheve, plumbit dhe zinkut. “Trepça” në Stantërg, Artanë, Hajvali, Badoc, Kishnicë, Bjellobërdë, Cërnac, si dhe vendburimet e pazhvilluara: Zajaç, Muzhiç, Rashan, Tërstenë, Gumnishtë, Kaltrina, Përroi i Ngjyrosur, Çukaj e Batllavës, Shatoricë, Gomillë dhe disa vendburime më të vogla, apo paraqitje mineralogjike që kërkojnë hulumtime gjeologjike të detajuara.

Këto rezerva minerale të rikuperueshme dhe të vlerësuara sillen prej 10-14 miliardë euro, çka do të thotë që një strategji e mirë për zhvillimin e “Trepçës” nënkupton një rregullim të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës nëpërmjet hapjes së vendeve të punës që aq shumë janë premtuar në çdo fushatë zgjedhore. Edhe përkundër faktit se ekziston ky potencial, Qeveria e Kosovës nuk ka mundësuar që sektori i minierave të zhvillohet dhe të shfrytëzohet në dobi të zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik dhe social të Kosovës, por për fat të keq “Trepça” vazhdon të mbetet në udhëkryq, duke mos e pasur një ligj të veçantë për të, që do t’ia jepte epitelin e një ndërmarrjeje publike.

Edhe pse në vitin 2011 është miratuar Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, deri më sot nuk ka pasur asnjë plan të riorganizimit të mirëfillt të “Trepçës”. A na jep kjo të kuptojmë se po përgatitet ndonjë befasi e keqe për këtë pasuri të Kosovës, siç zakonisht ka ditur të na befasojë Qeveria.

Qeveria e Kosovës është e njohur për mosrespektim të rezolutave që i ka nxjerrë ky Kuvend. Të tillë e kemi shembullin edhe me Rezolutën e “Trepçës”, në të cilin, ndër të tjera, është thënë se në afat sa më të shpejtë të sjellë ligj të veçantë për të dhe nga viti 2013, ja ku jemi sot, në të njëjtën gjendje në kuptimin ligjor, por në një situatë shumë më të rënduar për “Trepçën” dhe për punëtorët e saj. Për fund të këtij adresimi ju themi se duhet pasur jashtëzakonisht kujdes

referencat që i specifikojnë konsultimet edhe me komunat veriore për fatin e pasurisë nacionale. Këto referenca mund të jenë pengesa serioze të trajtimit të pasurisë së Kosovës.

Duhet bërë të qartë secilit se pasuria nacionale e Kosovës nuk është pasuri komunale. Ta zëmë, si shembull, kur është koncesionuar Aeroporti nuk është marrë ndonjë aprovim i Komunës së Lipjanit, me sa jemi në dijeni. Atëherë pse duhet pyetur Komuna, kushdo qoftë ajo komunë, për “Trepçën”. Sa i përket falimentimit, Qeveria duhet të gjejë forma të mençura, ristrukturimin e riorganizimin, alternativa e ide ligjore që do të mundësonin pasjen e një fotografie të qartë të secilit skenar të mundshëm dhe një trajtim i veçantë për të zgjedhur njëherë e mirë problemin më kompleks të mundshëm, atë të “Trepçës”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Slavko Simiq e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar, ndërkohë bëhet gati, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, Valdete Bajrami.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani Vladin kabinetu,

Poštovani narodni poslanici, uvaženi građani Kosova!

Ljudska prava kao univerzalna vrednost sistema na kojima je izgrađen savremeni svetski poredak predstavljaju osnovu svakog demokratskog i razvijenog društva. Poštovanja tih prava je obavezna, bez obzira na sve raznolikosti koje postoje u jednom društvu i društvenom uređenju. Odredbe Ustava Kosova koje garantuje pravo slobodu i jednakost svih građana pred zakonom se često zloupotrebljavaju. I pored dobre volje i namere Ustava i njegovih odredbi ta prava se ne poštuju.

Ovo kažem jer postoji puno zabrinjavajućih incidenata koje obeshrabruju i zabrinjavaju, a koji su se dogodile za nepunim mesec dana i upravo nam ti incidenti šalju poruku da se zapitamo da li je Ustav Kosova samo deklarativno karaktera, ili su ustavne odredbe obavezne za sve? Navešću samo neke od primera incidenata koji su se dogodili krajem avgusta i početkom septembra. Ne želeći da govorim o onim incidentima koji su se dogodile prethodnih nekoliko meseci, ja sam o tim incidentima govorio ovde u Skupštini Kosova, i upozoravao sam da se oni mora da se preduprede kako bi se poštovao Ustav Kosova, i kako bi se stvorio jedan ambijent koji pruža bezbednost Srpskoj zajednici.

Naime 28. avgusta dogodili su se protesti i nasilje u Muštištu. Preko 150 Srba koji su se nalazili u tri autobusa bilo je sprečeno da obeleži praznik Velike Gospine na ruševinama porušenog Manastira u tom mestu.

2. septembra spomen ploče ubijenim žrtvenicima u starom gradsku je polomljena, a krst iznad ploče je skinut, pored polomile spomen ploče stradanim Srbima u ovom mestu ispisan je grafit na albanskom jeziku “Osveta!”. Verujte mi da su građani u ovom mestu veoma bili uznemireni nakon ovog incidenta.

9. septembra nepoznate osobe pale gume i karton igranje u nedovršenoj Crkvi Krista Spasa u centru Prištine.

12. septembra Stevan Radić, iz Orahovca, koji ima 72 godine, napadnut je u Orahovcu u svom vinogradu i udaranje tupim predmetom s leđa i ostavljen je da leži bez svesti u svom dvorištu. Napomenuo bi takođe i sinoćni incident koji se dogodio u Gračanici, gde je direktor Vladine kancelarije Republike Srbije bio prinuđen i tražen od njega da napusti Kosovo što zapravo Ministarstvo unutrašnje poslova kosovske policije nije imalo pravo. Taj incident takođe šalje veoma loše poruku pripadnicima Srpske zajednice.

Upravo navedeni incidenti koji predstavljaju samo neke u nizu incidenata uperenih protiv pripadnika Srpske zajednice dovode do toga da se postavlja opravdano pitanje: Da li je Ustav Kosova akt kojim se garantuju ljudska prava?

Sigurno da Ustav Kosova, kao najviši pravni akt, i temeljni akt jednog društva i društvenog uređenja, u kojim su inkorporirane odredbe Evropske konvencije o ljudskim pravima - akta koji predstavlja rezultat razvijenih demokratskih društava, mora i može Srpskoj zajednici da garantuje uživanje osnovnih ljudskih prava.

Potrebna je samo jača rešenost centralnih institucija da ustavne odredbe primenjuje samim tim neophodne i veća angažovanost međunarodnih organizacija kao garantna ljudskih prava. Kao šef Parlamentarne grupe smatram da je neophodno uzeti u obzir preporuke uspostavljanja bezbednosnih mehanizama sadržanih u izveštaju poslaničkog kluba Srpske liste o posetama u opštinama u kojima žive Srbi, gde su nam upravo prilikom tih poseta građani predložili da je suštinski problem bezbednosti i izazovi sa kojima se oni konstantno suočavaju, odnosno nepoštovanja ljudskih prava.

Zato pozivam institucije da se što pre angažuje na izradi akcionog plana na rešavanje bezbednosnih problema sa kojima se suočavaju Srbi, kao što su napadi, plačka, uzurpacija imovine, sknavljenje verskih objekata i sknavljenje spomen ploče i nadgrobnih spomenika. Dakle, zahtevamo jednu efikasniju zaštitu Srpske zajednice od strane svih institucija, i tražimo da se poštuju odredbe Ustava Kosova, jer je očigledno da se one u velikoj meri krše. Takođe želim da napomenem na današnjoj sednici da je za Srpsku zajednicu veoma važno i veoma bitno, preko i preko potrebnog što pre, uspostavljanje Zajednice srpskih opština, kako bi se preko Zajednice srpskih opština još više zaštitila i garantovala prava Srpske zajednice koja živi na Kosovu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, zonja Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”. Ndërkohë, do ta shtyjmë deri në orën 11:00, do të thotë 15 minuta më shumë. Për të tjerët që mbeten, më vjen keq!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pos problemeve të shumta, situatës ekonomike dhe sociale, çështja e mirëqenies të qytetarëve është rënduar së tepërmi, jo vetëm me një vend të caktuar, por në të gjitha regionet e Kosovës.

Shtrohet pyetja pse kemi arritur deri në këtë pikë? Pse nga ardhja juaj në këtë Qeveri për asnjë moment nuk u keni kushtuar kujdes të veçantë çështjeve sociale, mirëqenies ekonomike, e cila

do të mund ta përmirësonte jetën e të gjithë qytetarëve, meqë shumica e tyre jetojnë në varfëri ekstreme. Unë e di këtë, por nuk mund ta them edhe për Qeverinë se ju e dini, se pos këtyre telasheve qytetarët tanë po ballafaqohen edhe me shumë probleme të tjera në jetën e tyre të përditshme, si në aspektin e shëndetësisë, arsimit, në drejtësi, bujqësi, në infrastrukturë, në mirëqenie sociale, e besa së fundmi edhe në siguri.

Secili sektor ka ndërlidhje me tjetrin, pasi po t'u ofrohej një mirëqenie e mirë dhe e sigurt qytetarëve tanë, së paku nuk do ta kishim një numër të madh të vrasjeve, të cilat po ndodhin ditëve të fundit. Vitin e kaluar ju e filluat misionin e largimit të të rinjve nga Kosova, mision për të cilin në fushatë patët premtuar për krijimin e mijëra vendeve të punës dhe ju pastaj talleshit edhe me largimin e tyre, duke thënë se po ikin me Iphone.

Që nga ardhja juaj në pushtet nuk e keni krijuar asnjë perspektivë për të ardhmen e tyre, e për punësim as që po bëhet fjalë për qytetarët tanë, e për njerëzit e PDK-së dhe LDK-së tashmë ajo është e ditur, ndërsa ky vit del të jetë një vit tragjik për të gjithë qytetarët tanë, pasi shumica nga të rinjtë, të cilëve kjo Qeveri do të duhej t'u krijonte kushte për një të ardhme më të mirë, t'u krijonte kushte për punësim, të kujdesej për përforcimin e sistemit të arsimit, ju atyre nuk u dolët në ndihmë, nuk iu ofruat siguri dhe sot kur unë po flas këtu, shumica nga të rinjtë më nuk janë në mesin tonë.

Ju jeni përgjegjës kryesorë për të ardhmen e shoqërisë tonë, e sidomos të gjeneratave të reja. Është shumë e padrejtë kur nga ju, në secilën takim që keni me miqtë ndërkombëtarë, e përmendni rininë si një aset, aset i cili ju nevojitet që të krenoheni me të. Kjo do të kishte kuptim vetëm atëherë kur ju të interesoheni për këtë rini, të cilën asnjë vend i BE-së nuk e ka, e ne e kemi, fatmirësisht, mirëpo fatkeqësisht nuk po mund t'i ofrojmë asgjë të mirë.

Ju e keqpërdorni rininë vetëm e vetëm për interesa personale dhe atëherë kur ju duhet juve ta përmirësoni imazhin tuaj personal. Që nga ardhja juaj në pushtet e deri më tani, nuk keni prezantuar asnjë strategji për t'u ofruar një shkollim të mirëfilltë, punësim, angazhime në profile të ndryshme të të rinjve, me qëllim që ata të kenë me çka të merren, e jo si rrugë të vetme ta kenë dhe ta gjejnë vrasjen e njëri-tjetrit.

Si mund të pranohet ky realitet, kur pjesëtarët e Policisë, të cilët do të duhej të ishin në krye të detyrës dhe në mbrojtjen e qytetarëve, janë të kërcënuar dhe të shantazhuar dhe vijnë deri në atë pikë sa të bëjnë edhe vetëvrasje. Rastin e keni, së fundmi, i cili ndodhi në Pejë. E gjithë kjo situatë është dhuratë nga ky koalicion, i cili që nga fillimi i krijimit të saj, organet e sigurisë dhe të drejtësisë i përdor si vegla.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Vetëm dy muajt më parë janë karakterizuar me vrasje në numër shumë të madh të të rinjve. Në muajin gusht kanë ndodhur 9 vrasje, kurse, sipas Policisë, që nga fillimi i këtij viti deri në korrik në total kanë qenë 15, ndërsa kjo gjendje është alarmante. Kjo është për shqetësim, sepse e gjithë kjo situatë mund të parandalohet vetëm po ta kishit një vullnet të mirë, të investonit në rininë dhe në të ardhmen e këtij shteti.

Ditë më parë pati të shtëna në kryeqytet dhe atë brenda një dite në tri lokacione të ndryshme. Fatmirësisht, nuk pati të lënduar në asnjë rast, mirëpo ka pasur qytetarë të cilët janë atakuar nga këto të shtëna. A nuk është kjo gjendje e jashtëzakonshme? A nuk është kjo në kompetencën e Ministrisë së Brendshme, të organeve të sigurisë, që të garantojnë siguri për të gjithë qytetarët e vendit tanë? A nuk do të duhej që të gjitha institucionet të alarmoheshin se kjo dukuri do t'ia shuajë të ardhmen rinisë sonë?

Situata është alarmante, edhe pse zoti ministër nuk është këtu, derisa ai ndihet komod dhe i qetë, për këtë situatë dikush duhet të japë përgjegjësi, përgjegjësi për këtë situatë të krijuar në vend dhe për pasigurinë me të cilën qytetarët po përballen çdo ditë. Besoj që ju e dini se kush do të duhej të jepte llogari për këtë situatë të rëndë. Ju, së bashku me kolegët tuaj, jeni përgjegjës të vetëm për humbjen e secilës jetë të qytetarëve tanë. Kjo për faktin se keni dështuar të ofroni siguri, keni dështuar të ofroni një të ardhme të sigurt, keni dështuar të ofroni mirëqenie, keni dështuar të ofroni stabilitet ekonomik, keni dështuar të ofroni arsim të mirëfilltë, keni dështuar të ofroni shërbime shëndetësore, keni dështuar të ofroni vende të reja të punës, ndërsa e dimë se pikërisht me këto premtime i keni marrë edhe votat, si LDK dhe PDK.

Keni dështuar të ofroni drejtësi.

Ju do të duhej të ofroni menjëherë dorëheqje, po të kishit pak ndërgjegje dhe moral. Pas atyre vrasjeve që ndodhën vetëm muajin e kaluar, por duke e ditur se me çfarë logjike jeni duke funksionuar dhe kjo është e perealizueshme, sepse mentaliteti i kësaj Qeverie është që njerëzit të cilët vazhdimisht kanë dështuar t'i mbajnë pozitat, bile-bile edhe të ngrihen më tutje. Prandaj, shpresoj që do të vijë koha sa më shpejt që të jepni llogari gjithsecili prej jush dhe të mos kemi lajme të hidhura për jetë të humbura, sepse rinia është e ardhmja e këtij vendi, e jo ju.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Abdyl Ymeri e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati zonja Njomza Emini.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që nga mbajtja e zgjedhjeve e deri më sot, gjatë gjithë kësaj kohe në diskursin publik është përdorur dhe po përdoret një gjuhë denigruese, fyese, e papërshtatshme dhe vulgare, nga udhëheqës të pozitës dhe opozitës.

Diskursi agresiv gjyqësor dhe politik, si dhe gjuha grindavece e përdorur nëpërmjet Facebook-ut, gjuha e tipit të përgjimeve dhe eksponentëve të opozitës me thirrjet “kriminelë”, “dhunues”, “shpirtshitur”, “tradhtarë”, “hajna”, nuk do të duhej të bëhej normë edukate apo trend i ditës për politikanët tanë, sepse kjo në masë të madhe veç sa e polarizon dhe e ndan shoqërinë tonë.

Ky lloj komunikimi, duke përdorur fjalorin e vrazhdë politik, dërgon një mesazh dhe sinjal të keq për shoqërinë në përgjithësi. Është e kuptueshme se për tema të ndryshme mund të ketë edhe divergjenca, polemika dhe mendime të ndryshme, mirëpo kjo nuk do të duhej të na shërbente ne që ta shikojmë njëri tjetrin si armiq, por polemikat dhe mendimet ndryshe duhet të na shërbejnë

si nxitje të debatit dhe konfrontim idesh, në mënyrë që të kemi ide dhe alternativa të qarta dhe kreative, të cilat ofrojnë një rrugëzgjdhje për çështje të caktuara.

Është për shqetësim që Kosovën dhe shoqërinë tonë e ka pllakosur injoranca në vend të dijes, mosdurimi në vend të tolerancës, moskomunikimi në vend të bashkëbisedimit, urrejtja në vend të dashamirësisë, kryeneçësia në vend të urtësisë, dredhiti e shantazhet në vend të guximit për veprim, mosbindja në vend të reflektimit, ndarja në vend të bashkimit, pabarazia në vend të barazisë për të gjithë.

Kosova dhe populli i saj nuk kanë nevojë për politikanë apo opinionistë që e promovojnë një gjuhë të tillë urrejtëse, që në mënyrë të vazhdueshme japin mesazhe që nxisin dhunë, përçarje dhe ndarje në shoqëri. Kosova dhe populli i saj nuk kanë nevojë për një gjuhë të tillë neveritëse, e po ashtu nuk kanë nevojë për skena të dhunës, siç i kemi parë të gjithë këto ditë, që janë zhvilluar para një objekti të kultit fetar në kampusin e Universitetit të Prishtinës dhe skena trishtuese para bllokut të banimit në lagjen “Dardania”.

Kosova sot ka nevojë për njerëz që politikën e kuptojnë si shkencë, si art i së mundshmes, si një profesion fisnik dhe jo si mjet për të arritur qëllimin me metodat më perfide, me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe përfitimit me mjete joligjore. Kosova sot ka nevojë për njerëz që e kanë guximin si vlerë, për të vepruar, që janë kreativë dhe inovativë me sinergji të reja, të cilët japin ide, alternativa dhe opsione për tejkalimin dhe zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen sot qytetarët e Kosovës në të gjitha sferat.

Por, unë e kam një shpresë dhe besim se qytetarët tanë janë të vetëdijshëm, të devotshëm dhe të mençur, sa nuk do të pranojnë diskurse dhe lojëra të tilla, por do të jenë qytetarë të guximshëm për të vepruar dhe punuar në ndërtimin e një shoqërie të ngritur dhe të barabartë për të gjithë, sepse vetëm të bashkuar jemi të fuqishëm në arritjen e aspiratave tona për një Kosovë të ndërtuar dhe të përparuar në të gjitha fushat.

Po e përfundoj fjalimin tim me një thënie popullore, “Fjala është si bleta”, që e ka edhe mjaltin, edhe thumbin. Prandaj, të gjithë ne duhet të jemi të kujdesshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Njomza Emini e ka fjalën. Ndërkohë, nga “Vetëvendosje” janë dy, sot mund ta marrë fjalën njëri. Do t’i lexoj ata që mbeten për herën tjetër. Zonja Aida Dërguti. Pastaj, kështu do të vazhdojmë edhe nga AAK-ja.

NJOMZA EMINI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju përfaqësues të medieve,

Duke qenë se përtej çështjeve politike, që kohën e fundit na kanë mbajtur më të tensionuar, krahas temave me rëndësi thelbësore që duhet t’i diskutojmë dhe t’i përcjellim ngjarjet dhe të arriturat në kuadër të këtyre temave, është edhe sistemi edukativo-arsimor në vendin tonë. Tema për të cilën kam vendosur të flas është më specifike në kuadër të sistemit tonë edukativo-arsimor dhe ka të bëjë me dhunën në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Reagimi ndaj dhunës në kuadër të institucioneve tona edukativo-arsimore, përveçse është detyrim përfaqësues që e kemi në kuadër të rolit tonë si deputetë të Republikës së Kosovës, po ashtu është edhe detyrim moral dhe qytetar me qëllim të parandalimit të këtij fenomeni mjaft shqetësues për nxënësit dhe punëtorët arsimorë në Republikën e Kosovës.

Duke iu referuar raportimit të medieve, sikur e kemi rastin sot të një artikulli që ka nxjerrë gazetarja e “Koha Ditore”, zonja Salihe Gajtani Osmankaq, shohim se si në këtë vit shkollor, që ende nuk i ka as tri javë qysh se ka filluar, kanë ndodhur dy raste të dhunës në shkollat e kryeqytetit. Kjo na vendos në një situatë jo të favorshme sa i përket parandalimit të këtij fenomeni. Sa u përket reagimeve të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në kuadër të dënimit të këtyre akteve, reagimet e kësaj natyre janë evidente dhe shprehin papajtueshmërinë shoqërore ndaj këtyre fenomeneve, por duhet shtruar disa pikëpyetje që po e nxitin këtë fenomen, që të gjejmë terren të përshtatshëm në kuadër të institucioneve tona edukativo-arsimore.

Prania e këtij fenomeni, siç është dhuna në shkolla, shpreh dyshime serioze për zbehjen e rolit edukativ që shkolla duhet ta ketë për nxënësit si mision parësor në funksion të zhvillimit dhe rritjes normale të tyre. Mungesa e rezultateve të prekshme nga këshillat për parandalimin e dhunës në shkolla në parandalimin e këtij fenomeni, si dhe mungesa informative të përditësuar dhe veprimeve konkrete nga ana e Inspektoratit Arsimor na krijojnë përshtypje që ai në këtë rast nuk po arrin t’i realizojë detyrat e veta me përpikëri, në mënyrë që t’i parandalojë këto raste të dhunës që po shfaqen, qoftë ndaj nxënësve, apo në raste të caktuara edhe ndaj punonjësve arsimorë.

Për ne shqetësim duhet të përbëjë edhe dhuna që po shfaqet brenda institucioneve arsimore dhe midis vetë nxënësve. Prandaj, konsideroj se duhet t’i shtojmë përpjekjet bashkërisht si Kuvend dhe Qeveri e Republikës së Kosovës që të nxitim funksionimin e këtyre mekanizmave të nevojshëm, që ky fenomen mjaft shqetësues të parandalohej dhe të mos kultivohet më tutje në mesin e institucioneve tona edukativo arsimore.

Krahas kërkesave për ngritjen e përgjegjshmërisë së Inspektoratit Arsimor duhet që edhe strukturat shtetërore, si Policia e Kosovës dhe Qendra për Punë Sociale, t’i kryejnë përgjegjësitë e tyre dhe të merren seriozisht me rastet me të cilat ballafaqohen sot nxënësit dhe punëtorët arsimorë në disa raste në shkollat tona.

Duke shpresuar që shtatori tjetër të mos na zërë në këtë nivel të dhunës në institucionet edukativo-arsimore, uroj që nxënësit dhe punëtorët arsimorë në muajt në vazhdim të kenë ambient më të sigurt për vijimin e procesit edukativo-arsimor në institucionet përkatëse.

Meqë e kemi të pranishëm edhe ministrin e Arsimit dhe Shkencës e Teknologjisë, unë kërkoj që t’i ndërmarrin masat dhe të mos kemi raste të tilla nëpër shkollat tona në kryeqytet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Aida Dërguti dhe bëhet gati Teuta Haxhiu. Pas “Nismes”, bëhesh gati Zafir dhe pa grup e kemi Gëzim Kelmendin, e pjesën tjetër e lëmë për seancën e radhës. Urdhëroni!

AIDA DËRGUTI: Të nderuar deputetë,

Unë sot nuk pata asnjë gjë për deklarim jashtë rendit të ditës, por u nxita nga ajo që dëgjova këtu - mënyra se si u keqpërdor kjo hapësirë për ta sulmuar Komunën e Prishtinës.

Rreth rastit të banesave të “Dardanisë”, ndoshta sqarimin më të mirë e ka dhënë vetë kryetari i Komunës Shpend Ahmeti nëpërmjet një statusi, që për hir të qytetarëve do ta lexoj prapë këtu.

“Në vitin 1999, shumë njerëz kanë hyrë në banesa të ndryshme në Prishtinë. Kështu ndodhi edhe me banesat e ashtuquajtura të ‘Dardanisë’. Në ish-sistemin politik, BVI-ja, tash Ndërmarrja Publike Banesore, ka ndërtuar banesa për ndërmarrjet shoqërore të ndryshme, nga të cilat kishte marrë nga 8% të banesave si pjesë e kontratës. Lufta i kishte ndërprerë shumë prej këtyre projekteve. Një prej këtyre projekteve ishte edhe ai të ‘Dardania’. Se si janë zaptuar banesat sigurisht se do të kuptohet me kohë. Ka pasur njerëz me shtëpi të djegura, ka pasur të fortë që kanë zaptuar për vete, e u kanë ndarë të tjerëve me para e qira. Por, sikur edhe me shumë banesa të tjera të zaptuara, pas një kohe gjyqet janë marrë me rastet.

Diku në vitin 2005, pra shumë para fillimit të mandatit tonë, Ndërmarrja Publike Banesore i ka paditur palët dhe ka kërkuar lirim të banesave të ‘Dardanisë’ për ta përfunduar projektin dhe për ta dorëzuar pronën te pronarët. Në vitin 2012, gjykata ka vendosur në favor të Ndërmarrjes Publike Banesore në të gjitha shkallët, duke thënë se uzurpimi është uzurpim, pa marrë parasysh rrethanat. Tash, gjykata ka vendosur ta zbatojë vendimin, pra jo Komuna, jo ndonjë instancë tjetër, por gjykata.

Unë jam takuar me banorët e banesave disa herë, para dy vjetësh, para një viti dhe prapë para një muaji. Ua kam thënë të njëjtën gjë, që Komuna nuk mund ta bëjë atë që po e kërkojnë ata. Së pari, ato banesa nuk janë në pronësi të Komunës.

Në rastin më të mirë janë 8% në pronësi të Ndërmarrjes Publike Banesore. Edhe po të ishte pronë, komuna nuk ka të drejtë të privatizojë pronën komunale.

Edhe para dy vjetëve, edhe para një viti u kam thënë, edhe tani po them që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka mundësi që përmes legjislacionit të mundësojë ndonjë zgjidhje, por duke ditur edhe standardet e BE-së, jo sipas asaj çka kërkojnë banorët.

Në takimin e fundit kanë kërkuar nga unë që të thërras gjykatësin pas krejt vendimeve dhe t’i them ta tërheqë apo ta shtyjë vendimin. Unë nuk kam kompetenca të tilla dhe në rastin më të mirë, kjo do të konsiderohej ndikim në gjyqësor.

Komuna e Prishtinës ka obligim t’i ndihmojë me asistencë sociale ata që janë në nevojë dhe u bëj thirrje të gjithë atyre që dëshmojnë se janë raste sociale, sipas ligjeve në fuqi, të lajmërohen në komunë.

Kemi mbi 1 500 familje pa strehim dhe për neve të gjithë janë të barabartë.

Nuk mund të jetë arsyetim që kanë më shumë të drejtë ata që i kanë zënë të parët në vitin 1999.

Shumica e palëve kanë kërkuar t'i blejnë ato banesa. Pra, nuk qenkan raste sociale ata që kanë kërkuar t'i blejnë banesat.

Edhe banesa të 'Rrethi i Flamurit', edhe këtu në 'Dardani' janë çështje të pazgjidhura dhe do të duhej të diskutoheshin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ka uzurpime klasike, ka qira mbi qira, mirëpo ka edhe raste sociale dhe si të tilla nuk mund t'i përgjithësojmë.

Uzurpimin nuk duhet ta legalizojmë, por edhe të rrezikuarit duhet t'i mbrojmë.

E kuptoj shqetësimin e qytetarëve me skenat e djeshme dhe bashkëndjej edhe me banorët e banesave, por duhet të jemi të barabartë në trajtimin e qytetarëve, duhet të kemi ndarje të pushteteve në Kosovë dhe duhet të ndajmë përgjegjësinë sipas kompetencave që kemi.

Pra, është adresë e gabuar Komuna e Prishtinës dhe nëse kaq shumë ju ka prekur rasti, është dashur të ndërhyjnë te ministri i Punëve të Brendshme dhe ai i Drejtësisë, të cilët kanë vendosur për këtë aksion”.

KRYETARI: E nderuar zonjë, as ministri i Brendshëm, as i Drejtësisë... Është Gjykata. Si do që të jetë, gjykatat janë të pavarura, të mos ndërhyjmë! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën. Ndërkohë, të bëhet gati zoti Zafir Berisha e zoti Gëzim Kelmendi dhe pastaj e lexoj listën që do të jetë për seancën e radhës, në pritje.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

Unë kisha një çështje për ta ngritur, por para se të filloj çështjen, kam një reagim ndaj fjalës së shefit të Grupit të Listës serbe, duke i falënderuar zotit Haradinaj, i cili vërtet kishte për ta ngritur këtë çështje, por meqë mua m'u dha rasti, unë ju bëj thirrje juve si deputetë të Parlamentit të Kosovës të ndaleni në kërkimin e privilegjeve si komunitet serb në Kosovë. Mjaft më me këto privilegje.

Banorët e fshatit Mushtisht kërkojnë llogari, kërkojnë dënimin e krimit që ka ndodhur aty. Janë më shumë se dhjetëra familjarë që i kanë të humbur familjarët e tyre në luftën e fundit. Janë shqiptarët në veri, të cilëve nuk u jepet e drejta kurrë për t'u kthyer në pronat e veta. Të gjitha krimet që kanë ndodhur në komunën e Gjakovës duhet të dënohen.

Pra, ju si komunitet duhet të kërkonit që të dënohen këto krime, të dënohen kriminelët që i kanë kryer këto krime, e jo të kërkohen privilegje.

Deri sa të krijohet një klimë e favorshme dhe këta të dënohen, atëherë mund të bisedojnë edhe fshatarët në atë pjesë.

Por, në këtë rast, derisa ka kriminelë që kanë kryer krime, e kanë emër e mbiemër dhe sot nuk dënohen, e ju si komunitet asnjëherë nuk e keni ngritur këtë çështje për të thënë: “Po, duhet të dënohen ata kriminelë që kanë kryer krime në Kosovë”, sepse s'kanë ndodhur krimet në Serbi, por kanë ndodhur në Kosovë - në Republikën e Kosovës, andaj edhe duhet të trajtohen si

qytetarë të barabartë, si të gjithë qytetarët e tjerë. Mjaft më me privilegje skajshmërisht për komunitetin serb, duke i lënë anash komunitetet e tjera.

Çështjen të cilën dua ta ngre sot është furnizimi i nxënësve me tekste mësimore. Konkretisht, ndarja e miliona eurove në këtë vit, sa unë kam informata, janë ndarë rreth 7 milionë euro për t'i furnizuar nxënësit me tekste mësimore.

E kemi mirëpritur ndarjen ose dhënien e teksteve nxënësve qysh në fillim kur është bërë, por sinqerisht është shqetësuese ndarja e miliona eurove dhe konsideroj se ka shumë hapësirë për të bërë biznes në këtë drejtim, ngase, flas me kompetencë - nxënësit e shkollave fillore, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, mund t'i mbushin ato libra, pra mund të mos përdoren vitin që vjen, por jo të gjitha. Kurse, nxënësit e shkollës së mesme të ulët, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, mund t'i përdorin lirisht për vitin që vjen.

Prapë them, çdo vit nxënësit detyrohen që në fund të vitit t'i kthejnë të gjitha tekstet që i kanë pasur gjatë gjithë vitit që u janë dhënë nga Ministria, e në fakt depot nëpër shkolla janë me libra dhe tekstet e njëjta shkojnë prapë, pra të parishikuara.

Unë jam që në Ministrinë e Arsimit, konkretisht në fushën e arsimit të ketë investime shumë më të mëdha, sepse është nevojë urgjente. Në qoftë se investojmë në arsim, investojmë në zhvillimin ekonomik të vendit, por jo për t'u dhënë hapësirë për të bërë biznes.

Prandaj, është nevojë urgjente që kjo të rishikohet dhe të shikohet në përgjithësi në secilën shkollë se sa janë depot e mbushura me libra dhe pse nuk përdoren librat që do të duhej të përdoreshin. Flas për ato që mund të përdoren, sepse mund të jetë një përqindje shumë e vogël e atyre teksteve që mund të dëmtohen gjatë vitit, por jo të tjerat të mbesin, pra në depo.

Pra, është nevojë urgjente të rishikohet edhe mundësia e ndërtimit të shkollave, të cilat janë në ndërtim e sipër dhe nuk kanë përfunduar dhe nxënësit sot mbesin jashtë atyre objekteve, si për shembull, në Mitrovicë e Podujevë, apo janë shumë nxënës të tjerë në komunën e Deçanit, në fshatin Lumëbardh, shkollë e cila nuk i përngjan një objekti shkollor. Në fshatin Ponoshec nxënësit janë në një gjendje të tmerrshme ku i mbajnë mësimet dhe sinqerisht, ministër, është mirë të shkohet e të vizitohet se ku mbajnë mësim nxënësit në fshatin Demjan të Hasit në komunën e Gjakovës. Ai objekt është një histori shumë e dhimbshme për ata fëmijë, sepse vërtet ka një histori të dhimbshme për komunitetin shqiptar atje dhe, mbi të gjitha, nuk i përngjan absolutisht një objekti shkollor ku do të mund të shkojnë fëmijët, e aq më tepër që janë edhe fëmijë parafillore.

Prandaj, edhe një herë, është mirë të shikohet mirë dhe të jenë njerëzit kompetentë për t'i verifikuar se ku shkojnë ato investime dhe thashë një herë e përgjithmonë të përfundojnë investimet e gabuara, të cilat nuk çojnë në ngritjen e cilësisë, për çka jemi zotuar dhe është zotuar ministri që kryefjalën në këtë mandat do ta ketë ngritjen e cilësisë në arsim. Por, në fakt, nuk kemi ngritje të cilësisë, nuk kemi matës të qartë që na tregon se me të vërtetë është ngritur cilësia në arsim kudo dhe në cilindo institucion, qoftë atë fillor, të mesëm apo atë të lartë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën. Le të përgatitet zoti Gëzim Kelmendi.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Meqë Kosova ka më shumë se një vit që përballlet me dy probleme jetike të funksionimit të shtetit dhe shumë çështje të tjera kanë mbetur nën hije, unë do të përqendrohem në diçka që është shumë domethënëse dhe thelbësore për shtetin e Kosovës - mungesën e përgjegjësisë në institucione, mosrespektimin e ligjit, mosdhënies llogari për shkeljen e ligjit dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare. Janë fakte shqetësuese që për çdo ditë përballohet shoqëria jonë.

Miliona euro të buxhetit të Kosovës humbin nga njerëz të papërgjegjshëm, të cilët në kundërshtim me ligjin largojnë shërbyes civilë nga puna, si në qeveritë lokale, ashtu edhe qendrore, në agjenci të pavarura dhe ndërmarrje publike për arsye të bindjeve politike dhe punësojnë militantë partiakë dhe familjarë të tyre, mirëpo nuk llogarisin se me qindra e miliona euro i humbin buxhetit të Kosovës për shkak se gjykatat, në shumicën e rasteve, të larguarit në mënyrë joligjore i kthejnë në punë dhe pastaj për vite të tëra që nuk kanë punuar, obligohen që nga buxheti i Kosovës t'u paguhet.

Këto shkelje janë evidente çdo kund. Por, shqetësuese është papërgjegjësia e njerëzve të caktuar, të cilët në kundërshtim me ligjin bëjnë veprime dhe i kushtojnë buxhetit, sikur që është rasti në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e pasaportave në raport me një ndërmarrje austriake, ose edhe rasti që pritet të ndodhë, për fat të keq, i AKSOS-it.

Këto shqetësime i ngrita, sepse është një moment shumë i rëndësishëm, që ne dalëngadalë vendosmërisht duhet ta respektojmë ligjin e shtetit dhe këto dukuri që lëndojnë shtetin ligjor dhe demokracinë duhet të ndërpriten urgjentisht, përndryshe, nëse vazhdohet kështu, jemi duke e fundosur shtetin dhe perspektivën evropiane të qytetarëve.

Si ka mundësi që një agjenci e caktuar, konkretisht Bordi i RTK-së, për 3-4 vjet rresht, i cili i jep llogari Kuvendit, të mos i miratohet raporti dhe përsëri të njëjti njerëz, i njëjti Bord zgjidhet, rizgjidhet, emërohet dhe riemërohet. Atëherë ne, në njëfarë forme, si Kuvend vetëm i stimulojmë keqpërdoruesit e parasë publike.

Unë mendoj se edhe Kuvendi ka përgjegjësi dhe në këtë drejtim urgjentisht duhet ndryshuar shumë ligje që...

Zoti Beqaj, jam duke folur unë. Faleminderit!

... t'ia kthejmë dinjitetin shtetit dhe institucioneve dhe, në këtë rast, më lejoni ta përmend edhe rastin që lidhet me kryetarin e Kuvendit, të nderuarin Kadri Veseli.

Unë, duke menduar se një ish-zyrtar i Kuvendit të Prizrenit është në burg, dhe kur e pashë dje, ishte në Kuvend. Njerëzit, të cilët janë nën hetime, që kanë rënë ndesh me ligjin, në rast se i mbështesim, atëherë faktikisht ne po stimulojmë keqpërdorimin e shtetit dhe ligjit.

Unë mendoj se ne duhet të jemi shembull, duke u nisur prej kryetarit të Kuvendit, deputetët, zyrtarët e nivelit lokal dhe qendror, që ata të cilët janë në ndjekje përfundimisht të suspendohen

derisa drejtësia ta japë fjalën e vet, përndryshe në rast se ne nuk i bëjmë këto veprime, atëherë faktikisht nuk jemi duke ndërtuar shtetin siç e presin qytetarët.

Është një e vërtetë shumë e madhe, që zoti Ymeri e përmendi, për fjalorin shumë të ashpër që po përdoret shpeshherë edhe në Kuvend. Mirëpo, unë nuk e di se si hajdutit duhet thënë ndryshe. Kur po i themi i korruptuar, po mendoj se është pak but. Hajduti është hajdut, edhe me fjalorin e gjuhës shqipe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar për fjalën e dhënë!

Pa dyshim se Kosova, si një shtet i ri, ka shumë probleme dhe unë do të fokusohem në problemin më të rëndë nga 17 vjet pas luftës, i cili fatkeqësisht jo vetëm që e ka shkatërruar, por është duke e shkatërruar të ardhmen e qytetarëve të Kosovës dhe veçanërisht të brezave – gjeneratave të reja, por një problem i cili është edhe faktor kryesor që e pengon Kosovën në integrimin evropian dhe procesin e liberalizimit të vizave.

Pra, fjalën e kam për shkallën e lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit, që fatkeqësisht nuk ka lënë pore të vendit tonë, institucione publike dhe private pa e prekur.

Kjo epidemi, e cila që 17 vjet pasluftës është duke lulëzuar dhe fatkeqësisht është duke u rritur dhe duke marrë përgjigjen më të vogël të mundshme në vazhdimësi qoftë nga politika kosovare, qoftë nga institucionet që janë përgjegjës për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Është për keqardhje që një vend, kur ka pasur miliarda euro investime nga partnerët ndërkombëtarë, kur ka pasur edhe miliarda euro investime nga diaspora kosovare, ka mbetur vendi me shkallën më të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe, fatkeqësisht me shkallën më negative të perspektivës së gjeneratave të reja.

Shkalla e lartë e krimit të organizuar dhe korrupsionit nuk ka lënë pjesë të shoqërisë kosovare pa e prekur dhe kemi krim të organizuar e korrupsion duke filluar nga politika kosovare, arsimi, shëndetësia, ekonomia, institucionet publike e private dhe, fatkeqësisht, ajo që është më e keqja dhe çka e bën më të rëndë klimën në vendin tonë, është mungesa e vullnetit, mungesa e guximit që të ballafaqohet dhe të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin në vendin tonë.

Zatën, krimi i organizuar dhe korrupsioni është faktori kryesor që po e pengon Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave dhe pastaj vijnë edhe kërkesat e tjera, të cilat janë të njohura tashmë për ne nga Bashkimi Evropian.

Kosova, si një vend i ri demokratik, 17 vjet pas lufte është përcaktuar në rrugën e integritit evropian në raporte me vendet e Bashkimit Evropian dhe raportin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por në rrugën në të cilën është duke ecur Kosova, është duke rrezikuar t'i prishë këto marrëdhënie të rëndësishme me këto vende dhe me këto integritime, për faktin se është duke bërë partner jo me BE-në, jo me SHBA-në, por është duke u bërë partner me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Prandaj, mendoj se kurrë më shumë se sot edhe Kuvendi i Kosovës, si institucion legjislativ, por edhe Qeveria e Kosovës, si institucion ekzekutiv, kurrë më shumë se sot e kanë mundësinë të ballafaqohen, t'i përvjelin mangët dhe ta luftojnë këtë fenomen që fatkeqësisht e ka rrënuar të ardhmen e vendit tonë, e përgjithësi në fjalimet e mia publike nuk kam dëshirë dhe gjithmonë u shmangem emrave të përveçëm, por vetëm sa për ilustrim, ku dhe si është guximi i institucioneve kosovare të ballafaqohen me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. E kemi rastin konkret me vendin fqinj, Republikën e Kroacisë, kur ish-kryeministri akuzohet dhe dënohet me 10 vjet burgim efektiv për keqpërdorim të 250 mijë eurove, ndërsa Republika e Kosovës ende nuk ka dënime të tilla të nivelit të lartë, përveç ish-ministrit të kaluar, nga mandati i kaluar, së bashku me zëvendësin e tij, të cilët për keqpërdorimin e 600 mijë eurove dënohen me kusht 6 muaj, do të thotë 10 vjet në Kroaci, e në Kosovë dënohet me kusht.

Prandaj, unë mendoj që edhe një herë ne si Kuvend i Kosovës, si Qeveri e Kosovës, duhet një herë e përgjithmonë t'i përvjelim mëngët e të angazhohemi, të mobilizohemi e ta luftojmë këtë krim të organizuar, i cili fatkeqësisht nuk ka lënë pore të shoqërisë pa prekur.

Dhe, në fund, kemi raste të njohura, edhe mungesë vullneti që ta luftojmë këtë krim të organizuar, kur kemi pasur investitorë të ndryshëm nga vende të ndryshme dhe nga diaspora, nga Gjermani, nga Turqia, kur në media është bërë publike edhe kërkimi i haraçit legal, me letra, e fatkeqësisht ajo që është raportuar në media, edhe nga ish-ministra të mandatit të kaluar, ku kanë kërkuar shuma marramendëse që investitorët të ndryshëm të investojnë në Kosovë.

Prandaj, pa dashur ta zgjas më shumë, unë mendoj që ne duhet më shumë se kurrë që sot të mobilizohemi e ta luftojmë këtë të keqe, e cila fatkeqësisht është duke na armiqësuar edhe me vendet e BE-së, edhe me SHBA-në dhe me të gjitha vendet e tjera, të cilët na duan të mirën dhe kanë investuar në Kosovë.

KRYETARI: Faleminderit! Me këtë përfundon kjo pikë e rendit të ditës.

Më lejoni t'i lexoj, në mënyrë rigjide do t'i bindemi kësaj liste për seancën e ardhshme. Radhitja është në bazë elektronike që unë po e lexoj: Labinotë Demi- Murtezi, Raif Qela, Bali Muharremaj, Flora Brovina, Driton Çausi, Ganimete Musliu, Shukrije Bytyqi, Nait Hasani, Hajdar Beqa dhe Faton Topalli, mbesin për seancën e radhës ta marrin fjalën, unë kërkoj falje, edhe kështu 15 minuta e kemi zgjatur.

Ndërkohë ministri i Arsimit e ka fjalën për një sqarim, për ata që mund të kenë ndonjë huti në Rregullore, neni 48 i Rregullores së Kuvendit ia lejon këtë mundësi, ke të drejtë Ismajl. Faleminderit! Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht ju uroj një legjislaturë të suksesshme vjeshtore dhe besoj që kemi shumë punë në këtë legjislaturë.

Dëshiroj të jap disa sqarim shtesë rreth diskutimit të deputetes Teuta Haxhiu, e cila iu referua dy çështjeve: çështjes së furnizimit me tekste shkollore dhe çështjes së infrastrukturës apo objekteve shkollore.

Me iniciativën time si ministër, Qeveria tani ka miratua koncept dokumentin për projektligjin e ri për furnizimin me tekste mësimore.

Ky projektligj është në finalizim e sipër dhe jam i sigurt se në sesionin vjeshtor do të vijë në Kuvend dhe është një ligj, i cili do të sjellë risi sa i përket furnizimit me tekste në dy segmente.

E para, duke promovuar pjesërisht tekstin digjital në shkolla, do të thotë, ministria po punon që gati gjysma e teksteve të ofrohen në formën digjitale, në formën e CD-ve.

Dhe, e dyta, ofrimi i teksteve me standarde dhe me licencim ndërkombëtar që po bëhet në bashkëpunim me Qeverinë gjermane dhe këto ditë do të firmoset marrëveshje midis dy qeverive dhe ministrive, ku Qeveria gjermane do të ofrojë tekste për shkencat ekzakte, të cilat do të adaptohen për nevojat e nxënësve të Kosovës.

Është e vërtetë që sivjet ka pasur një problem goxha të madh sa i përket furnizimit të teksteve në mungesë të buxhetit, sepse nuk ka pasur fare vijë buxhetore të paraparë dhe vetëm në momentin e fundit Ministria e Financave ka ndihmuar dhe ne kemi filluar procesin e furnizimit me tekste, i cili ka përfunduar këtë javë.

Dëshiroj t'ju siguroj se sivjet ka pasur një proces jashtëzakonisht të detajuar të përgatitjes së teksteve që nga futja në përdorim e 86 teksteve të rishikuara nga klasa e parë e deri te klasa e nëntë.

Pastaj është zvogëluar dukshëm buxheti dhe në 10-vjetshin e fundit sivjet kemi arritur të reduktojmë mjaft buxhetin. Komplet procesi i menaxhimit të teksteve shkon përmes drejtorive komunale, të cilat për çdo vit referojnë nevojat për tekste.

Kemi përfshirë të gjitha stoqet e teksteve të përdorshme, më shumë se 200 mijë tekste janë përfshirë dhe kostoja mesatare për një nxënës, pra për një nxënës të arsimit fillor, është diku 20 euro për një pako, që është diku deri në 14 tekste.

Kështu që ne së shpejti do ta kemi debatin në Kuvend për projektligjin e ri për furnizimin me tekste dhe aty është mundësia e mirë që jo vetëm të ofrojmë tekste falas për nxënës, por të ofrojmë edhe tekste cilësore dhe moderne, të cilat do të jenë plotësisht me standarde ndërkombëtare.

Sa i përket infrastrukturës, të gjithë jemi këtu në Kosovë dhe e dimë se është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe në periudhën e pasluftës, janë ndërtuar shkolla moderne, por gjithmonë problemet për shkolla të reja janë permanente, gjithmonë nevoja për të ndërtuar shkolla të reja është permanente dhe Ministria e Arsimit po bënë çmos që të përfshijë kërkesat e mundshme.

Ne nga java e ardhshme do të kemi përrurimin e një varg shkollave nga viti 2009, ditën e mërkurë do ta përrurojmë shkollën e mesme në Mitrovicë, ditën e martë shkollën e mesme në Prizren.

Jemi pajtuar me autoritetet lokale të Komunës së Podujevës, ku kemi një problem jashtëzakonisht të madh që brenda një muajve edhe atë shkollë ta bëjmë funksionale.

E pranoj se kemi mungesë buxheti, por brenda mundësive buxhetore po bëjmë çmos që çdo shkollë të përfundojë dhe të planifikojmë ndërtimin e shkollave për të cilat ka nevojë emergjente, janë diku rreth 20 shkolla nga Lufta e Dytë Botërore, të cilat nuk plotësojnë asnjë kusht infrastrukturor për të punuar dhe ministria po punon edhe me partnerët ndërkombëtarë të sigurojmë buxhet që vërtet të sigurojmë sa më shumë kushte të mira për shkolla jo vetëm sa i përket infrastrukturës, por të punojmë edhe në aspekte të tjera, për të cilat edhe sot do të ketë pyetje parlamentare. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë zoti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Bazuar në informatat e publikuara, e që ministria juaj i ka pranuar si të vërteta, gjatë vitit 2015 ministria që ju e drejtoni gabimisht i ka ekzekutuar një milion e 400 mijë euro pagesa për pensionistë, edhe atë, mbi 800 mijë euro u janë paguar pensionistëve pas vdekjes, mbi 400 mijë euro përfituesve të më shumë se një skeme pensionale dhe rreth 250 mijë euro u janë paguar personave që realizojnë të ardhura personale.

Sipas auditorit, nga kjo sasi vetëm 63 mijë euro i kanë kthyer përfituesit e këtyre mjeteve që nuk u takojnë.

Pyetja ime është për ju: Çka keni ndërmarrë konkretisht t'ia ktheni ato mjete buxhetit të Kosovës dhe çka keni ndërmarrë ndaj zyrtarëve përgjegjës që me fajin e tyre e kanë dëmtuar kaq rëndë buxhetin e Kosovës?

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë, ministra,

Faleminderit për pyetjen, zoti Kurteshi,

Mund të ndërlidhem me konstatimin e auditorit, e cila është përmendur shpeshherë edhe në media. Më lejoni të shpjegoj se si është situata.

Me marrjen e detyrës, në funksion të menaxhimit sa më të mirë të financave publike, në këtë rast edhe skemave të cilat menaxhohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ne kemi arritur një marrëveshje vetë, e cila është iniciuar nga kabineti ynë, marrëveshje me Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Marrëveshja është iniciuar diku rreth pranverës, mars-prill, pas negociatave dhe negociatave që kanë bërë edhe departamentet e tyre me Ministrinë e Punëve të Brendshme, marrëveshja është

arritur në shtator, ka hyrë në fuqi menjëherë në tetor, pasi që është bërë edhe trajnimi i personelit se si të përdoren të dhënat.

Me marrjen e të dhënave, ne si ministri, do me thënë, me iniciativën tonë, ne kemi vërejtur se një numër i madh i familjeve kanë përfutur pensione edhe pas vdekjes së pensionistëve. Edhe po flasim jo për periudhën 2015, po periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2015, sepse auditori e ka shënua vetëm 2015, ose nuk e di si e ka cekur, është problem i tyre. Por, ne po flasim për diku rreth 3 200 persona apo familje që kanë pranuar pensionet për një muaj, dy muaj deri në gjashtë muaj, sepse realisht pensionistët duhet të lajmërohen dy herë në vit, apo çdo gjashtë muaj, prandaj edhe mund të ketë kesi mangësi.

Ideja është se 3 200 pensionistë, familje të cilët kanë pranuar pensionet, kanë të bëjnë me periudhën 2006-2015. Edhe kjo është arritur falë një iniciative tonë, falë marrëveshjes me Agjencinë për Regjistrin Civil.

Në bazë të kësaj, ne kemi reaguar karshi edhe këtyre familjeve, karshi edhe bankave dhe kemi kërkuar kthimin e mjeteve dhe kjo po vazhdon ende realisht edhe kësaj dite.

Në mos gabofsha, deri në vitin 2015, raportin e fundit që kemi kërkuar që të kthehen këto mjete, është diku rreth 313 222 euro, të cilat janë kthyer dhe janë mjete të tjera, të cilat priten të kthehen.

Sa i përket pagesave të dyfishta, disa nga skemat parashihet të kenë pagesa të dyfishta, pasi që janë edhe probleme ose sfida ligjore, le të themi, sepse diku quhen skema pensionale, diku kompensime, dhe pagesat janë bërë ashtu sipas vendimeve të mëhershme të ministrisë.

Ne kemi reaguar edhe karshi vendimit të auditorit dhe kemi bërë ndërprerjen, kurse atyre që u janë ndërprerë tani, te pagesat e dyfishta, mbeten rrugë të tjera ligjore që të sqarojnë qoftë në Gjykatën Kushtetuese, qoftë në rrugë të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kurteshi?

ISMAJL KURTESHI: E kam edhe një pyetje shtesë. Kjo vlen për ministrin për kohën sa ka qenë ai. Sa mjete kanë shkuar kështu gabimisht? Edhe një çështje tjetër që po dua ta pyes ministrin është se, në vendet demokratike, siç pretendon të jetë Kosova, pas një skandalit të këtillë në një ministri, punën e parë që e bën ministri është të japë dorëheqje, a ke shqyrtuar këtë mundësi dhe të vërtetosh se vërtet jeni një qeveri demokratike, në një vend demokratik? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Zoti Kurteshi!

Si duket, prapë pyetja ose ka qenë tendencioze, ose s'je kah e kupton përgjigjen. Unë jam ai që e kam bërë këtë zbulim, a po të pëlqen a nuk po të pëlqen. Unë jam ai që kam iniciuar marrëveshjen edhe me ARC-në, edhe me bashkësitë fetare që të ndalen këto keqpërdorime.

Unë s'e kam ndërmend të jap dorëheqje, se kam ende punë për të bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, prapë pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Regjia, zotit Kurteshi fjalën.

ISMAJL KURTESHI: ...kemi një farë zhvillimi të madh ekonomik në këtë vend edhe gjithë të mirat, po ne jse po kaloj te ministri i Arsimit.

Zoti ministër!

Vitin e kaluar ju patët bërë përpjekje që nxënësve shqiptarë të Luginës së Preshevës t'ua dërgoni tekstet shkollore nga Kosova. Serbia nuk i lejoi këto tekste që t'u shpërndahen nxënësve shqiptarë. Në të njëjtën kohë, në Kosovë hyjnë tekste nga Serbia për nxënësit serbë. Ju u zotuat vitin e kaluar se do ta zbatoni reciprocitetin, por kjo nuk funksionoi.

Zoti ministër!

Çka keni ndërmarrë që këtë vit t'u dërgoni libra nxënësve shqiptarë në Luginën e Preshevës dhe që ato të arrijnë në duar të nxënësve dhe a do të lejoni në Kosovë të hyjnë tekstet shkollore nga Serbia, nëse Serbia nuk i lejon tekstet e Kosovës të hyjnë në Luginë dhe t'u jepen në përdorim nxënësve shqiptarë?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalë.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet Kurteshi!

Tani më disa herë në Komisionin për Arsim, bashkë me ju, kemi diskutuar problemet që kanë dalë me dërgimin e teksteve në Luginën e Preshevës dhe keni qenë të informuar dhe keni bërë edhe pyetje më herët. Përkundër të gjitha përpjekjeve dhe rrugëve ligjore që janë ndërmarrë, e Qeveria serbe nuk ka lejuar hyrjen e këtyre teksteve dhe përkundër faktit se ka pasur edhe një marrëveshje në Bruksel që të lejohet përdorimi i teksteve.

Gjithashtu ju e dini se menjëherë pas bllokimit të këtyre teksteve, unë si ministër, brenda kompetencave që kam pasur kam sjellë vendimin për vendosjen e reciprocitetit, ndalimin e hyrjes së teksteve mësimore të Qeverisë serbe në Kosovës dhe ky vendim u është proceduar të gjitha organeve kompetente që janë të obliguara ta zbatojnë.

Informacionet tona tregojnë se në përgjithësi vendimi është respektuar, edhe pse aty-këtu ka pasur hyrje ilegale të këtyre teksteve, por kjo del jashtë përgjegjësisë së Ministrisë së Arsimit, sepse është përgjegjësi e Doganave dhe e Policisë së Kosovës për ta zbatuar një vendim shtetëror për reciprocitete.

Sa i përket këtij viti, ne i kemi pritur përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, kemi diskutuar me ta, edhe ata janë në kërkim të mundësive për marrjen e teksteve. Është ndoshta një rrethanë tash edhe vështirësuese, sepse kohë më parë përfaqësuesit politikë të shqiptarëve kanë nënshkruar me Ministrin e Arsimit të Republikës së Serbisë marrëveshjen për pranimin e fillimit të përkthimit të teksteve në gjuhën shqipe dhe ata kanë qenë në Ministrinë e Arsimit dhe kanë kërkuar asistencë nga ministria për të asistuar në përkthimin e këtyre teksteve, gjë që ministria ka refuzuar në mënyrë të vendosur, që ne nuk do të asistojmë në përkthimin e këtyre teksteve serbe për nevojat e nxënësve shqiptarë, sepse jemi të vetëdijshëm se përpos gabimeve profesionale, ato tekste kanë edhe gjuhë diskriminuese dhe u kemi dhënë një afat

përfaqësuesve politikë që brenda këtij afati ata të ndërmarrin të gjitha masat për furnizimin me tekstet që janë donacion i Qeverisë së Kosovës. Në qoftë se nuk arrijnë që brenda afatit, atëherë këto tekste do të shpërndahen nëpër shkollat e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: Ju e dini që përfaqësuesit politikë dhe ata institucionalë në Luginën e Preshevës nuk mund ta zgjedhin këtë problem dhe ky problem është i nivelit të dy qeverive. Çka keni ndërmarrë ju që kontaktoni me Qeverinë e Serbisë dhe a keni lejuar që sivjet të hyjnë tekstet e Serbisë, se vitin e kaluar e di që institucionet e Kosovës nuk e kanë përfillur vendimin tuaj. Do të thotë, ju brenda Qeverisë nuk keni dakordancë dhe koordinim. Çka keni ndërmarrë që sivjet të pengohen këto tekste?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Deputet, tani më ju e dini se kontakte dhe takime zyrtare mes ministrive të Qeverisë së Kosovës dhe të Serbisë nuk ka ende, kemi pasur takime joformale në shumë takime ministrore të nivelit ministror dhe e kemi shtruar këtë çështje, por kjo çështje është ngritur në nivel të takimeve të Brukselit bashkë me ministren Tahiri. Ne e kemi ngritur dhe kemi pasur një pajtueshmëri edhe të autoriteteve evropiane që do të lejohet furnizimi i teksteve, por kjo nuk ka ndodhur.

Vendimi për reciprocitetin vazhdon të jetë në fuqi edhe këtë vit dhe unë i ftoj nga këtu të gjitha institucionet ekzekutive që ta zbatojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Qela, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Kryeministri nuk është këtu, në qoftë se doni ta bënë pyetjen, jeni të lirë.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të pranishëm,
Qe disa muaj me radhë e shtroj çështjen e Ligjit për “Trepçën” edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, edhe para kësaj seance të Kuvendit, në mënyrë që të gjendet zgjidhja për këtë.

Kryeministri nuk më është përgjigjur edhe herën e kaluar në këtë pyetje, as sot nuk është i pranishëm.

Prandaj, kërkoj që përveç kohës për dy minuta për pyetjen, edhe pyetjen plotësuese, më jepni kohë plotësuese.

Para 20 muajsh ky Kuvend, por edhe Qeveria kanë qenë në siklet të madh duke shqyrtuar Ligjin për ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me qëllim që të pengohet likuidimi i paralajmëruar i Kombinatit “Trepça”.

Prej atëherë pothuajse asgjë nuk ka ndryshuar lidhur me këtë çështje, gjendja e agonisë në të cilën është “Trepça” që më shumë se 25 vjet po vazhdon.

Akoma nuk kemi nxjerrë bazë ligjore të nevojshme që kjo ndërmarrje të zhvillohet dhe me afarizmin e vet pozitiv të ndikojë edhe në zhvillimin ekonomik të krejt Kosovës.

Ligji për Kombinatin “Trepça” duhet të sillet në Kuvend, e jo të mjaftohemi me terapi shpëtimi të përkohshëm apo me ligje surrogate.

Qe disa muaj grupi punues, respektivisht Komisioni për hartimin e Ligjit për Trepçën e themeluar nga vetë kryeministri, e ka kryer punën e vet dhe e ka sjellë një version fillestar të projektligjit, prej atëherë ne nuk kemi asnjë lëvizje.

Qeveria nuk e ka proceduar në Kuvendin Ligjin për “Trepçën”. Shumë nga përfaqësuesit e institucioneve kanë dhënë premtim para punonjësve të Kombinatit Trepça dhe para qytetarëve se do ta nxjerrin Ligjin për “Trepçën”. Edhe vetë kryeministri në shkurt të këtij viti e kishte dhënë këtë premtim në “Trepçë” para minatorëve, në manifestim me rastin e përvjetorit të “Trepçës”, ky është ai premtim? Pse akoma nuk ka lëvizje? Ne nuk duhet të paralizohemi nga frika e pabazë e të mos veprojmë, siç kemi bërë deri më tani.

Ligji për “Trepçën” duhet të nxirret në afatin e paraparë. Këtë duhet ta bëjmë më së largu brenda javës së ardhshme, sepse më 2 nëntor skadon afati me ligjin përkatës e pastaj “Trepça” shkon me automatizëm në likuidim.

Nuk është kurrfarë zgjidhje as ndonjë ligj surrogat për t’ia zgjatur agoninë “Trepçës”, duhet Ligji për “Trepçën”, ose duhet të bëjmë këtë, ose duhet të tregojmë se nuk jemi të aftë ta udhëheqim vendin dhe duhet të japim përgjegjësi për çdo dështim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sali Salihu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, zoti Salihu nuk është.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Me qenë se ministri nuk qenka këtu, çështja ka qenë loja që po bëhet me specialistët e Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët nuk po paguhen me gjithë premtimet që i ka dhënë ministri.

Është absurde se përpos gjendjes së rëndë në shëndetësi, gjendjes tejte të rëndë me të cilën jemi të informuar të gjithë, po abuzohet edhe me kuadro të larta.

Për t’u bërë një mjek specialist Kosovës i duhen 23 vjet investim në një person. Ndërsa, këta persona dhe mjekë të kualifikuar t’i lësh në mëshirën e fatit, kjo është një turp që po i ndodh Kosovës. Nuk është e paarrtshme që Qeveria të mos sigurojë paga për specialistët, për punën të cilën po e kryen dhe për kujdestaritë që po i mbajnë.

Nëse vazhdojmë me këto politika diskriminuese ndaj personalit shëndetësor, në afat jo të gjatë Kosova do të mbetet pa kuadër shëndetësor, sepse mjekët e papunë, specialistët e papunë, specialistët e papaguar po e shohin perspektivën e tyre në vendet perëndimore, të cilët pa asnjë hezitim po i pranojnë dhe po i punësojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, ka dhënë shumë deklarata dhe qëndrime, një pjesë prej tyre jo gjithnjë të vërteta sa i takon funksionalizimit të odave të profesionistëve shëndetësorë.

Ne i patëm në takim kryetarët e të gjitha odave në Komisionin për Shëndetësi, përveç vërejtjeve shumë të drejtpërdrejta që kanë për ministrinë, ata shfaqën hapën mosbesimin e gatishmërinë e ministrit për të zbatuar ligjin për këto oda.

Nuk kuptohet ende ku po bazohet Ministria e Shëndetësisë dhe ju si drejtues i saj që vijoni t'i shkelni të gjitha normat ligjore dhe procedurale sa i takon bartjes së kompetencave dhe lejimit të funksionimit, bashkë me financat autonome të këtyre institucioneve kaq të rëndësishme për punonjësit mjekësorë.

Është viti 2016 dhe në vendin tonë paditet Ministria e Shëndetësisë, sepse nuk pranon t'i lëshojë kompetencat që i kanë me ligj profesionistët shëndetësorë.

Merreni me mend, sikur odat e avokatëve ende të mos veprojnë në mënyrë autonome, por t'i kryenin shërbimet në Ministrinë e Drejtësisë.

Ministër, profesionistët mjekësorë nuk janë vartësit tuaj, ju keni vetëm përgjegjësinë të ushtroni kontroll ndaj institucioneve shëndetësore, të dërgoni për ndjekje penale keqbërësit, t'u dërgoni me kohë dhe siç duhet buxhetet, të hartoni politika dhe të lehtësoni punën. Por, ju asnjë nga këto nuk bëni, përveç që mbani në kontroll avancimin dhe karrierën e punonjësve mjekësorë.

Kjo na bënë të dyshojmë se po përfitoni në mënyrë joligjore nga këto kompetenca që tashmë duhet t'i kishin odat.

Prandaj, pyetja është për Ministrinë e Shëndetësisë, përkatësisht për ministrin, se deri kur do të vazhdojnë ta shkelin ligjin sa u përket odave të profesionistëve shëndetësorë?

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk është këtu. Deputetja Besa Baftija, prapë ka një pyetje tjetër për ministrin, po ashtu. Dëshiron ta lexoni. Zonja Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Është një kundërthënie në mes të emërimit të programit qeverisës sa i përket shëndetësisë dhe asaj çfarë e kemi shëndetësinë në vendin tonë.

Unë nuk di se çfarë nënkuptojnë me “shëndetësi moderne”. Duke qenë se po bëhen dy vjet të qeverisjes tuaj dhe pa asnjë dilemë nuk mund të themi se ky sektor nuk ka pasur përmirësim.

Përkundrazi çdo ditë po shënohen probleme të reja përveç atyre të vjetrave. Institucionet publike, në veçanti ato që i menaxhon Ministria e Shëndetësisë, ai sekondar dhe terciar, vazhdojnë të mbeten në gjendje të rëndë. Mungesa e përditshme e barnave dhe materialit shpenzues,

mosfunksionimi i aparaturave me muaj ka bërë që pacientët, ata që kanë t'i blejnë dhe t'i marrin shërbimet jashtë institucioneve publike, ndërsa ata që nuk kanë të paguajnë me jetë.

Tani besoj dhe duket qartë pse ne kundërshtojmë Spitalin e Përgjithshëm Privat që ndodhet brenda territorit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe ministri i Shëndetësisë, bashkë me kryeministrin e mbështetën.

Ministër, ka më shumë se dy muaj që aparati i koronarografisë është jashtë funksionit dhe ende nuk ka një përgjigje se çfarë do të ndodhë. Përveç justifikimeve të përhershme lidhur me servisimin e tyre, që çdo herë është i shtrenjtë dhe i vonuar. Jemi në dijeni që këto aparatura prishen me qëllim dhe të shumtën e rasteve pacientët mbeten në shërbim të institucioneve dhe personave privatë, duke u arsyetuar çdo herë me një udhëzim administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë që lejon referimin në institucionet private, kur nuk ka kushte në klinikat publike.

Prandaj, ne kërkojmë që ministri të na njoftojë se çka ka ndërmarrë konkretisht Ministria e Shëndetësisë ndaj këtyre shkelësve të ligjit për t'i penguar dukuritë e lartpërmendura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Selville Halimi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Dëshironi ta bëni pyetjen?

SELVILLE HALIMI: Vetëm desha ta theksoj çështjen se për çka ka të bëjë pyetja. Pyetja ka të bëjë me sigurimet shëndetësore dhe t'ia kujtoj Kabinetit qeveritar se sigurimet shëndetësore kanë qenë edhe premtim elektorale i dy partive në koalicion dhe tashmë jemi në fund të vitit 2016 dhe duam të dimë, edhe ne si deputetë, por edhe qytetarët e Kosovës, se kur mund të realizohen sigurimet shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që është pyetje për Qeverinë më shumë sesa për ministrin e Shëndetësisë, se ajo duhet t'i bëjë analizat, ajo duhet të përgjigjet. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Në planin e punës së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në vitin 2014 e keni pasur të paraparë Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë nga viti shkollor 1990-1991 deri në vitin shkollor 1998-1999.

Pyetja për ju zoti ministër është: A ka filluar ministria juaj të merret seriozisht me këtë çështje?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar deputete Haxhiu!

Më lejoni të ju informoj, edhe pse këtë informatë ju kam dhënë edhe në komisionin parlamentar që në muajin dhjetor të këtij viti, Ministria e Arsimit e ka përfunduar dhe e ka dorëzuar projektligjin për mësimdhënësit e viteve '90-'98 dhe ky ligj tanimë ndodhet në procesin e vlerësimit financiar në Ministrinë e Financave dhe me siguri që edhe Parlamenti mund ta japë një rol të rëndësishëm tek diskutimi i buxhetit për vitin 2017.

Është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili nuk është vetëm një satisfaksion moral për të gjithë mësimdhënësit që e dhanë një rol shumë të rëndësishëm në kohën e mbijetesës së arsimit shqip, por është edhe një njohje e punës së përgjithshme të sistemit arsimor në këtë periudhë. Tanimë Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës e kanë filluar implementimin e pagesës së përvojës së punës për të gjithë mësimdhënësit për këto vite, pra nga '90 deri në '98 dhe kjo tanimë ka hyrë në skemën e re të pensioneve, ku secili vit pranohet si vit i përvojës së punës.

Natyrisht ky është një ligj që po diskutohet që 10 vjet dhe po diskutohet me shumë partnerë. Ministria e Arsimit ka pas një proces të gjerë të diskutimit edhe me sindikata dhe ne e kemi finalizuar me sukses, por Parlamenti duhet të ketë shumë punë për ta miratuar këtë listë, sepse do të ketë një kosto shumë të madhe, sidomos dëshiroj ta theksoj një pozicion shumë specifik në këtë ligj që ka të bëjë me pensionin shtesë për mësimdhënësit, sepse njëra nga pikat apo njëra nga kërkesat e mësimdhënësve është edhe një pension shtesë krahas pensionit të rregullt, që përfshin gati më tepër se 40 mijë mësimdhënës, punëtorë administrativë dhe punëtorë tjerë në sistemin arsimor, që është një kosto shumë e papërballueshme, sepse kjo do të shkaktonte kërkesa zinxhimore edhe të punëtorëve tjerë të kësaj periudhe, sepse duhet të gjithë të jemi të vetëdijshëm se mbijetesa e arsimit shqip në këtë periudhë ka qenë pjesë e rezistencës së përgjithshme kombëtare, ku mësimdhënësit e kanë luajtur rolin e vetë dhe mendoj se...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Pyetje shtesë, deputete?

TEUTA HAXHIU: Po, unë kam para vetes dy dokumente ministër, ndër të cilat një që ka dalë nga komisioni në legjislaturën e kaluar, më 20 mars 2013 dhe janë nxjerrë rekomandimet. Njëri prej rekomandimet thotë "Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet ta nxjerrë këtë ligj në afatin prej 3 muajve".

Njëkohësisht e kam edhe përfundimin e seancës së vitit 2013, në prill, pra që e obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës ta hartojë këtë, pra në afatin jo më shumë se tre muaj, dhe t'ia sjellë Kuvendit për miratim.

Sot jemi në vitin 2016, do të thotë janë tre vjet në pyetje. Megjithatë, edhe çështja e kostos që ju e përmendët, të gjithë e dimë që këta njerëz, këta mësimdhënës kanë dhënë më shumë për ta mbajtur arsimin shqip gjallë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete, Nuk po flas për periudhën 2013, por do t'ju bind edhe një herë se ka qenë prioritet i Ministrisë së Arsimit dhe imi, dhe ne e kemi realizuar këtë ligj. E kemi dorëzuar, është në vlerësim financiar dhe uroj që të gjendet kostoja financiare. Por, më shumë se sa përfitimet materiale, ky ligj ka efekte morale: njohja e punës së sistemit arsimor, edhe një herë po e përsëris atë që mbeta në

gjysmë: Ky ka qenë një projekt i rezistencës kombëtare, ku mësimdhënësit e kanë luajtur rolin që duhet ta kenë luajtur. Nuk ka pasur alternativë tjetër për ne si mësimdhënëës përpos që të punojmë edhe në kushte të vështira dhe natyrisht ne kemi të drejtë të kërkojmë që puna jonë të vlerësohet, por jo të marrim tash shpërblime dhe dekorata për këtë punë, sepse kjo ka qenë pjesë e rezistencës kombëtare. Ne s'kemi pasur zgjidhje tjetër. O është dashur të punojmë në shtëpitë private, ta mbajmë universitetin, ose ndoshta është dashur, siç kanë bërë një pjesë të kolegëve, të shkojmë dhe të punojmë bashkë me pushtetin okupues serb, dhe ne e kemi zgjedhur këtë jo si zgjidhje jona, por si pjesë e konceptit të rezistencës të përgjithshme politike për mbajtjen gjallë të frymës së rezistencës dhe për jetësimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, edhe mbi bazën e Kushtetutës së Kaçanikut të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

E do edhe pyetjen tjetër? Atëherë zonja Haxhiu e ka edhe një pyetje tjetër për ministrin Bajrami.

TEUTA HAXHIU: E kam edhe një pyetje, por para se të vazhdoj me pyetjen, ju thatë nuk i referoheni vitit 2013, por në planin e punës së komisionit, i cili hartohet në bashkëpunim me ministrinë tuaj, e kemi më 30 maj 2014.

Prandaj, jeni më shumë se vonë. Vazhdojmë me pyetjen e dytë: Në seancën e mbajtur më 19 shkurt 2016, ju ministër e tërhoqët Ligjin e arsimit të lartë me arsyen se keni nevojë për konsulta shtesë. Ndërsa, Komisioni për Arsim e miratoi këtë projektligj në fund të vitit 2015. Pyetja është: Ku mbeti Ligji i arsimit të lartë?

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar deputete!

Ne do të bisedojmë edhe të hënën kur e kemi raportimin në komision. Ligjin për arsimin e lartë është një ligj sistemor dhe shumë i rëndësishëm, një ligj i cili miratohet me shumicën e dyfishtë, pra na duhet edhe shumica e komuniteteve pakicë.

Arsyeja e vonesës së këtij ligji është për dy arsye: e para, për faktin se Ministria e Arsimit për herë të parë ka propozuar që në këtë ligj në pjesën e hapësirës së arsimit të lartë të përfshihet edhe i ashtuquajti Universiteti i Mitrovicës së Veriut, i cili duhet të sistemohet brenda sistemit të arsimit të lartë së Republikës së Kosovës dhe ne jemi duke i finalizuar, do të thosha edhe kontaktet me të gjithë partnerët që kjo të bëhet e mundshme, sepse, siç e dimë, ky institucion deri tash ka funksionuar jashtë sistemit të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, projektligji që e kemi dorëzuar dhe që është miratuar në komision e parasheh si universitet të Kosovës dhe arsyeja e dytë është që vërtet të sigurojmë që ky ligj t'i përmbajë standardet më të larta, të cilat do t'i mundësojnë ndoshta sivjet Kosovës edhe pranimin në hapësirën evropiane të Bolonjës, që të bëhemi anëtar i plotë në sistemin e Bolonjës. Këto ditë e kemi edhe një çështje që do të hyjë në këtë ligj, e ka të bëjë me një koleg ndërkombëtar të biznesit, i ashtuquajti Universitet Evropian, që ka funksionuar disa vite në Mitrovicë në pjesën e veriut dhe në pjesën jugore, dhe po bëjmë përpjekje që edhe këtë institucion ta shndërrojmë në institucion publik, pra jo institucion privat, dhe të jetë një institucion i ekselencës në arsimin e lartë dhe këtë do ta bëjmë me Projektligjin për arsimin e lartë, i cili jam i sigurt se nuk do të vonojë 2-3 mbledhje dhe do të vijë në këtë Parlament.

E kemi një përparësi se do ta diskutojmë pa presione, për shkak se në kohën kur është bërë ligji e kemi pasur një krizë në universitet. Universiteti ka qenë pa udhëheqje dhe tash është mirë që ky ligj do të diskutohet gjatë ndoshta, edhe në komision, pa presione, në mënyrë që ta bëjmë një ligj të mirë, i cili ndoshta do të jetojë me dekada dhe do të mundësojë zhvillimin dhe profilizimin e mirë të arsimit të lartë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë prapë? Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Megjithatë, nuk mora përgjigje se kur do të vijë. Mënyra se si është tërhequr ky ligj ministër, nuk është e paraparë as me Rregulloren e Kuvendit, ministri mund ta tërheqë ligjin, por ju nuk e keni tërhequr, në fakt e keni lënë në mes të rrugës.

Kur do të vijë ligji në Kuvend dhe uroj që çështjet të cilat i përmendët sa i përket universitetit që e keni pasur edhe premtim fushator të rregullohen, por megjithatë kur do të na sillet neve si deputetë ky ligj?

KRYESUESI: Zoti ministër, urhdëro!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Besoj që nuk do të na duhet më shumë se një muaj ditë kohë për t'i përfunduar këto dy projekte, pra rreth Universitetit të Mitrovicës së Veriut dhe rreth Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit, i ashtuquajtur i Sparkut ndoshta është më lehtë për ta kuptuar, që edhe këto dy institucione t'i përfshijmë me pëlqim ndërkombëtar dhe me buxhet, sepse të dyja kanë kosto buxhetore brenda ligjit dhe uroj që gjatë muajit tetor ky ligj të vijë në Kuvend.

KRYESUESI: Deputeti Mytaher Haskuka, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

MYTAHER HASKUKA: Sipas udhëzimit administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr. 34-2014, për funksionimin e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, në mbështetje të Ligjit për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L- 032, sipas nenit 2 parashihet që në shkolla të gjitha institucionet parauniversitare të punësojnë psikologë dhe pedagogë në kuadër të shërbimit pedagogjik psikologjik.

Pyetja parlamentare: Edhe pse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga udhëzimi administrativ, i cili kërkon që në çdo shkollë fillore dhe të mesme të ketë së paku një psikolog apo pedagog, në shumicën e shkollave të Kosovës nuk ka psikologë apo pedagogë, pse nuk implementohet ky udhëzim administrativ, ngase kjo kishte për të ndikuar shumë pozitivisht në parandalimin e sjelljeve problematike, të cilat u folën edhe paraprakisht në dhunën në shkolla, e kështu me radhë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet dhe profesor Haskuka!

Më lejoni të ju jap përgjigjen në pyetjen e parashtruar. Siç e theksuat edhe ju, udhëzimi administrativ i vitit 2014 parasheh që secila shkollë publike në Republikën e Kosovës të ketë pedagogun dhe psikologun. E kjo është një e arritur e madhe, sepse roli i pedagogut dhe

psikologut është i jashtëzakonshëm në shkolla, jo vetëm për edukim, por edhe për socializim, edhe për evitimin e dukurive negative siç u përmend edhe sot dhuna në shkolla.

Ministria e Arsimit në planet e veta planifikon që secila shkollë publike ta ketë pedagogun, ta ketë psikologun, ta ketë koordinatorin për cilësi, i cili tanimë është i pranishëm, ta ketë ndoshta edhe sociologun, por në të ardhmen edhe mjekun, por unë dëshiroj të theksoj se ku jemi sot. Faktikisht, në Republikën e Kosovës, për nevojat e përgjigjes suaj, unë kam marrë shënimet nga SMIA që kemi 37 pedagogë dhe 37 psikologë në të gjitha shkollat, që është numër i vogël, por besoj që ju e dini se punësimi i pedagogëve dhe psikologëve është përgjegjësie e drejtpërdrejtë e komunave, e nivelit komunal, e DKA-ve.

Dhe ato duhet të punojnë që brenda grandit specifik, brenda buxhetit të komunave të parashohin, Ministria ua ka hapur derën që të parashtrajnë dhe të kërkojnë mjete për punësimin e pedagogëve dhe psikologëve. Gjithashtu, në bashkëpunim me USAID-in amerikan dhe me programin DEP, apo programin e edukimit bazik, ne e kemi krijuar një program për licencimin e pedagogëve dhe të psikologëve. Jemi në kontakte me Fakultetin e Edukimit që ta ofrojmë një proces të mirë të licencimit dhe kualifikimit të pedagogëve dhe të psikologëve, në mënyrë që secila shkollë e jona sa më shpejtë të ketë pedagogë dhe psikologë.

Unë them se në një periudhë profesioni i pedagogut ka qenë i rrezikuar, siç e dini edhe ju, dhe me përpjekjet e Ministrisë ne e kemi rikthyer pedagogun si një institucion të rëndësishëm brenda shkollës, e kemi paraparë që edhe psikologu duhet të jetë pjesë e pandashme e shkollës, por të gjithë duhet të punojmë që t'i mbështetim komunat në buxhet, sepse punëdhënësit e pedagogëve dhe psikologëve janë komunat. Të punojmë që t'ua rritim grandet specifike, jo vetëm për pagat e mësimdhënësve, por edhe për pagat e pedagogëve e të psikologëve, koordinatorëve për cilësi, dhe jemi në proces, sepse tanimë disa komuna sivjet kanë pranuar pedagogë dhe psikologë dhe Ministria do të punojë dhe do të llojë me tërë kapacitetin që të rriten fondet e komunave, që asnjë shkollë të mos mbetet pa këta punëtorë shumë të rëndësishëm profesionalë të shkollave.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Haskuka?

MYTAHER HASKUKA: E falënderoj ministrin për informatat që i dha dhe besoj që ky duhet të jetë njëri ndër prioritetet në të ardhmen që të punohet sa më shumë në rritjen e numrit të psikologëve dhe pedagogëve nëpër shkolla, duke i marrë parasysh të gjitha problemet që po paraqiten nëpër shkolla, nga përleshjet, dhuna dhe vrasjet, të cilat kanë ndodhur.

Besoj që kjo mund të ndikojë shumë pozitivisht në uljen e këtyre dukurive negative. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Time Kadriaj, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Kur që sjellë në Kuvend Ligji për veteranët e luftës patëm shpresuar dhe e përdorëm atë shprehjen “më mirë vonë sesa kurrë” dhe komisioni parlamentar ka punuar me përkushtim në amendamentimin e këtij ligji, në mënyrë që kjo kategori e cila ia solli dinjitetin Kosovës të vlerësohet dhe të trajtohet në mënyrë institucionale.

Mirëpo, edhe përkundër amendamentimit dhe aprovimit të ligjit në Kuvendin e Kosovës, ende ka pengesa në zbatimin e tij dhe edhe sot shumë veteranë po përballen me problemet, sepse nuk po u paguhet ajo çka u takon me ligj. Zoti ministër, kur do të fillojë të zbatohet kjo çështje dhe kur do ta kenë rastin të gjithë veteranët ta marrin pagën, e cila u takon sipas ligjeve në fuqi?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Qytetarë,

Faleminderit për pyetjen zonja Kadrijaj! Më lejoni të theksoj se vitin e kaluar së bashku me komisionin qeveritar, së bashku me përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta, ne e kemi hartuar buxhetin bazuar në informatat, të cilat i kemi marrë nga komisioni qeveritar për numrin e veteranëve luftëtarë të UÇK-së, të cilët kanë aplikuar dhe, ashtu siç e parasheh ligji, i plotësojnë kushtet për marrjen e pensionit të veteranit luftëtar të UÇK-së.

Të gjitha informacionet që i kemi pasur ne si Qeveri nga komisioni përkatës qeveritar është se ne e presim një fluks prej 12 000 - 14 000 veteranë luftëtarë të UÇK-së, të cilët nuk kanë të hyra personale bazuar në ligjin, prandaj edhe i plotësojnë kushtet që ta marrin këtë pension. Pas kësaj, pas këtyre negociatave, pas këtyre koordinimeve, ne e kemi hartuar buxhetin së bashku me Ministrinë e Financave, buxhet prej 25 milionë eurove, i cili i përmbush këto kërkesa.

Ajo çfarë ka ndodhur në ndërkohë me hapjen e procesit është se jashtë çdo parashikimi, numri i veteranëve luftëtarë, të cilët kanë aplikuar për pension, është dyfishuar. Realisht, numri i fundit i veteranëve luftëtarë të cilët i plotësojnë kushtet ligjore për ta marrë pensionin është 28 031.

Ne këtë çështje e kemi shtruar edhe në Qeveri, edhe në instancat tjera, dhe Ministria e Financave me një vendim ka reaguuar te ministria jonë dhe ka ndarë mjete shtesë prej 7 milionë euro për këtë kategori. Prandaj, tani i kemi diku rreth 32 milionë euro sa i përket këtij pensioni. Nuk është e vërtetë që nuk i marrin, të gjithë ata që i plotësojnë kushtet e marrin këtë pension dhe sfida është që të sigurohet buxheti deri në fund vitit, sepse me këtë fluks, në qoftë se i kemi 28 mijë, neve na duhen së paku edhe 15 700 000 euro, në qoftë se mbetet ai numër. Pra, fluksi është rritur, sikur edhe numri i atyre që aplikojnë është rritur nga muaji në muaj, prandaj edhe ky 15,7 milionë nuk do të jetë i mjaftueshëm.

Ne jemi në koordinim të vazhdueshëm, qoftë me Ministrinë e Financave, qoftë edhe me aktorë të tjerë që të gjejmë, qoftë mjete shtesë, qoftë forma tjera që ta mbulojmë këtë kërkesë ligjore.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete, pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Unë e di që një numër i veteranëve po i marrin beneficionet dhe nuk është mirë të bëhet lojë me një kategori të tillë.

Vitin e kaluar, ju e dini që janë ndarë diku 24 milionë dhe për shkak që s'ka filluar procesi i vlerësimit dhe procesi që të paguhen veteranët, këto para kanë shkuar dhe janë distribuuar në

sektorë të tjerë, ndërsa sot kjo Qeveri ka para për një Kabinet të ekzagjeruar, ka para për t'i paguar lukset e zyrtarëve qeveritarë, ndërsa s'ka para të sigurojë para për t'i paguar veteranët!

Unë po them që janë duke u paguar disa, por nuk janë duke u paguar të gjithë, dhe njëjtë, sikur ata që po paguhen, duhet edhe këta. Nuk është mirë të bëhet lojë me këtë kategori, sepse jemi vonuar diku për 17 vjet dhe e dimë se shumica e veteranëve janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, bile-bile kemi edhe numër të madh të veteranëve që janë vetëvrarë për shkak të gjendjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ka përfunduar ajo kohë! Vazhdoja 50 sekonda!

TIME KADRIJAJ: Dhe ministër, unë dëshiroj që ju dhe kërkoj që ju në çdo formë t'i siguronit paratë që të gjithë veteranët që e kanë marrë certifikatën e veteranëve të paguhen.

KRYESUESI: S'ke çfarë thua besoj, je dakord! Deputeti Mytaher Haskuka, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Ministri s'është këtu, dëshironi ta shtroni pyetjen? Zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Si zakonisht, ministri nuk është këtu, prandaj unë po e bëj pyetjen, ndoshta pastaj përgjigjet me shkrim.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në valën e privatizimeve e ka shitur shumicën e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, por edhe në shumë raste pagesat e punëtorëve të cilat njihen si 20% nuk janë realizuar në afatet e parapara, e në disa raste, si ajo e punëtorëve të gypave të Ferizajt, nuk janë realizuar fare.

AKP-ja po ashtu nuk i ka paguar pagat e punëtorëve, për të cilat ndërmarrjet u kanë mbetur borxh dhe të cilat janë obligime të AKP-së. Në rastet e fundit janë edhe punëtorët e ndërmarrjes "Liria" në Prizren, ku më shumë se 100 punëtorëve nuk u janë paguar 10 pagat e fundit, të cilat AKP-ja u ka mbetur borxh për më shumë se 6 muaj, nën pretekstin e problemeve në llogaritë bankare.

Po ashtu, për pagesat e pagave që janë bërë më herët, AKP-ja nuk i ka deponuar kontributet pensionale, e pasi këto kanë qenë paga, AKP-ja për çdo pagesë është dashur të paguajë për Trustin Pensional të Kosovës, ashtu siç kërkon ligji. Pyetja parlamentare është: Çfarë ka bërë Ministria e Zhvillimit Ekonomik në aspektin e mbikëqyrjes së AKP-së në implementimin e të drejtave të punëtorëve sipas Ligjit në fuqi? A ka ndonjë iniciativë të Qeverisë për të siguruar respektimin e të drejtave të punëtorëve karshi AKP-së për t'i parandaluar shkeljet e mëtutjeshme të të drejtave të punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore?

Domethënë, në këtë aspekt edhe javën e kaluar ne e patëm edhe një takim edhe me punëtorët e "Sharrcemit" të Hanit të Elezit, ku atyre po ashtu nga AKP-ja nuk u ishin paguar dëmshpërblimet për shëndetin e tyre të humbur gjatë punës të cilën e kanë bërë me azbest dhe për problemet tjera. Prandaj, besoj që Qeveria këtu duhet të punojë që AKP-ja t'i respektojë të drejtat e punëtorëve dhe të ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Margarita Kadriu, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Do ta bësh pyetjen? Regjia, fjalën zonjës Kadriu!

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Faleminderit!

Siç po e shohin edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, edhe përkundër faktit që pyetja parlamentare është bërë para një jave, më duhet ta bëj të qartë se ministri i sektorit më të rëndësishëm në Kosovë nuk e ka parë të arsyeshme të japë përgjigje për një çështje tepër urgjente, ku po rrezikojmë të humbim hiç më pak se 390 milionë euro në Arbitrazh.

Mospraninë e ministrit e shoh si ikje nga përgjegjësia, apo ndoshta nuk e ka guximin të flasë hapur për pyetjet, që do t'i lexoj në vijim:

Axos-Capital e ka paditur shtetin e Kosovës para gjyqtarit të Arbitrazhit në Washington. Axos-Capital kërkon nga Kosova hiç më pak se 390 milionë euro. Pra, rrezikojmë të humbim afro 400 milionë euro për një proces të përcjellë me dyshime, akuza e plot prapaskena. Kjo do të ishte një goditje e rëndë dhe e tmerrshme financiare.

Ju si ministër, edhe pse nuk jeni i pranishëm, mund të ktheni përgjigje me shkrim apo t'i informoni qytetarët në formën të cilën ju e preferoni. A e keni analizuar se kush në ministrinë që ju e udhëhiqni ka qenë përgjegjës dhe duhet të japë përgjegjësi për rrezikun e humbjes edhe të gati 400 milionë eurove të tatimpaguesve kosovarë?

Çka tash, nëse Kosova e humb kontestin në fjalë, si në rastin e tenderit të pasaportave dhe detyrohet të paguajë edhe 390 milionë euro, një shumë sa ¼-ta e buxhetit? Kush është personi përgjegjës juridikisht për këtë? Ku qëndron baza e padisë së Axos-it dhe kë e keni angazhuar për mbrojtje, si dhe sa para e keni kontraktuar? Faleminderit!

KRYEUSESI: Faleminderit! Deputetja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Abrashi.

AIDA DËRGUTI: Zoti ministër,

Nga mbledhja e parë e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, më 11 janar 2014, dhe marrëveshjeve të dakorduara, Qeveria në Tiranë mori vendim më datë 7 maj 2014 për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë, të përkatësisë etnike shqiptare.

Në mars 2015, pra një vit më vonë, ministria juaj njoftonte se u firmosën tri marrëveshje bashkëpunimi me Shqipërinë. Nënshkrimi është bërë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Velijaj, dhe homologu i tij kosovar, Arban Abrashi. Më konkretisht, u arrit marrëveshja për heqjen e lejeve të punës dhe liberalizimin e tregut të punës ndërmjet dy vendeve, nga Gjirokastra deri në Mitrovicë.

Shqipëria i ka hequr lejet e punës për shtetasit kosovarë, ndërsa Kosova u zotua ta bëjë këtë shumë shpejt për shtetasit shqiptarë.

Po ashtu, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Kursimeve Pensionale të Republikës së Kosovës, me të cilin u ra dakord edhe për nisjen e bisedimeve për njohjen e kontributeve të pensioneve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Marrëveshja e tretë u arrit për qendrat e formimit profesional, ku të rinjtë shqiptarë nga zonat e Hasit dhe Kukësit mund t'i ndjekin qendrat profesionale pa pagesë në Kosovë.

Zoti ministër,

Pse nuk po e zbatoni marrëveshjen me Republikën e Shqipërisë për heqjen e lejeve të punës për shtetasit e Shqipërisë dhe shqiptarët që jetojnë në shtetet tjera të rajonit, si dhe pse nuk i keni nisur ende bisedimet për njohjen e pensioneve Kosovë-Shqipëri?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Deputete Dërguti, faleminderit për pyetjen!

Një shpjegim i thjeshtë: Që nga shtatori i vitit 2013 është në fuqi Ligji për të huajt, i cili i rregullon kushtet, lëvizjet, qëndrimin dhe punësimin e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës dhe në bazë të ligjit në fjalë, mandatin për lëshimin e lejeve të punës, lejeqëndrimin për punë e ka Ministria e Punëve të Brendshme.

Ky ligj, sipas informatave, edhe për shkak të lotimit tonë si ministri, është në proces të plotësimit, prandaj edhe është sponsorizues i heqjes së lejeve të punës, prandaj ne shpresojmë, pasi është edhe në procedurë, se shumë shpejt do të arrihet kjo. Por, besoj që kjo pyetje duhet t'i takojë më shumë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ne e kemi kryer pjesën tonë dhe ne jemi pjesë e grupeve punuese në kuadër të ligjit, i cili tani është duke u sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe i kemi dhënë idetë konkrete se si duhet që në kuadër të marrëveshjes me Shqipërinë të lehtësohet edhe procesi i punësimit të qytetarëve të Shqipërisë në Kosovë.

Sa u përket marrëveshjeve dhe pikave tjera që i përmendët, sa i përket punës, në kuadër të marrëveshjes për shfrytëzimin e qendrave të aftësimit profesional nga qytetarët e Shqipërisë, kjo marrëveshje është në funksion të plotë dhe tani disa dhjetëra qytetarë të Shqipërisë, posaçërisht rrethet e Kukësit, Bajram Currit, e tjera, i shfrytëzojnë qendrat e aftësimit profesional të ministrisë sonë në Gjakovë, Prizren dhe rrjedhimisht në Pejë. Atë që e kemi vërejtur gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, kur veç ka filluar të zbatohet kjo marrëveshje, është që një numër i madh i tyre për shkak të pamundësive të transportit nuk kanë mundësi t'i ndjekin kurset tona, por veç kanë filluar t'i ndjekin. Jemi duke punuar që të sigurojmë transport, aq sa ka mundësi, në kuadër të mundësive tona buxhetore, edhe për të interesuar tjerë.

Dhe, pika e fundit që ka të bëjë me marrëveshjen rreth pensioneve - ne e kemi kaluar edhe në Qeveri nismën për marrëveshjen me Republikën e Shqipërisë sa i përket njohjes së përvojës së

punës, ashtu siç u kërkua nga vetë autoritetet e Shqipërisë për përvojën e punës të shtetasve të Shqipërisë që e kanë pasur në Kosovë dhe anasjelltas dhe besoj që në periudhë prej një muaji, një muaj e gjysmë, të mos përmend tash edhe afate kohore, ne do ta kemi të nënshkruar edhe marrëveshjen. Grupet punuese tashmë e kanë filluar punën, nisma ka kaluar në Qeveri dhe besojmë që diku rreth nëntorit realisht do ta nënshkruajmë atë. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë? Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministren Dhurata Hoxha. Ministria s'është këtu, keni mundësi të flisni. Zonjës Haxhiu fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari më duhet të them që si duket ministria Hoxha po e vazhdon avazin e zotit Kuçi, për faktin se jo vetëm se po mungon edhe në këtë seancë plenare në kohën e pyetjeve parlamentare, por kështu bëri edhe para dy ditëve në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe, natyrisht, se kjo tregon se ka pasur vetëm ndryshim të personit, e jo ndryshim të mendësisë politike.

Megjithatë, edhe pse s'është ministria këtu, unë po e parashtroj pyetjen. Shpresoj se në seancën e ardhshme do të jetë para deputetëve dhe të përgjigjet në pyetjet parlamentare.

Më 13 korrik të këtij viti, zonja Hoxha e ka marrë përsipër udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë. Në një konferencë para gazetarëve, e njëjta ka deklaruar se do të angazhohet në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Pyetja parlamentare është: Çfarë ka menduar ministria Hoxha kur ka deklaruar diçka të tillë dhe cilat do të jenë angazhimet e saj, apo çfarë saktësisht do të bëjë zonja Hoxha në këtë drejtim?

Unë pres përgjigjen në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sali Salihu, pyetje për ministrin Krasniqi. Ministri as deputeti më duket nuk qenkan këtu. Deputetja Selviqe Halimi, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. A është këtu ministri? S'është! Zonja Selviqe Halimi e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Unë sot, meqenëse s'janë ministrat, as në rastin e parë, as tash, unë vetëm çështjen do ta theksoj sot.

Çështja që ka të bëjë me pyetjen që do t'ia shtroja ministrit në seancën e radhës është se në kohën e të reshurave shumë rrugë rajonale dhe magjistrale të Kosovës, duke shkuar edhe në ato lokale, që besoj se duhet t'i mbikëqyrë ministria, po shndërrohen në ujëmbledhës dhe po paraqesin vështirësi në qarkullim, duke e shtuar rrezikun dhe gjithashtu duke i dëmtuar edhe rrugët nëpër Kosovë.

Andaj, për shkak të kësaj dukurie e kemi një rritje edhe të aksidenteve, por edhe një rrezikshmëri të përgjithshme. Do të thotë, sot e shtrova vetëm si çështje, pyetjen në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Hyseni.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Meqë ministri nuk është i pranishëm, pyetja ime do të shtyhet për javën tjetër, ose për seancën e radhës, meqë nuk i humb relevanca. Kështu që me kënaqësi këtë pyetje do t'ia drejtoj ministrit kur të jetë i pranishëm, sepse besoj se qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të marrin informacion nga ministri drejtpërdrejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për ministren Edita Tahiri.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Para pesë vjetëve, në korrik të vitit 2011, u propagandua si një arritje e jashtëzakonshme marrëveshja e quajtur atëherë “lëvizja e lirë”. Por, nga teksti i asaj, u kuptua se në fakt ishte një problem i ri për shtetësinë e Kosovës. Saktësisht, në pikën 9 të asaj marrëveshjeje thuhej se si masë kalimtare për cilindo pronar automjeteve që dëshiron do të vihen në dispozicion edhe targat e përkohshme në kalimet kufitare, respektivisht administrative. Pra, kufiri shtetëror i Kosovës u rishfaq me dokument si një i kontestuar, pra jo si kufi shtetëror. Ndërsa, termin në thonjëza “dëshiron”, në praktikë u pa që ishte një detyrim në pikat kufitare me Serbinë. Në to qytetarëve dhe zyrtarëve nga Kosova ua hoqën targat dhe ua mbuluan simbolet e shtetit të Kosovës.

Në marrëveshjen e 14 shtatorit 2016 thuhet “palët janë pajtuar që të mbulohen pjesët relevante të tabelave respektive të automjeteve me dy letërngjitëse të bardha”. Kurse, pika pasuese thotë: “ky sistem me letërngjitëse do të hyjë në fuqi më 15 nëntor të vitit 2016”. Pra, targat provuese nuk po hiqen, siç thuhet, për të dyja palët, sepse edhe ashtu kanë qenë të zbatueshme vetëm nga njëra palë, pra nga pala e Serbisë karshi targave të shtetasve të Republikës së Kosovës.

E dyta, prapë kjo marrëveshje nuk është reciproke, sepse ky regjim i mbulesës së simboleve të Serbisë nuk po vlen për serbët e Kosovës.

E treta, nuk dihet pse do të vazhdohet edhe për pesë vjet të tjera lëshimi i targave me shenjën KS... Aktualisht, në Republikën e Kosovës janë katër lloj targash, pra ato RKS, KS, PROVA dhe targat ilegale, apo të lëshuara nga strukturat ilegale të Republikës së Serbisë brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Pyetja është kjo: Me çfarë mandati, mbi cilën bazë të ligjit, rezolutë apo vendim të cilit institucion negocion për këto çështje dhe shtyn afate të dokumenteve dhe shenjave zyrtare të Republikës së Kosovës?

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar deputet Selimi,

Marrëveshja për lëvizjen e lirë, e arritur më 14 shtator 2016, në Bruksel, është marrëveshje për zbatimin e reciprocitetit në tabelat e automjeteve ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Reciprociteti është parimi bazë i të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialogun e Brukselit, me ndërmjetësimin dhe garancitë e Bashkimit Evropian dhe me mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara Amerikës. Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë këmbëngulëse dhe e vendosur në parimin e reciprocitetit në të gjitha marrëveshjet e arritura në Bruksel, pra edhe në këtë marrëveshje për reciprocitet në tabela.

Marrëveshja për reciprocitet në tabelat e automjeteve ndërmjet dy shteteve përcakton se ajo çfarë vlen për tabelat e veturave të një shteti do të vlejë edhe për tabelat e veturave të shtetit tjetër. Kjo marrëveshje u jep fund tabelave “Prova”, që Serbia kishte përdorur njëanshëm ndaj tabelave RKS gjatë hyrjes në Serbi dhe kjo marrëveshje hyn në fuqi më 15 nëntor 2015. Pra, që nga 15 nëntori veturat e Kosovës me tabelat RKS mund të hyjnë në Serbi dhe nuk do të kenë nevojë t’i heqin këto tabela dhe t’i zëvendësojnë me “Prova”, dhe as nuk do të paguajnë asnjë tarifë tash e tutje.

Ndërsa, veturat e Serbisë tashmë i nënshtrohen reciprocitetit gjatë hyrjes në Kosovë. Reciprociteti në tabelat e automjeteve do të zbatohet me një model të letrave ngjitëse për të dyja shtetet, sipas modelit që përdoret në rastin Maqedoni-Greqi. Mirëpo, në rastin Maqedoni-Greqi vetëm Greqia i aplikon njëanshëm këto letra ngjitëse, ndërsa marrëveshja që kemi arritur tani me Serbinë të dyja shtetet aplikojnë letrat ngjitëse, që për mendimin tim është një arritje shumë e rëndësishme në planin e marrëdhënieve reciproke bilaterale.

Siç mund ta dini, kjo marrëveshje ishte arritur një javë më herët se data 14 shtator dhe unë e kisha bërë publike marrëveshjen, sepse kam pasur parasysh që qytetarët e Kosovës kanë qenë të nervozuar dhe frustruar me këto tabela “Prova”, prandaj kam dashur ta jap lajmin e mirë menjëherë. Dhe, ashtu siç e paralajmërova pastaj më datën 14 shtator u vërtetua.

Rëndësia e kësaj marrëveshjeje është se, përveçse lehtësojmë tutje qarkullimin e lirë të qytetarëve, kjo marrëveshje pas shtatëmbëdhjetë vjetësh i detyron veturat e Serbisë që t’i nënshtrohen reciprocitetit në raport me shtetin e Kosovës. Pra, veturat e Serbisë që kanë qarkulluar të papenguara në territorin e Kosovës për shumë vjet, tani e tutje do ta respektojnë regjimin reciprok. Po ashtu, kjo marrëveshje u jep fund tabelave ilegale të automjeteve, të cilat aty-këtu kanë mbetur në qarkullim në pjesën veriore të vendit tonë. Fjala është për tabelat ilegale të kohës së ish-Jugosllavisë dhe për 12 muaj edhe këto tabela do të hiqen nga qarkullimi.

Po ashtu, mund t’ju informoj që Qeveria e Republikës së Kosovës po përgatit hapjen e zyrave të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe zyrave të Gjendjes Civile dhe që nga nëntori ne do të fillojmë t’i pajisim qytetarët e pjesës veriore të vendit tonë me të gjitha dokumentet e shtetësisë, prej pasaportave, lejeve të njoftimit, deri te certifikatat e lindjes dhe të gjitha tjerat, që për mendimin tonë si Qeveri është konsolidim i rëndësishëm i sovranitetit në këtë pjesë të vendit, sepse siç e dini, në veri për shumë vjet nuk ka pasur zyra të tilla dhe në këtë marrëveshje që e kemi arritur më 14 shtator Serbia është pajtuar që të mos pengojë serbët që të punojnë në këto zyra, të cilat tanimë i kemi rekrutuar.

Sa i takon zgjatjes edhe për pesë vjet të tabelave KS, kjo është bërë me qëllim që t’i stimulojmë këta serbë të cilët ende mbajnë tabela ilegale nëpër automjetet e tyre që t’i heqin ato dhe të mund të kalojnë në tabela legale. Ndërsa, pse nuk vlen regjimi i letrave ngjitëse në këto tabela ilegale,

është sepse ato janë tabela ilegale dhe duke aplikuar modelin e letrave ngjitëse ne në një mënyrë do t'i pranoni si tabela legale. Prandaj, për 12 muaj ato hiqen nga qarkullimi.

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Selimi?

REXHEP SELIMI: Ju e përmendët reciprocitetin, por nuk po duket diku në sfond. Dua t'ua bëj një pyetje konkrete atëherë, në bazë të asaj çfarë keni shkruar në këtë marrëveshje:

Kur thoni se të dyja palët ranë dakord për mbulesën e pjesëve përkatëse të targave me letër ngjitëse, është një pasus këtu, që kërkoj nga ju të na shpjegoni saktësisht se çfarë keni dashur të thoni. "Targat e përdorura nga banorët e Kosovës nuk do të ndikohen nga ky regjim i letërngjitëses", çfarë keni dashur të thoni me këtë?

Normalisht që prapë nuk mora përgjigjen se përse edhe pesë vjet, pse duhet thjesht të merren me të mirë, edhe pasi që është arritur, siç thoni ju, një marrëveshje për reciprocitet, pra pesë vjet prapë me targa KS.

Dhe, në anën tjetër, pse brenda kësaj marrëveshjeje ju nuk keni paraparë edhe shuarjen, ose vazhdimin e shuarjes së institucioneve paralele dhe produktit të saj, siç janë tabelat me targa KM... e të tjera që vazhdojnë të qarkullojnë në pjesën veriore të Mitrovicës, apo në pjesën veriore të Kosovës, në përgjithësi. Dhe, atyre targave ju kisha lutur që të mos u referoheni si targa të ish-Jugosllavisë, sepse ato nuk e kanë yllin në mes, ato e kanë stemën e Serbisë së sotme. Kështu që, ato targa nuk janë të ish-Jugosllavisë, ato targa janë të Serbisë, ku Serbia brenda legjislacionit të vet e parasheh edhe Mitrovicën dhe vendet tjera.

Prandaj, t'u them edhe një herë, çfarë keni dashur të thoni me pasuset të cilat i përmenda unë, që kjo nuk vlen për qytetarët në Republikën e Kosovës? Kush janë këta qytetarë, që nuk vlen ky reciprocitet, ose ky regjimi i letrave ngjitëse?

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, deputet Selimi!

E para, pse është dashur të zbatohet ky regjimi reciprok, por i letrave ngjitëse? Të dyja shtetet, Kosova dhe Serbia, ende nuk kanë njohje reciproke ndërmjet vete dhe kjo është arsyeja pse u desh të gjendet një modalitet i këtillë. Ngjashëm e kemi rastin e Maqedonisë me Greqinë. Meqenëse Greqia nuk e njeh emrin e Maqedonisë, atëherë në tabelat e Maqedonisë vendos letra ngjitëse, për të treguar që ka mosnjohje për emrin.

Sa u takon tabelave ilegale, keni të drejtë, janë tabela të strukturave ilegale të Serbisë. Unë i përdora të ish-Jugosllavisë, sepse ashtu janë quajtur këto qytete si GL..., KM..., e të tjera, por ju keni të drejtë. Tani për 12 muaj këto tabela do të hiqen nga qarkullimi, ndërsa prej vitit 2011 janë hequr tashmë 8 mijë, por edhe disa të tjerë serbë kanë refuzuar t'i heqin dhe me këto tabela kur hiqen, tashmë qarkullimi në Kosovë do të jetë pa tabela ilegale dhe automatikisht edhe këto struktura që kanë dhënë këso tabelash, por edhe ato çfarë janë ato certifikatat e qarkullimit të automjeteve shuhen, sepse po i hapim zyrat e gjendjes civile dhe të regjistrimit civil dhe këto zyra do t'i pajisim tashmë me të gjitha dokumentet e shtetësisë, përfshirë edhe lejet e vozitjes, lejet e

qarkullimit të automjeteve e të tjera, që është në kuadër të këtyre zyrave të regjistrimit civil dhe gjendjes civile.

Pse në këto tabela nuk aplikohet sistemi i letrave ngjitëse, sepse janë tabela ilegale. Nëse do t'i mbulonim do t'i konsideronim legale, do të kishim pengesa legale.

Kush ka qenë delegacioni në këtë marrëveshje dhe kush është kompetent, sipas institucioneve? Që nga viti 2011, kur e kemi arritur marrëveshjen për lëvizjen e lirë, siç e thatë edhe ju, deputet Selimi, ku është përcaktuar reciprociteti, pra reciprociteti tash vetëm po zbatohet, ndërsa më 2011 është arritur në marrëveshjen për lëvizjen e lirë. Pjesëtarët e grupit punues qeveritarë janë përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe të Policisë së Kosovës, si institucione kompetente për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka pyetje tjera të shtruara nga deputetët.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që është:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Pyes deputetët nëse kanë vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 1 shtator 2016? Nuk ka. Atëherë, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 1 shtator 2016.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 04/L-168

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin Abrashi që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale ka për qëllim rritjen dhe qartësimin e tavanit të lejuar të investimit të mjeteve të fondit në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky projektligj synon të adresojë edhe disa çështje tjera lidhur me çështjen menaxheriale të fondit pensional.

Sipas ligjit në fuqi, neni 9.10, fondi brenda vitit kalendarik mund të investojë jo më shumë se 50% të kontributeve bruto të vitit të kaluar, pa e specifikuar nëse fjala është vetëm për investime të reja apo investime të reja dhe rifinancime të investimeve që maturojnë.

Sipas nenit të ri të propozuar, investimi përfshin investime të reja, ndërsa rifinancimi nuk definohet si investim i ri. Me këtë qartësim de fakto do të rritet vlera e investimeve në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës, meqë interpretimi i Trustit për nenin 9.10 ka qenë konservator.

Në anën tjetër, projektligji parasheh edhe zgjerimin e bazës së instrumenteve tjera të lejuara për investim, në veçanti letrat me vlerë të korporatave, ose institucioneve financiare ndërkombëtare depozita të afatizuara në bankat vendore dhe ndërkombëtare, fonde, investime dhe marrëveshje të riblerjes.

Projektligji synon t'i rregullojë edhe disa nene të ligjit bazik lidhur me mandatin dhe funksionimin e bordit. Po ashtu, synohet të rregullohet komiteti i auditimit, fushë e cila deri më tani nuk ka qenë e rregulluar me ligj, mirëpo ka funksionuar vetëm në bazë të praktikave të mira të qeverisjes, ose korporatave financiare.

Në bazë të vlerësimeve të Ministrisë së Financave, implementimi i këtij projektligji nuk do të sjellë kosto shtesë financiare për institucionet e zbatimit të ligjit.

Me këtë projektligj Ministria e Financave ka zhvilluar konsultimet publike dhe paraprake. Meqë të gjitha palët e interesuara kanë qenë të përfshira në hartimin e këtij projektligji, sikurse Trusti dhe BQK-ja, të gjitha çështjet janë adresuar gjatë hartimit të draftit fillestar të projektligjit.

Gjatë fazës së konsultimeve, Ministria e Financave ka pranuar komente vetëm nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Komentet dhe vlerësimet e tyre janë të paraqitura në shtojcën e projektligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Fondit Pensional ka për qëllim kryesor rritjen e tavanit të investimeve të mjeteve të Fondit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si dhe zgjerimin e bazës së instrumenteve të tjera të lejuara për investim, në veçanti të letrave me vlerë të korporatave ose institucioneve financiare ndërkombëtare, depozita të afatizuara në banka vendëse dhe ndërkombëtare, fonde investive dhe marrëveshje të riblerjes.

Projektligji po ashtu bën disa ndryshime sa i përket përzgjedhjes dhe mandatit të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale. Është propozuar rregullimi i çështjes së mjeteve pensionale të paadresë apo të paidentifikuara nga ana e punëdhënësve, e cila çështje është ngritur si shqetësim nga Komisioni dhe Kuvendi me rastin e shqyrtimit të raporteve vjetore të Fondit Pensional.

Për të qenë deputetët më saktë të informuar, fjala është për 9,5 milionë euro të cilat nuk kanë adresë të kontributdhënësve, por është një përmirësim i dukshëm, sepse para disa viteve kjo shumë ka qenë 21 milionë dhe me korrigjimin apo identifikimin e tyre, tani kemi të bëjmë me këtë shumë prej 9,5 milionë.

Ndryshimet e tjera janë propozuar në çështjen e informimit të kontributdhënësve, ku është paraparë që vetëm pjesëmarrësit aktivë që kanë pasur transaksione brenda një viti kalendarik do të informohen në baza vjetore, kurse pjesëmarrësit, të cilët nuk kanë pasur transaksione në llogarinë e tyre individuale, pranojnë raporte së paku 3 vjet pas raportimit të fundit që e kanë pranuar.

Është shtuar një nen i ri, i cili rregullon çështjen e emërimit dhe funksionimit të Komitetit të Auditimit. Deri tani kjo fushë nuk ka qenë fare e rregulluar me ligj, por ka funksionuar vetëm në bazë të praktikave të mira të qeverisjes ose korporatave financiare, por nuk është saktësuar numri i anëtarëve të Komitetit.

Projektligji si i tillë përmban memorandumin shpjegues për objektiva që synon t'i realizojë ligji.

Po ashtu, projektligji përmban edhe opinionin për ndikimin buxhetor që vlerësohet se Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondin Pensional të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar në Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Ligjin Nr. 04/L-168 nuk do të ketë kosto buxhetore shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Fondin Pensional të Kosovës dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet formale-juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit.

Gjithashtu në komision janë ngritur disa çështje në disa nene të projektligjit, të cilat kanë nevojë për ndryshim dhe plotësim, e të cilat do të analizohen dhe trajtohen gjatë amendamentimit.

Komisioni i rekomandon Kuvendit që të miratojë projektligjin në leximin e parë dhe rekomandimet e propozimet që dalin gjatë shqyrtimit të sotëm do t'i trajtojë gjatë amendamentimit të projektligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani! Radha është e kryetarëve ose e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Buja e ka fjalën.

SHUKRI BUJA: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah aprovimin e Projektligjit 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondin Pensional të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115 dhe Ligjin 04/L-168. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, besoj se është dakord me Naserin?

Grupi Parlamentar Vetëvendosje! Fjalën e ka zonja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Është më se e qartë se Ligji për pensionet, gjegjësisht i gjithë sistemi pensional në Kosovë ka nevojë për ndryshim dhe reformim, por ky projektligj nuk i plotëson të gjitha nevojat që duhet për ta rregulluar këtë fushë që është mjaft e ndjeshme, por edhe mjaft e rëndësishme.

Për më tepër, ky ligj, duke filluar nga vetë emri është gabim, sepse ky do të duhej të quhej Ligji për Fondin e Kursimeve Pensionale, e jo siç është i emëruar tani - për fondet pensionale.

Mirëpo, është e papranueshme, në fakt, qasja e Qeverisë dhe mënyra e amendamentimit të ligjeve, dhe të këtij ligji konkretisht. Amendamentimet nëpër ligje po bëhen pa një analizë paraprake, në baza ad-hoc, kur Qeverisë i duhet për interes të vetin, e jo për interesa të qytetarit, siç është, për shembull, edhe me këtë projektligj.

Gjatë legjislaturës së kaluar dy herë Kuvendi është marr me këtë projektligj brenda një viti. Ta zëmë, ky ligj, si i tillë është miratuar në mars të vitit 2012 dhe është amendamentuar një vit më vonë, pra në mars të vitit 2013.

Kjo tregon se qeveria e mëhershme nuk ka pasur vizion të qartë se si ta rregullojë çështjen e fondeve të kursimeve. Por, edhe kjo Qeveri, në fakt, nuk është treguar aspak më vizionare, bile edhe më keq akoma.

Ndryshimet e propozuara nuk krijojnë më shumë siguri për kursimet e kontribuesve të Fondit, përkundrazi Qeveria po synon të marrë më shumë para nga Trusti, por pa e bërë të qartë se si dhe ku dëshiron t'i investojë këto para.

Dhe, ndonëse në memorandumin shpjegues thuhet se me këto ndryshime synohet qëllimi i inkuadrimit të ndryshimeve të nevojshme për rritjen e tavanit të investimeve të mjeteve të Fondit në letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në fakt janë prekur edhe çështje të tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me qëllimin të cilin Qeveria e ka përshkruar në memorandumin shpjegues.

Ta zëmë, neni 2 i këtij projektligji rregullon mënyrën e zgjedhjes së Bordit menaxhues të Fondit të Kursimeve. Përbërja e Komisionit përzgjedhës vetëm nga guvernatori i BQK-ës, ministri i Financave dhe Auditori i Përgjithshëm ka bazë për konflikt interesi, e në veçanti përfshirja e guvernatorit të Bankës Qendrore, i cili ka autoritet mbikëqyrës mbi institucionet financiare, ku bën pjesë edhe Trusti dhe ministri i Financave, pasi që fondi blen letra me vlerë të lëshuara nga kjo Ministri në emër të Qeverisë.

Kemi mjaft shembuj si mund të rregullohet përzgjedhja e kandidatëve për borde të institucioneve të pavarura që i përgjigjen Kuvendit, prandaj kjo mund të rregullohet ndryshe. Për shembull, përzgjedhja të bëhet nga një komision ad hoc i Kuvendit, ndërsa institucionet e lartpërmendura të kenë rol këshillëdhënës dhe të ofrojnë mbështetje profesionale, ose Komisioni përzgjedhës të jetë i kombinuar nga Kuvendi dhe nga përfaqësuesit e institucioneve të lartpërmendura. Por, problemi më i madh i këtij projektligji është neni 3, i cili ndryshon paragrafin 7, pika 11 të ligjit bazik. Paratë të cilat i menaxhon Trusti janë të kontribuesve dhe assesi Qeveria nuk guxon t'i fusë duart në këto para, e për më tepër t'i inkasojë ato nëse pas 6 vjetëve nuk identifikohet paguesi i kontributit. Kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të lejohet. Në fakt, Kuvendi duhet të bëjë më shumë presion mbi institucionet përgjegjëse, siç është Administrata Tatimore, që sa më shpejt t'i identifikojë paguesit e kontributit pensional dhe paratë t'u shpërndahen në llogari këtyre kontribuesve, e jo të lejojë që Qeveria të tentojë t'i marrë për qëllime të veta.

Këto para, të cilat kanë përfunduar te Trusti Pensional, nuk kanë ardhur aty përmes zarfave anonime. Ato kanë ardhur përmes një xhirollogarie bankare. Kjo xhirollogari bankare domosdoshmërisht është e lidhur me një biznes dhe ky biznes domosdoshmërisht ka një titullar, pra ka një pronar, i cili po ashtu ka një numër personal identifikues. Prandaj, administrata, bashkë me Trustin dhe institucionet e tjera, duhet të ndërmarrin një fushatë për t'i gjetur se të kujt janë këto para dhe pastaj ato t'i derdhë në xhirollogari të tyre. Kjo mund të bëhet, ta zëmë, me një fushatë jo më shumë se një vit, dhe kështu këto para të përfundojnë te kontribuuesit, të cilët në fund do të mund t'i gëzojnë pensionet.

Lëvizja Vetëvendosje vlerëson se Ligji për Fondin Pensional ka nevojë të ndryshohet dhe atë duke filluar nga vetë emri, prandaj i propozon Qeverisë që ta tërheqë draftin aktual dhe duke marrë parasysh edhe vërejtjet e dhëna, të përmirësojë projektligjin, duke bërë edhe ndryshime e tjera të nevojshme, përfshirë këtu edhe rekomandimet të cilat vetë Trusti Pensional i ka dhënë dhe pastaj ta sjellë për procedim në Kuvend.

Lëvizja Vetëvendosje do ta japë përkrahjen e vet për këtë projektligj kur të sigurohet se ndryshimet e bëra rrisin sigurinë e kontribuuesve të këtij fondi, e jo interesin e Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bali Muharremaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues,
Të nderuar deputetë,
Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës, në parim, do ta përkrahë këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Simiq, në emër të Listës serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!
Poslanička grupa Srpske liste razmotrila je Nacrt zakona o penzijskim fondovima, i mi ćemo u načelu podržati izmene i dopune ovog zakona i glasaćemo za. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma".

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!
Po ashtu deputetët e "Nismës", të cilët do të jenë në komisionet përkatëse do të japin kontributin e tyre, por shpresoj që ky projektligj njëherë e mirë të rregullohet ashtu siç duhet dhe të mos silltet nga një legjislaturë në legjislaturën e radhës dhe të ketë çdoherë amendamente. Pra, le t'i bëjmë ligjet një herë e përgjithmonë dhe t'i kompletojmë, e jo të mbesin me vite të tëra, të mbeten barrë dhe pa u krye ashtu siç duhet.

Prandaj, kontributin tonë do ta japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Qerim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar "6+".

ĆERIM BAJRAMI: Hvala predsedavajući!

I naša Grupa će dati svoj doprinos preko Funkcionalne komisije, uzimajući u obzir da je ovaj zakon od velike važnosti za sve građane Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Radha është e deputetëve të paraqitur. Zoti Besim Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Unë e kam shikuar me kujdes propozimin për ndryshimin e Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale dhe duke mirëkuptuar orientimin e Qeverisë që e ka për të lehtësuar mundësitë për investime në tregun e Republikës së Kosovës dhe duke hapur rrugë që një pjesë e këtyre mjeteve të përdoren në Republikën e Kosovës, dua të ngre edhe një shqetësim timin që ka të bëjë me sigurinë e mjeteve të Fondit të Kursimeve Pensionale.

Mjetet e kursimeve pensionale janë para të qytetarëve të Republikës së Kosovës, janë para, të cilat nuk i nënshtrohen në asnjë rrethanë parasë publike, janë para të cilat në mënyrë shumë të kujdesshme shteti duhet të ketë parasysh se nuk mund të marrë vendime, të cilat do të mund ta rrezikonin sigurinë e të investuarit.

Normalisht, fondet si të tilla kërkojnë një siguri për investim, jo investime të drejtpërdrejta nëpër projekte të caktuara. Unë e kam parë aty që nganjëherë tentohet të jepet përshtypja se mund të investohet në letra me vlerë dhe në nivele të drejtpërdrejta dhe kjo nuk duhet të jetë në asnjë rrethanë rezultat. Çdo investim që bëhet në tregun e Republikës së Kosovës duhet të jetë në mënyrë strikte i mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Kosovës. Ndërsa, sa i përket rifinancimeve dhe huazimeve, të cilat parimisht janë bërë me vite të tëra, gjithashtu duhet të kemi një dozë konservatizmi.

Prandaj, besoj se në mes të dy leximeve do të sqarohen shumë më shumë të gjitha këto gjëra, por duhet të kemi parasysh se shteti, Qeveria, Kuvendi dhe të gjithë kanë përgjegjësi të plotë për sigurinë e mjeteve të kursimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Qeveria e Kosovës ka sjellë në Kuvend Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pensionet.

Besoj se shumë pensionistë që janë duke shikuar sot punimet e Kuvendit kanë shpresa të mëdha se do të ndryshojë ligji në të mirën e tyre dhe një pjesë mund të ketë edhe të tillë që mendojnë se do të rriten pensionet.

Këto janë pritje të kuptueshme kur kemi parasysh situatën e rëndë në të cilën ndodhen pensionistët e Kosovës dhe aq më shumë kur sipas hulumtimeve të Iniciativës kosovare për stabilitet, 86% e pensionistëve të anketuar tregojnë që me pensionet që i marrin ata nuk mund t'i

sigurojnë as barnat, ndërsa 69% e atyre të cilët janë kontaktuar dhe janë pjesë e këtij hulumtimi tregojnë që janë barrë e familjes për t'i përmbushur obligimet shëndetësore.

Projektligji, të cilin ne sot po e diskutojmë, nuk ka për qëllim përmirësimin e pozitës së pensionistëve, por ky ligj ka për qëllim përmirësimin e pozitës së Qeverisë së Kosovës përmes rritjes së buxhetit nga paratë e kursyera të pensionistëve.

Ky është, pra, qëllimi i ndryshimit të këtij ligji. Qeveria dëshiron të vërë dorë mbi paratë e kursyera të pensionistëve të Kosovës. Pas privatizimit të fabrikave në Kosovë, pas shkatërrimit të ekonomisë së Kosovës, pas keqpërdorimeve të mëdha që janë bërë në këtë vend, Qeveria dëshiron tash që edhe paratë e kursyera të pensionistëve t'i shfrytëzojë në mënyrën që i ka shfrytëzuar të gjitha resurset e Kosovës dhe këtë ligji e vërteton me nenin 2, me nenin 3, pika 7.11, nenin 4, pika 9.9, e kështu me radhë.

Me këto pensione që ne i kemi sot nuk mund të sigurojmë ekzistencën e pensionistëve në Kosovë dhe kjo mjerisht edhe 16 vjet pas përfundimit të luftës. Shtylla e parë e sistemit tonë pensional financohet nga buxheti i shtetit, në vend që të përdoret sistemi i parimit të solidaritetit mes gjeneratave, siç e ka propozuar apo siç e ka Lëvizja Vetëvendosje në programin e saj qeverisës.

Nuk është se po zbulojmë diçka të re. Ky është një sistem, i cili përdoret prej kohës së Bizmarkut, ku gjenerata e cila punon sot i derdh mjetet në një fond dhe ai fond përdoret për gjeneratën, e cila është sot e pensionuar, dhe kjo është shtylla kryesore në të gjitha vendet ku çështja e pensioneve funksionon.

Unë e di që ju nuk keni alternativë sa i përket pensioneve, sepse sikur të kishit, do ta kishit prezantuar në Kuvend. Në fakt, nuk keni fare të interesuar. Lëvizja Vetëvendosje ka një alternativë sa i përket kësaj. Ne konsiderojmë se kontributet e pensionistëve duhet të rriten nga 5 në 8%, pjesa prej 3 plus 3% mund të derdhet në një fond, i cili siguron rreth 80 milionë në vit, apo 6.7 milionë në muaj dhe me këtë rast do të krijohet një mundësi përmes integritetit të dy sistemeve që të krijojmë një sistem pensinal, i cili pastaj krijon mundësinë që qytetarët tanë të jetojnë nga pensionet që i marrin.

Ne parashohim gjithashtu hapjen e tregut pensional obligativ. Jo të krijohet një monopol siç është krijuar tani me Trustin, por ky monopol të hapet dhe të krijohen mundësitë edhe për investitorët e huaj, të cilat do të kontribuonin gjithashtu që mjetet e parapara për Fondin pensinal të rriten.

Gjithashtu konsiderojmë se duhet të sigurohemi për një kthim minimal prej 3% të investimeve që bëhen dhe në rastet kur ka humbje, atëherë ata të cilët e bëjnë sigurimin, janë të obliguar që këtë shumë të fitimit prej 3% ta sigurojnë.

Pastrimi i listave është gjithashtu një problem, i cili duhet rregulluar dhe kjo u pa sot edhe në diskutimet që u bënë rreth pastrimit të tyre.

Janë pra këto disa nga propozimet që Lëvizja "Vetëvendosje" i ka në programin e saj dhe që do të krijojnë mundësi që ne ta kemi një sistem pensinal të qëndrueshëm. Por, kjo Qeveri, në fakt,

nuk e ka hallin fare të pensionistëve dhe vetë fakti që është sjellë ky ligj këtu për ndryshim, tregon se dëshiron të ndryshojë pozitën e Qeverisë, të krijojë kushte më të mira për Qeverinë, t'i keqpërdorë në njëfarë mënyre fondet e pensionistëve, por ky ndryshim i ligjit nuk ka asnjë ndikim, absolutisht asnjë ndikim në pensionet e pensionistëve.

Ka një vit që kjo Qeveri po na mban në ankth edhe si qytetarë, edhe si deputetë me gogolin e demarkacionit dhe Zajednicës. Dy tema, të cilat kanë mund të rregullohen brenda një seance, e që Qeveria po i përdor si paravan, si mbrojtje për t'i ikur përgjegjësisë për gjendjen që ka dhe për ta fshehur papërgjegjësinë dhe paaftësinë që këtë vend ta çojë përpara.

Ka një vit që në këtë Kuvend nuk diskutohet për krijimin e kushteve të zhvillimit ekonomik, sepse zhvillimi dhe rritja është personalizuar dhe këtu përfitojnë vetëm qytetarët.

Ka një vit që nuk diskutojmë për sistemet pensionale, sepse politikanët dhe qeveritarët i kanë të siguruar pensionet e tyre.

Ka një vit që nuk bisedojmë fare për vende të reja të punës, për arsye se politikanët kanë vende të punës dhe i kanë rehatuar të afërmit e tyre.

Nuk po bisedojmë fare për përmirësimin e jetës së qytetarëve, sepse jeta e qeveritarëve është përmirësuar.

Ajo që ne kemi nevojë është që demarkacioni dhe "Zajednica" të hiqen nga rendi i ditës dhe t'u kthehemi problemeve, me të cilat po ballafaqohet ky vend. Ky vend ka nevojë për qetësi, ka nevojë për zgjidhjen e problemeve.

Ky vend ka nevojë që ne të angazhohemi edhe bashkërisht për ta ndryshuar këtë mjerim politik, ekonomik e social, i cili mbretëron këtu.

Unë ju ftoj edhe një herë që të hiqni dorë, larg duart nga kursimet e pensionistëve. Keni shkatërruar çdo gjë në ekonominë e Kosovës. Mos e shkatërroni tani edhe Fondin, edhe kursimet që i kanë bërë pensionistët tanë, sepse janë para të fituara me nder dhe nuk ka të drejtë Qeveria t'i përdorë, respektivisht t'i keqpërdorë sikur se i ka keqpërdorur deri tani.

Unë, të nderuar deputetë dhe deputete, ju ftoj që të votoni kundër këtij ligji, për arsye se me këtë ligj nuk ndryshon asgjë në jetën e pensionistëve të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Lus t'i thirrni deputetët për të votuar.

Në sallë janë 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Kanë votuar 61 deputetë. 47 janë për, 7 kundër dhe 6 kanë abstenuar.

Pra, konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Arsim Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni që të bëj prezantimin e Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Është ky një ligj shumë i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë në sistemin arsimor, sepse një Inspektorat profesional, kredibil dhe i besueshëm është një faktor i rëndësishëm në stabilizimin e sistemit arsimor, por edhe në ngritjen e cilësisë në sistemin arsimor.

Ky ligj ndryshon në koncept organizimin dhe strukturimin e Inspektoratit të Arsimit në Republikën e Kosovës dhe ndryshon në koncept edhe funksionin dhe rolin që duhet ta ketë një Inspektorat i Arsimit në Republikën e Kosovës.

Risia kryesore e këtij ligji është që ai ligj e profilizon në mënyrë shumë të qartë pjesën e inspektimit administrativ ligjor dhe pjesën e inspektimit pedagogjik, duke caktuar saktësisht funksionet e këtyre dy komponentëve të Inspektoratit dhe duke hapur një rrugë të profilizimit të Inspektoratit drejt specializimit të tij të ngushtë.

Më lejoni të paraqes disa nga risitë e këtij ligji.

Fillimisht ky ligj në mënyrë të qartë përcakton rolin e Inspektoratit administrativ ligjor në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Që nga respektimi i legjislacionit arsimor në të gjitha nivelet nga arsimi parashkollor deri te arsimi universitar e deri te respektimi i akteve nënligjore, standardeve e strategjive të tjera të miratuara sa i përket sistemit arsimor.

Pjesa pedagogjike e Inspektoratit është kyçe dhe është shumë e rëndësishme, ndoshta edhe kjo është risi, sepse ne kemi vendosur që Inspektoratin ta bëjmë instrument të vlerësimit të performansës, pra kjo është risia në kuadër të strategjisë për ngritjen e cilësisë që është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ne dëshirojmë që Inspektoratin e Arsimit ta bëjmë një organ kompetent për vlerësimin e performansës qoftë të institucionit, qoftë të mësimitdhënësve në sistemin arsimor.

Tani vlerësimi i performansës është në gjë shumë e rëndësishme për faktin që përpjekjet për ngritjen e cilësisë kërkojnë vërtet një vlerësim të rregullt të performansës së mësimdhënësve, por edhe institucioneve shkollore.

Do të bëjmë dy lloj vlerësimesh të performansës nëpërmjet Inspektoratit. Performansa e institucionit, filluar nga çerdhet deri te universitetet, pra do të shohim cila është performansa e shkollave tona, cila është shkolla cilësore, cila është performansa e universiteteve dhe këtu inspektorët do të luajnë një rol të rëndësishëm dhe performansa e mësimdhënësve. Duke e lidhur këtë komponentë shumë të rëndësishme me Inspektoratin, i cili është një nga faktorët, faktori i katërt i cili e përmban zinxhirin e vlerësimit të performansës, për shkak se kemi ndërtuar në nivel të Republikës një sistem në katër nivele të vlerësimit të performansës.

Niveli i parë është vetë shkolla, drejtori i shkollës, koordinatori për cilësi, i cili vlerëson performansën e stafit.

Niveli i dytë është komuna, e cila duhet të rritë kapacitetet profesionale në komuna, jo vetëm përmes DKA-ve, por edhe këshillave profesionale.

Niveli i tretë është Këshilli i prindërve, i cili bëhet një faktor shumë i rëndësishëm, dhe

Niveli i katërt është Inspektorati i Arsimit.

Ky sistem shtetëror do të mundësojë që secili mësimdhënës të ketë një vlerësim vjetor të performansës dhe kjo domosdoshmëri do të krijojë një konkurrencë pozitive dhe do të reflektojë në ngritjen e cilësisë dhe shkathtësive të mësimdhënësve.

Dëshirojmë të ndërtojmë një Inspektorat që nuk identifikohet me veprim represiv. Por me një përgatitje, me një veprim, do të thosha, ndihmues të shkollave, por për ta bërë këtë neve na duhen inspektorë kompetentë dhe ky ligj e hap procesin e specializimit të inspektorëve.

Në Ministrinë e Arsimit aktualisht kemi rreth 60 inspektorë, dhe planet e ministrisë janë që krahas këtij ligji, të punojmë në akte nënligjore që secili inspektor i arsimit të profilizohet për segmente të caktuara të inspektimit.

Nuk mund të kemi inspektor të përgatitur për gjithçka dhe për asgjë. Por, do ta zhvillojmë një proces që inspektorët do të ndahen në specialistë të arsimit parashkollor, që do të merren me çerdhet me institucionet parashkollore.

Me specialistë të shkollave fillore deri në klasën e nëntë, me specialistë të inspektimit të gjimnazeve, me specialistë të inspektimit të shkollave profesionale, e sidomos do ta forcojmë njësinë e Inspektoratit të Arsimit të Lartë, për ta përgatitur që të mundësojë vërtet mbrojtjen e standardeve të larta që përcaktohen me legjislacion dhe me akte të tjera.

Tani ky ligj do të hapë një rrugë, e cila pastaj do të shoqërohet edhe me akte nënligjore, e cila do të bëjë komplet riorganizimin e inspektorateve, duke ndarë kompetencat midis Qeverisë, nivelit

qendror, të nivelit lokal dhe duke ndërtuar një sistem, ku inspektorët kanë edhe vetë një llogaridhënie karshi performansës dhe karshi aktiviteteve që ata zhvillojnë.

Gjithashtu ligji përcakton në mënyrë të qartë edhe modelet e inspektimit, nga inspektimet e rregullta që duhet të jenë vjetore, unë do të thosha edhe gjashtëmujore të gjitha institucioneve, të inspektimet e jashtëzakonshme e deri të inspektimet emergjente apo të momentit, të cilat paraqiten në momentin kur institucionet arsimore kemi probleme apo kemi dukuri negative.

Thjesht, përmes këtij ligji që është hartuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, ministria planifikon riorganizimin e plotë të Inspektoratit Arsimor, me cilën nga dita e parë u kam thënë që nuk jemi shumë të kënaqur, sepse duhet të jetë kompetent, kredibil, i besueshëm dhe profesional dhe jemi të sigurt që përmes këtij mekanizmi shumë të fuqishëm do të ndikojmë shumë në atë që kemi premtuar, pra stabilizimin e plotë të sistemit arsimor dhe fillimin gradual të ngritjes së cilësisë.

Të nderuar deputetë,

Të bindur se ky ligj është një instrument shumë i rëndësishëm për të vendosur rregull, rend dhe për të ngritur cilësinë në sistemin arsimor, Ju ftoj sot ta votojmë në parim dhe ne do të punojmë bashkë me Komisionin për Arsim, por edhe me partnerët e tjerë që gjatë leximit të dytë, gjatë dëgjimeve publike, gjatë debateve që do ta kemi të ndërtojmë një ligj të mirë, të qëndrueshëm, i cili përgjigjet nevojave të sistemit arsimor dhe që bëhet një instrument i fuqishëm, do të thosha, i monitorimit të përgjithshëm të sistemit arsimor, i preventimit të dukurive negative, por edhe i lehtësimit të procesit të ngritjes së cilësisë në sistemin arsimor. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Radha është e kryetarit të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, respektivisht zëvendëskryetarit, zoti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 shtator 2016 shqyrtoi në parim Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit numër 05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve, respektivisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së fjalën e ka zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër i Arsimit, zoti Bajrami,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe si të tillë në parim do t'i japë mbështetje.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ne kemi vërejtur disa çështje përmbajtjesore dhe teknike që ne si grup jemi të interesuar të bisedojmë me sponsorizuesin dhe Komisionin përkatës për Arsim.

Ndër të tjera ato që ne i kemi vërejtur janë që, ne sugjerojmë që Inspektorati Arsimor të jetë organ qendror, pra ashtu siç e ka paraparë vendimi i Qeverisë dhe Rregullorja e Qeverisë numër 39/2013, i njëjti vendim është i po këtij viti, i vitit 2013.

Ndërsa në këtë projektligj neni 3, pika 15, e parasheh që Inspektorati të organizohen në një departament, pra që është i varur nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë, gjegjësisht nga organet e tjera më të larta të ministrisë.

Po ashtu, në nenin 17, pika 4, duhet të shtohet fjala “obligohet”, sepse kjo do të jetë më e qartë për autoritetet komunale dhe institucionet arsimore për të bashkëpunuar me inspektorët e arsimit. Besoj se ministri dhe të gjithë të tjerët e dinë që në praktikë ka pasur disa keqkuptime mes zyrtarëve komunalë apo institucioneve dhe inspektorëve të arsimit. Mendoj se fjala “obligim” është më e qartë.

Ka edhe gjëra të tjera që ne do t'ia dërgojmë me shkrim Komisionit përkatës, për shembull, kemi nenin 3. 1. 13, duhet të shtohet fjalia për inspektorët e arsimit: “Duhet të vendosë për çështje kontestuese”, jo veç të konstatojë gjendje inspektori, po të vendosë për çështje kontestuese.

Kemi aspektin teknik që do të ketë ndikim në funksionimin më të mirë të Inspektoratit si: neni 12, pika 1, neni 15, pika 1, neni 15, pika 3, të hiqet fjala “mund”, pra në këto nene e kemi fjalën “mund”, të hiqet pra fjala “mund” për të mos shkaktuar dilemë apo diç tjetër që ka Inspektorati gjatë punës.

Për këto dhe për gjëra të tjera ne do ta japim kontributin tonë gjatë leximit të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar këtë projektligj.

Ne në Komisionin Funkcional, do të thotë në Komisionin Parlamentar kemi diskutuar bukur gjatë si anëtar të Komisionit dhe e dimë mirëfilli që ky ligj, me që ka ardhur në Kuvend për rishqyrtim, do të thotë ka pasur mangësi dhe defekte bukur të madha, por mendojmë që e para ka qenë që kemi një mungesë të vogël të inspektorateve në disa fusha. Ne këtë temë e kemi diskutuar edhe me ministrin Bajrami dhe besojmë që kjo duhet të kompletohet dhe njëkohësisht çështja më kryesore ka qenë se si të pavarësohet Inspektorati, do të thotë si të ketë një pavarësi më të plotë dhe mos të jetë i ndikuar drejtpërsëdrejti nga institucioni përkatës.

Ne i kemi marrë edhe disa modele të tjera, me të cilin kemi bërë edhe disa vizita zyrtare, do të thotë si në Gjermani dhe në disa vende të tjera, do të merren edhe përvojat edhe modelet e këtyre

projektligjeve, njëkohësisht do të futen në këtë projektligj dhe bashkërisht edhe me institucionin, në këtë rast Ministrinë e Arsimit dhe njëkohësisht me anëtarët e Komisionit do të angazhohemi që të kemi një projektligj më të implementueshëm dhe njëkohësisht një projektligj, i cili do të ishte më cilësor në ngritjen e nivelit arsimor në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji për Inspektoratin e Arsimit është një ndër ligjet më me rëndësi për ngritjen e cilësisë së arsimit edhe për kontrollin e procesit mësimor.

Prandaj, ne besojmë që ky ligj do të miratohet në parim, por pasi është njëri ndër ligjet më të rëndësishme në fushën e arsimit, pa dyshim ne presim që ky ligj të diskutohet pak më gjerë me ekspertë të fushës së arsimit dhe shqyrtimi i ligjit të bëhet edhe me vendet që kanë arsim cilësor, si për shembull, Finlanda ose vendet e tjera skandinave dhe të shikohen përvojat e tyre dhe ato të adaptohen për Kosovën.

Por, për habi, ky projektligj, edhe pse shumë i rëndësishëm edhe i nevojshëm për vendin tonë, ka ardhur në Komisionin e Arsimit në formë të përsheptuar, madje edhe pa u paraparë me kohë si pikë e rendit të ditës dhe pa trajtim të duhur paraprak.

Para se ky projektligj të kalojë qoftë edhe në leximin e parë, është shumë me rëndësi të zhvillohet një debat i gjerë për çështje si, a duhet që Inspektorati të jetë në kuadër të Ministrisë së Arsimit apo duhet të bëhet si agjenci e pavarur?

A mjaftojnë kompetencat e parapara me këtë projektligj për të kryer me sukses misionin e vet Inspektorati i Arsimit, apo duhet dhënë edhe kompetenca të tjera shtesë?

A janë adekuate masat e parapara ndaj inspektorëve që i tejkalojnë kompetencat e tyre?

Domethënë, për të gjitha këto pyetje për fillim një përgjigje më të mirë me ligjin e ardhshëm Komisioni i Arsimit duhet të organizojë një diskutim publik me njohës të fushës së arsimit dhe mësimdhënës e udhëheqës të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet dhe pastaj të rregullohet ligji sipas rekomandimeve të ekspertëve dhe sipas shembujve të vendeve të cilët kanë një arsim cilësor.

Por, siç thashë edhe më herët, në parim “Vetëvendosja” do të përkrahë këtë ligj me kushtin që në procedurat në vazhdim ky ligj të kompletohet siç është më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim Projektligjin për Inspektoratin në Kosovë.

Sado që në përmbajtjen e këtij projektligji kemi shumë çështje, të cilat normalisht se në Komisionin Funkcional do t'i ngremë, kisha bërë sugjerime edhe te ministria që ta ketë parasysh, sidomos tek aktet nënligjore, të cilat janë paraparë në shumë nene në këtë projektligj, me që i ka 22 nene, por realisht janë katër nene, prej tyre parashihen të nxirren akte nënligjore. Dimë që nuk është një traditë e mirë e nxjerrjes së akteve nënligjore, të cilat kalon kohë e gjatë derisa të nxirren dhe derisa të hyjnë në funksion, por çështjet kyçe në interes të ngritjes së cilësisë në arsim, sepse e konsiderojmë sektorin kryesor të ngritjes së cilësisë në arsim, të bëhen pra me ligj, e jo të mbesin në akte nënligjore.

E dimë që edhe ligji parasheh nxjerrjen e këtyre akteve, por vetëm aty ku është e domosdoshme, pra për të nxjerrë, në mënyrë që ta thjeshtësojmë punën e funksionimit të inspektorëve.

Atë që e kam përmendur edhe në mandatin e kaluar, çështja kryesore është tek inspektorët e fushave, kemi mungesë të inspektorëve të fushave, sa i përket çështjeve pedagogjike unë pajtohem, por në fakt, për ta inspektua një mësimdhënë, një inspektor mund të shkojë brenda orës vetëm të shohë pjesën pedagogjike ose mbarëvajtjen e orës, por jo të hyjë në çështjet profesionale. Andaj, duhet të kemi parasysh që të jenë inspektorë edhe të fushave, në mënyrë që vërtet të dihen edhe mësimdhënësit që japin kontributin, e të mos jenë krejt të barabartë, të shohin pra anën vizuale më tepër, por të hyjmë në thelb, në cilësinë e mbarëvajtjes së orës mësimore, e cila është pikënisja e ngritjes së cilësisë në arsim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Lista serbe, zoti Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

I Poslanička grupa Srpske liste razmotrila ovaj Nacrt zakona i s obzirom da Zakon o Inspektoratu obrazovanja utvrđuje prava ovlašćenja i odgovornost inspektorata obrazovanja, a sve u cilju da bi se obezbedile kvalitetnije obrazovanje usluge i nadgledanja sprovođenja Zakona na svim nivoima obrazovanja.

Poslanička grupa Srpske liste u načelu podržava ovaj Nacrt zakona, i mi ćemo svoj doprinos dati između prvog i drugog čitanja kroz Funkcionalne stalne Komisije. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Nisma, zonja Bytyqi. Regjia, zonjës Bytyqi fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për një qeverisje të përngjashme, kompetente dhe që arsimin ta ketë prioritet në vepra, e jo vetëm në konferenca shkencore dhe në fjalë.

Ministri e tha që është munduar të bëjë stabilizimin në sistemin arsimor, ne s'kemi parë stabilizim në sistemin arsimor në këtë periudhë, përkundrazi kemi parë destabilizim në procesin arsimor.

Grupi Parlamentar "Nisma për Kosovën" e ka shqyrtuar me shumë vëmendje Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe në parim e mbështet.

Ndërsa angazhimin tonë do ta japim në kontakt me ekspertë të fushës së caktuar dhe në Komisionin Parlamentar për Arsim.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zoti Bajrami.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani ministar obrazovanja, doktor Arsim Bajrami,

Ovaj Zakon je svakako od velike važnosti za obrazovanje u Republici Kosovo, i mi ćemo svakako u načelu glasati sada za njega, s tim što ćemo preko Funkcionalne Komisije dati svoj doprinos i eventualnim izmenama i dopunama Zakona, uzimajući u obzir da obrazovanje na Bosankom jeziku kao obrazovanje na Turskom jeziku u sistemu obrazovanja Republike Kosova i tu postoje neki naši specifični problemi, odnosno specifične potrebe koje takođe kao Zakon trebaju biti dakle predviđene za rešavanje. U ovom smislu mislim da budući inspektori trebaju da postoje dakle inspektori za obrazovanje na Bosanskom i Turskom jeziku, s obzirom zbog specifičnosti jezički i svake druge, po gotovo oko nacionalne grupe predmeta.

Dakle daćemo sada svoj glas a kasnije ćemo dati svoj doprinos da bi ovaj Zakon bio što bolji i što korisniji za obrazovanje na Kosovu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buja e ka fjalën.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Çështjet të cilat shtrohen në këtë ligj, në Ligjin për Inspektoratin Arsimor dhe në pjesën e parë të memorandumit shpjegues, sidomos nga ministri, thuhet në pikën e parë, te çështjet kryesore të trajtuara, se Ligji për Inspektoratin e Arsimit ka nevojë për ndryshim dhe plotësim me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së inspektorëve të arsimit si dhe përafrimi me legjislacionin e BE-së.

Ndërsa në opinion ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, opinionin jepet se nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe rrjedhimisht secili shtet i ka rregulluar sipas politikave dhe legjislacionit të tyre të brendshëm.

Po ashtu në këtë çështje memorandumit shtronte opinionet e rekomanduara, në të njëjtën frymë thoshte se krijimi i një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, me këtë rast nxjerrjes së projektligjit në përputhshmëri me aktet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Po ashtu opinionin i ministrisë përkatëse për përputhshmëri me legjislacionin e BE-së, e theksova më herët, thotë se nuk ka legjislacion specifik për këtë çështje, por secili shtet e rregullon çështjen në bazë të specifikave politike që i ka shteti.

Edhe në pjesën tjetër, te pika 4, është arsyeimi i propozimet duke përfshirë dhe shpjegimin e nivelit të përafrimit me legjislacionin e BE-së, e legjislacion BE-ja nuk paska për këtë çështje. Sidomos këtu është shpjegim edhe më i rëndë kur thotë: “Te shqyrtimi dhe plotësimi i ligjit për Inspektoratin e Arsimit është me standarde evropiane dhe ndërkombëtare, respektivisht me

legjislacionin e BE-së që është një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës” dhe vazhdon. “Gjatë hartimit të projektligjit është bërë përafrimi i dispozitave me legjislacionin e BE-së”, a opinioni është se nuk ka legjislacion të BE-së në këtë fushë.

Po vazhdoj me ligjin për të ndihmuar në drejtim të konsolidimit sa më të mirë të ligjit. Te neni 2, paragrafi 2.2, neni 2 thotë: “Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni Inspektorati i Arsimit nuk është përgjegjës për”, ndërsa në nenin 2.2. apo në paragrafin 2.2: “Çështjet e ndërlidhura me punësimin e stafit në të gjitha institucionet arsimore, përveç në rastet e përkufizuara me këtë ligj”, nuk e përkufizon se nuk është përgjegjës për pranimin e stafit, në këtë nen, në nenin 2.2, dhe ky nen është në kundërshtim pastaj me nenet e tjera. Po nenet e tjera janë në kundërshtim me nenin 2.

Neni 9 thotë: “Detyrat specifike të ndërlidhura me institucionin arsimor të nivelit të SNKA-s, në pikën 3.1, thuhet “kontrollon nëse drejtorët, zëvendësdrejtorët, stafi profesional dhe mësimdhënësit i kanë kualifikimet e nevojshme dhe licencën për punësim”. Kjo është në kundërshtim, sepse me punësim dhe stafin nuk merret te neni 2.

Po ashtu vazhdon te neni 12, që po ashtu është në kundërshtim me nenin 2, i cili thotë: “Të iniciojë masat disiplinore dhe ligjore kundër drejtorëve të shkollave, zëvendësdrejtorëve, stafit profesional dhe mësimdhënësve të tyre” dhe neni 13 po ashtu vazhdon në kundërshtim, thotë: “Të urdhërojë kualifikimin e mëtejme apo të iniciojë procedurat për shkarkimin apo riemërimin e drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, stafit profesional dhe mësimdhënësve që nuk posedojnë kualifikime të nevojshme për punësim në pozita aktuale”, thotë realisht në nenin 2.2 e merr të drejtën Inspektorati, ndërsa në këto nene i jap të drejtën të ndërhyjë në largimin, në shkarkimin apo në masa disiplinore.

Do të ishte më mirë të shqyrtohet neni 2.2 dhe të jepet mundësia që inspektorati, siç parashihet në nenet e tjera, të rekomandojë që gjatë pranimit të stafit, gjatë pranimit të punëtorëve arsimorë të kihet parasysh që të rekomandojë të jenë profesional dhe siç parashihen në nenet e tjera.

E dimë që mësimdhënësit nuk janë shërbyes civilë dhe nuk mund të merren institucionet që janë për shërbyesit civilë me ankesat e tyre. Prandaj, duhet të kemi një institucion, siç është institucioni i Inspektoratit në fushën sidomos administrative apo Inspektorati administrativ të merret me çështjen e ankesave të mësimdhënësve, të cilët nuk pranohen në punë për shkaqe të ndryshme, të cilat janë edhe politike, madje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar,
I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,
Faleminderit, që keni sjellë këtë ligj.

Ajo çka viteve të fundit është diskutuar vërtet edhe ju në elaborimet tuaja të para dhe deklaratimet tuaja të para keni thënë që do të jetë prioritet cilësia në arsim në mandatin tuaj, po besojmë se ashtu do të jetë dhe ky Ligj për Inspektoratin që Komisioni ynë Parlamentar dhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar, për të cilin do të duhej një diskutim dhe një trajtim shumë më të

gjerë, për arsye se po flasim për një inspektorat, i cili do bëjmë vlerësueshmërinë e cilësisë dhe performansës të arsimit në Kosovë, duke filluar nga çerdhet, shkollat fillore, të mesmet dhe universitete.

Edhe pse mendoj që tek universitetet vlerësimi i performansës është konkurrenca, si në krejt botën demokratike dhe në vendet e zhvilluara. Të gjithë studentët shkojnë në universitete, të cilat ata mendojnë që janë cilësore dhe i vlerësojnë si të tilla, por gjithsesi problemi te ne qëndron te niveli tjetër, tek drejtorët politikë të shkollave dhe vlerësimet që inspektorët shpeshherë bëjnë edhe vlerësime si deri më tani, që kanë qenë vlerësime politike.

Nëse vërtet dëshirojmë të kemi një cilësi në arsim, atëherë vërtet, kryetarët e komunave, partitë politike duhet të heqin dorë nga bërja e drejtorëve politikë.

Duke vlerësuar edhe ata drejtorë, të cilët kanë shkuar nga partitë politike dhe kanë treguar rezultate në disa shkolla, por definitivisht zgjedhjet e fundit lokale, kur dhanë atë ngjyrën e demokracisë dhe pothuajse në të gjitha partitë politike tani kem në qeverisje nëpër komunat dhe shohim të njëjtin model qeverisës në arsim.

Të gjitha partitë politike, pa përjashtim, insistojnë që të caktojnë drejtorë të shkollave dhe kjo pastaj drejtpërdrejt ndikon në cilësinë e arsimit.

Nëse me anë të këtij ligji dëshirojmë të kemi një inspektorat, i cili do ta bëjë vlerësimin e cilësisë dhe të performansës, atëherë sigurisht që ky inspektorat duhet të jetë decidivisht i pavarur, decidivisht i pavarur do të jetë si agjenci dhe përveç kompetencës që ka si inspektorat, atëherë detyrimisht duhet ta marrë në kompetencë edhe zgjedhjen e drejtorëve të shkollave.

Nëse dëshirojmë të kemi cilësi në arsim, atëherë partitë politike duhet të heqin dorë që të çojnë militantë, drejtorë dhe zëvendësdrejtorë nëpër shkolla, pa përjashtim, për arsye se këtë na e dëshmuar zgjedhjet e fundit lokale dhe qeverisjet e mëpastajshme nëpër të gjitha komunat. Asnjë parti politike nuk heq dorë për të caktuar njerëz politikë në arsim, në drejtori, duke rehatuar militantët e tyre politikë, duke filluar nga Prishtina si kryeqytet, ashtu edhe në të gjitha qytetet e tjera të Kosovës.

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju ftoj të gjithëve, për arsye se po flasim për një çështje shumë madhore për cilësinë në arsim, për cilësinë e arsimimit të fëmijëve tanë. Ju ftoj të gjithëve që në debatin publik dhe dëgjime publike që besoj do të organizohen disa nga ato nga ne si Komision, të merrni pjesë dhe të jepni kontributin tuaj që vërtet përmes këtij ligji të arrijmë të vendosim bazën ligjore.

Nëse ky ligj ka ardhur në Kuvend vetëm sa për thënë se kemi bërë Ligjin për Inspektoratin e Arsimit dhe tani e kemi ligjin dhe e kemi mbaruar punën me këtë, atëherë mendoj që nuk është e nevojshme të shpenzojmë kohë kot, por nëse dëshirojmë të bëjmë një ligj, përmes të cilit do ta vlerësojmë cilësinë në arrimë, duke filluar kontrollin e parë të cilësisë që do të duhej ta bënte drejtori i shkollës dhe pastaj kontrolli i dytë i cilësisë që do të duhej ta bënte Inspektorati i

Arsimit dhe kështu pastaj të kemi një kontroll të cilësisë dhe ngritje të cilësisë gradualisht, për arsye se nuk mund të pretendojmë se mund të bëjmë shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ndoshta pa rend, por dua të inkuadrohem rreth diskutimeve.

Unë mendoj që ligji, i cili ia mundëson kryetarit të komunës që t'i zgjedhë drejtorët e shkollës është antidemokratik dhe nuk ka të bëjë absolutisht në mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies në asnjë shkollë, as të mesme e as fillore. Prandaj, unë besoj që do të duhej të ndryshojë që drejtorët të zgjidhen nga kolektivi i arsimit, së bashku me shoqatën e prindërve që i kanë nxënësit në ato shkolla dhe ky është, mendoj, një rregull i cili do të duhej të aplikohet.

Ashtu siç është një problem tjetër shumë i madh me punonjësit e arsimit, të cilët e presin pensionin dhe kanë probleme të mëdha shëndetësore.

Unë mendoj që një ligj, i cili ua mundëson pensionimin e parakohshëm arsimtarëve dhe mësuesve është i domosdoshëm, për faktin se ne kemi arsimtarë pothuajse që shkojnë për t'u dhënë mësim nxënësve dhe unë besoj se invalidët e shkollës ndoshta, s'e di cila është më e larta, të futen në klasë me nxënës dhe t'u japin mësim atyre, unë nuk e di se çfarë edukimi dhe çfarë arsimimi mund të bëjnë këta profesorë, mësues apo çfarëdo që janë.

Mendoj që këto dy çështje do të duhej të diskutohen dhe të nxirret një mësim nga praktikat e vendeve që i kanë kaluar këto. Ne e kemi pasur edhe përpara, krejt drejtorët e shkollave i kanë zgjedhur kolektive të shkollave dhe jo kryetarët e komunave. Po pajtohem me atë që tha parafolësi lidhur me zgjedhjen e drejtorëve, unë jam kundër që inspektorët t'i zgjedhin drejtorët e shkollave, por kolektivi i shkollës së bashku me prindërit mund të përcaktojnë se cili drejtor është më i mirë dhe më i përshtatshëm që ta drejtojë një shkollë fillore ose të mesme.

Radhën e ka deputetja Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Është më se i pritur projektligji që e keni sjellë për Inspektoratin e Arsimit dhe për t'u kyçur në debat do ta lexoj qëllimin e ligjit: "Ky ligj përcakton të drejtat, autorizimet dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Arsimit në Republikën e Kosovës për të siguruar cilësinë e shërbimeve arsimore në arsimin parauniversitar dhe për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit në të gjitha nivelet e arsimit". Fushëveprimtaria e ligjit: "Ky ligj trajton mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në institucionet arsimore publike dhe private". S'do të vazhdoj më tutje me ligjin.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi aktualisht një Inspektorat të Arsimit, po ashtu e kemi një ligj. Problemet në arsim janë shkaktuar nga moszbatimi i ligjit nga Inspektorati dhe kjo nuk është tashmë në këtë mandat, por kjo është në vazhdimësi duke i përcjellë institucionet e arsimit në Kosovë, sepse Inspektorati nuk është i përgatitur, apo punonjësit në Inspektorat, jo të gjithë, por shumica nuk janë të përgatitur që të punojnë të pavarur dhe t'i kryejnë detyrat e tyre ligjore të pavarur nga politika.

Dhe, kjo domosdoshmërisht ka ndikuar edhe në cilësinë e mësimdhënësve. Pse? Pothuajse secili mësimdhënës sa herë mbahen zgjedhjet lokale i kap frika se do t'u shpallet konkursi nga të ardhurit e rinj në pushtetet lokale. Qofshin ato subjekte politike apo grupacione të caktuara. Dhe frika e humbjes së vendit të punës në rrethana çfarë është Kosova, domosdoshmërisht shkakton dekoncentrim të mësimdhënësve në procesin e mësimdhënies. Deri më tash, Inspektorati i Arsimit nuk ka lëndë të dorëzuara në gjykata për shkak të shkeljes së ligjeve nga DKA-të, përkatësisht kryetarët e komunave sa i përket zbatimit të ligjeve.

Këtë e bëjnë vetë privatisht mësimdhënësit. Është detyrë e paraparë edhe me ligjin aktual që është në fuqi, por edhe me këtë ligj tash që Inspektorati kur nuk zbatohen rekomandimet ligjore të Inspektoratit t'u drejtohet gjykatave dhe kjo dukuri pothuajse mungon. Pse mungon kjo dukuri në Inspektorat? Po e theksoj, nuk janë të gatshëm të veprojnë të pavarur në zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë në fushën e arsimit. Kjo është detyra e tyre e përcaktuar tash edhe me këtë ligj dhe kjo domosdoshmërisht është shqetësim.

E përkrah idenë që u dha sot këtu edhe nga ju nënkryetar që në përzgjedhjen e drejtorëve nëpër shkolla të shtohet roli i këshillit të prindërve dhe mësimdhënësve të shkollës përkatëse. Janë udhëzimet administrative dhe Ligji për arsimin parauniversitar në Kosovë që u jep të drejtë që në bazë të performansës të vazhdohet mandati i drejtorëve në shkolla dhe në qoftë se nuk e plotëson performansën për vazhdimin e mandatit, ai kthehet në procesin e mësimdhënies, në lëndën për të cilën është i përgatitur paraprakisht.

E, kjo nuk është duke u zbatuar dhe është një heshtje Inspektoratit. Po t'i marrim disa deklarime të njerëzve, të mësimdhënësve apo edhe të menaxherëve të shkollave, të cilët u janë qasur zyra të Inspektoratit, qoftë në nivel qendror, qoftë ato rajonal, për problemet e tyre lidhur me zbatimin apo jo të projektligjeve, të ligjeve nga DKA-të pa dallim, nga ana e DKA-ve drejtorët e të cilave i përcaktojnë kryetarët e komunave, të cilët janë përfaqësues të të gjitha partive tona këtu që jemi në Kuvend, asnjëri nuk ka performansë më pozitive apo më të mirë në anën e zbatimit të ligjeve.

Të gjitha emërimet bëhen politike, të gjitha vazhdimet bëhen politike, performansë mund të marrë vetëm ai që i përket një subjekti politik dhe i vazhdohet mandati, e jo ai tjetri që i përket subjektit tjetër politik. Kemi stërzgjatje të konkurseve publike për drejtorë, duke filluar nga institucionet parashkollore, dhe për këtë Inspektorati prapë hesht. Ato fillojnë nga Komuna e Prishtinës, e në të gjitha komunat ku udhëheqin të gjitha partitë politike. Dhe, gatishmëria jonë këtu si subjekte politike të përfaqësuara në Kuvend dhe secila nga ne e udhëheq nga një komunë e më tepër që ta rregullojmë çështjen e arsimit, të bëjmë depolitizimin dhe të kërkojmë zbatimin e ligjeve, së pari në aspektin infrastrukturial dhe menaxhues, e më pastaj të hymë në çështjet e asaj që u shtrua këtu - inspektorat sipas fushave, do të mund ta kemi një arsimim më cilësor. Por, gatishmëria jonë nuk mund të mbetet vetëm në nivelin deklarativ në Kuvend për të na dëgjuar disa votues tanë, duhet të jemi të gatshëm të veprojmë realisht.

Dhe, atë gatishmëri s'e ka treguar asnjë subjekt politik që udhëheq me komuna dhe e ka përgjegjësi arsimin parauniversitar. Por, mua më shqetëson heshtja e Inspektoratit në këto raste. Dhe, unë besoj që me punën tonë së bashku këtu do të mund të bëjmë ligjin gjatë amendamentimit edhe më të mirë, edhe më praktik dhe t'i japim përgjegjësi Inspektoratit dhe të veprojmë.

I nderuar ministër,

Ndiej obligim moral të theksoj se kjo dukuri nuk është vetëm në këtë mandat. Kjo dukuri e politizimit të arsimit duke vepruar dhe e depolitizimit vetëm në aspektin deklarativ është vazhdimësi. Ndoshta duhet menduar për idenë që inspektorët të veprojnë në kuadër të komunave, sepse do të jenë më afër institucioneve arsimore në mënyrë që ta shohin zbatueshmërinë e ligjeve. Njëherë e përgjithmonë ju kisha lutur, zoti ministër, së bashku me ne këtu që po deklarohemi sot, të përpiqemi ta lirojmë Inspektoratin, punonjësit në Inspektorat, nga kërcënimet politike që mund t'u shkojnë atyre, në mënyrë që ata ta kryejnë punën të pavarur.

Në qoftë se nuk janë të gatshëm, atëherë mund të bëhet edhe zëvendësimi i tyre dhe ta largojnë njëherë e përgjithmonë frikën e mësimdhënësve, madje dhe në shkollat ku vërtet performansa është shumë pozitive se u shpallen konkurset për qëllimet politike, apo sipas njëanshmërisë partiake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit Fjalën e ka zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

U tha, por edhe vetë konsideroj që kjo lëmi është tepër e rëndësishme, andaj edhe kodifikimi ligjor i saktë i saj për t'u bërë funksionale dhe e suksesshme është tepër i rëndësishëm.

Këtu e kemi një mënyrë të çuditshme qysh flasim për ligje dhe është mirë që bile disa gjëra që mund t'i bëjmë ne t'i themi ne këtu dhe t'i kërkojmë prej atyre që sponsorizojnë. E dëgjova këtu problemin 'duhet - s' duhet', dhe mënyrat e shkrimit të ligjeve. I takon Kuvendit që të kërkojë me fuqinë e vet edhe nëpërmjet Qeverisë se sponsorimet e ligjeve të shkruhen nga kompetentë që shkruajnë ligje, po flas për gjuhën e ligjeve, jo për zgjidhjen, sepse gjuha e ligjeve është themelore dhe po t'u thuhet, po flas për ligje në shqip, por edhe në gjuhë tjera, që kodifikimi i tij bëhet me dëftore në kohën e tashme, që në kuptimin elementar është shumë i thjeshtë, por kjo është me rëndësi.

Nëse shkruhet kurrë, kurrë s'ka gabime. Ne e kemi ministrin që është jurist, le të dalë, le të kundërshtojë, ose le të pohojë, por kjo është kaq e thjeshtë, mënyra më e thjeshtë e shprehjes, por më e sigurt. S'ka interpretime!

Pra, dëftorja e tashme! Po të ndodhë kjo edhe në këtë ligj, edhe askund s'ka probleme. Kjo është tepër e rëndësishme, sepse po kalojmë edhe në amendamente dhe kur po bisedojmë për të pastaj po na mbulojnë nuancat, duke e mbuluar thelbin. E thelbi këtu është i këtij institucioni dhe i ligjit. Forcimi i inspektimit të arsimit, do të thosha unë, kjo është shumë e rëndësishme. Te ne ky tip i inspektimit ka ekzistuar historikisht dhe mund të ju them që, meqë jemi në mosha të ndryshme, të gjithë e kemi perceptimin e tij në kohën kur ne çfarë shkollash kemi kryer. Në faza të ndryshme, ky ka pasur fuqi të jashtëzakonshme. Edhe mirë e ka pasur që e ka pasur. Në faza të tjera është bërë krejt formal, dikur kam dëgjuar edhe njerëz të arsimit që thoshin që është mirë të hiqet krejt. Që është një mendim katastrofal, do të thosha, sepse është bërë modë këtu që të thuhet 'vendet e përparuara', 'filan vendi', pastaj 'bashkësia ndërkombëtare', tani 'shtetet e përparuara', që është një..., të folurit e përgjithshëm që s' thotë kurrëgjë.

Nëse dikush do ta analizojë, le ta marrë qysh bëhet ky inspektim në Francë, për shembull. Që është tepër rigoroz, këtë e di vetë. Ose ta marr në Gjermani, por të mos thuhet BE-ja, sepse pastaj e kemi këtë konfuzion, që dikush e analizoi, se është bërë proforma në bazë të ligjit të BE-së. Në BE, normalisht ligji për veprimtaritë, të gjitha shtetet që janë bërë bashkë atje, nuk janë bërë bashkë për t'u zhvilluar me direktiva. Zhvillohet sipas nevojave të veta dhe ne duhet ta kemi një Inspektorat të Arsimit për nevojat tona, jo të Gjermanisë, as të Francës, as të Anglisë, se as sistemet s'i kemi njëjtë.

Edhe sistemet të cilat e parashohin suksesin nuk janë te Inspektorati. Inspektorati është organizim që e teston cilësinë, por s'e bën cilësinë. E krijon sistemi i arsimit dhe ata që e përbëjnë, që i bie niveli i atyre që japin mësim dhe atyre që marrin mësim. Pra, është përtej kësaj të mos i përziejme punët, por meqë është i tillë, i cili e teston në një shoqëri në mënyrë të përhershme suksesin, atëherë e ka rëndësinë e veçantë.

E tash, çka teston ky? Këtu po i dëgjoj, edhe kësaj radhe i dëgjova problemet 'performansa, performansa'! Shikoni! Janë bërë tash këto disa fjalë që gati e kanë humb kuptimin e parë. Keni kujdes çka është performansë. Ka njerëz, varet për çka performon, se performansa është paraqitje. Ndodh që i thuhet një arsimtari 'performansa jote është e mirë nëse i kalon shkëlqyeshëm 89% të nxënësve në lëndën e caktuar', e ai u jep të gjithëve 5-sa ose 10-ta, e gjoja bëhet performansa më e mirë. Ajo është performansë shkatërrimtare. Është e kundërta, ai duhet të cilësohet i keq.

Në këtë tip të testimit, po ai del më i miri! Pse? Atëherë vjen në rend të parë kompetenca. Harrojeni performansë, se nëse në arsim ka arsimtar kompetent, ai vetë bëhet performanti më i mirë. S'keni shans, vizatojeni si të doni, visheni si të doni, nuk ka shans ta ketë performansën e mirë. Pra, le të kthehemi te kompetencat. E kompetenca, pra tash duhet të ushtrohet në këta inspektorë zotërinj. Krejt janë fjalë të kota çka flasim ne, nëse nuk janë kompetentë inspektorët, dhe kompetentë, jo në kuptimin metodologjik, që është bërë tash edhe modë kjo, prapë qysh performon dikush, ose pedagogjik, por profesional. Nuk mund të bëjë kurrfarë inspektimi filozofi në matematikë. Le të më falë, të dytë janë shumë të respektuar për mua, por ç'lyp ai atje?!

Pra, kompetenca, nën një, dhe raportet tjera tutje. Dhe, unë nuk do ta zgjas, por dola të them që unë për vete i jap rëndësi të jashtëzakonshme kësaj dhe sidomos mënyrës kush bëhet inspektor. Shumë me rëndësi është kompetenca, se këtu tha po politizohen, po normalisht ai që s'di, nëse e vë në pozicion që s'e meriton, ai nuk mund të ekzistojë, pos si i politizuar.

Ti veç e ke bërë politik. Vëre njeriun në fushën që s'e di, e ke bërë politik atë ditë. Kudo qoftë, në cilëndo lëmi, aq më tepër në këtë lëmi. Por me kritere bëhet, edhe mund të bëhet, pa mbajtur fare fjalime politike. Dhe, po e përfundoj, ndjeva nevojë t'i them këto fjalë, edhe një herë po them: e konsideroj element tepër të rëndësishëm për të parë çka po bëhet me arsimin. Tjerat janë, ne mund të flasim fjalime, por kur s'e ke elementin në veprim kot e ke.

Edhe kjo puna e ndryshimeve edhe të ligjeve, se e tha këtu një kolege boll i mirë është po të funksiononte edhe ligji paraprak, pak a shumë nëse e thashë gabim, korrigjomë, atëherë unë po e marr si shkas për ta thënë edhe këtë çka desha ta them.

Edhe ta heqim nga mendja që bëjmë diçka të re pse ndërrojmë përditë, sidomos në sistemet që për kah natyra janë konservative, e nuk ka sistem të organizimi për nga natyra më konservativ se arsimi, ndoshta veç ushtria, që shekujt kalojnë, por është si natyrë e organizimit e tillë. Ndërrimet e shpeshta janë huqe. Duhet të krijohen standarde, sa më gjatë të rrinë standardet në këtë lami, ajo fushë në atë vend është shumë më e konsoliduar. Se është bërë modë kjo ‘reforma, reforma!’. Po çfarë reforme kur s’ke formë?!

Është e domosdoshme formë e substancë thjesht për të korrigjuar nga pak, e cila nuk shkon. Prandaj, të mos mendojmë që zgjedhim diçka pse themi ‘si krejt bota e përparuar’, ‘si ligjet e BE-së’ edhe po bëjmë reformë. Jo!

Se edhe sistemet, formë - reformë, ju e dini, është profesor i njohur edhe ministri, në këtë rast është edhe jurist. Ne edhe shkollat e larta i ndërruam për 15 ditë i bëjmë Bolonjë, po ku ka universitet të madh klasik në Evropë që është Bolonjë sot. Po, jo, se s’janë kurrkund! Dhe, atëherë dikush që ka ditur pak më shumë është përpjekur të rezistojë, por Bolonja është për ta krijuar mesataren. Kaq! Është sistem për ta dominuar mesataren. Dhe duhet ta dimë këtë punë. Jo ne po na pëlqente. Atëherë merre! Por, nuk është e vërtetë që duke vrapuar pas nevojave të vendeve të ndryshme, ai që krijon mesatare e ka gjetur më të mirë. Nuk është e vërtetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka zoti Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Me të vërtetë dua ta falënderoj publikisht profesorin e nderuar, zotin Hamiti, se na dha shumë ide dhe na foli shumë qartë për rëndësinë dhe rolin që duhet të ketë ky projektligj për Inspektoratin e Arsimit.

Ajo pse e mora fjalën është më tepër për të ngrehur disa çështje këtu lidhur me atë që dëgjuam para folësve, para zotit Hamitit, se arsimi u konstatua që është i politizuar. Inspektorati ka qenë i politizuar thua se dy partitë që janë në pushtet nuk e kanë udhëhequr arsimin mbi 90% të mandateve qeverisëse, thua se këto parti nuk e kanë pushtetin mbi 60% të komunave dhe tani ndryshimi i zgjedhjeve të vitit 2013 ka ndërhyrë dhe i ka prishur kalkulimet e tyre.

Unë po dua të them që kryetarët e komunave nuk i zgjedhin drejtorët, sigurisht është edhe ministri këtu dhe e di këtë, por i zgjedh një panel, ku merr pjesë edhe një zyrtar i Ministrisë së Arsimit, dhe ai propozim që doli këtu nga disa parafoles, siç ishte që drejtorët duhet të zgjidhen nga Inspektorati, me të vërtetë mendoj që është i papranueshëm dhe duhet të na shqetësojë dhe duhet të interesohemi të gjithë që ta parandalojmë, sepse është edhe një thirrje që edhe atë mundësi që duhet ta kenë drejtorët e shkollave të lirë dhe ta ushtrojnë brenda normave ligjore autoritetin e vetë si drejtor të shkollave ta bartin, ta centralizojmë te një grup njerëzish, të cilët mund të zgjidhen edhe nga ndikimet politike dhe t’i shndërrojmë edhe Inspektoratin e Arsimit sikur janë shndërruar bordet e ndërmarrjeve publike apo bordet e agjencive të pavarura, që janë shndërruar në çerdhe të partive politike.

Për të folur për ligjshmërinë, se si rrjedhin çështjet nëpër komuna lidhur me shtyrjen apo neglizhimin e shpalljeve të vendeve të lira, ne e kemi këtu një dokument tuajin ministër, i cili na

jep ne një fakt këtu që në Ministrinë e Arsimit ende e keni një ushtrues detyre, zotin Alush Istogu. Që sa kohë është këtu dhe do të shihet që këtu gjithmonë hyjnë çështjet politike dhe për shkaqe të tjera nuk realizohen në mandat të caktuar edhe mandatet që donin t'i ushtrojnë njerëzit e tij.

Prandaj, po them edhe një herë që duhet të lirohemi nga frika se humbja e zgjedhjeve do të ndikojë në manipulimin, apo në ndikimin e drejtorëve nëpër shkolla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

I dëgjova me vëmendje diskutimet rreth Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, unë nuk kam çka t'i shtoj më tepër, por do të pajtohem me atë se Inspektorati i Arsimit në Republikën e Kosovës duhet të bëhet sipas profilit që inspekton dhe nivelit të arsimit që inspekton.

Mbi të gjitha, duhet të ketë kompetencë profesionale inspektori që inspekton nivelin e arsimit, por edhe profilin e arsimit. Te decentralizohet Inspektorati apo jo, mendoj se jo, duhet të gjendet ndonjë model i kombinuar, ose në bashkëpunim me inspektoratet komunale dhe inspektoratin qendror.

Krejt në fund, dëshiroj ta shtoj një pyetje, kush mund të përgjigjet: Po na përcjell një fat nëpër të gjitha projektligjet, si bie fjala, dëgjova që u lexua qëllimi i ligjit thotë kështu: "Të zbatohet në legjislacionin e aplikuar". Unë nuk e kuptoj, fjala "e aplikuar" është fjalë e huaj, apo në gjuhën shqipe mund ta llogaritim edhe si neologjizëm, por shtrohet pyetja: a kemi ligje të paaplikueshme? Dhe, kisha dëshiruar që dikush t'i analizojë këto çështje dhe të mos na vijnë në këtë formë kështu, sepse, jo vetëm në këtë projektligj, por edhe në ligjet tjera na vijnë kështu.

E mbështes në parim projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

I dëgjova me vëmendje të gjithë ata që folën dhe është një segment me rëndësi jetike për monitorimin e arsimit dhe unë mendoj që Ministria e Arsimit e ka për detyrë që të bëjë politika zhvillimore të arsimit dhe të mos kyçet në çështjet ekzekutive dhe që janë të përcaktuara me Ligjin për qeverisjen lokale.

Dhe, nëse ne ndërhyjmë këtu, atëherë duhet t'i ndërhyjmë dhe ta amendamentojmë edhe Ligjin për qeverisje lokale që i parasheh kompetencat e qarta për kryetarin e Komunës dhe përgjegjësit që i ka kryetari dhe Komuna, në përgjithësi. Prandaj, në këtë drejtim, unë mendoj që nëse jemi për reforma ligjore vetëm sa për të thënë që kemi bërë reformë ligjore dhe të mos e ndryshojmë mendësinë tonë politike dhe të vepruarit kemi gabuar, sepse ne kemi mjaft ligje që nuk implementohen ashtu siç duhet dhe njerëzit nuk janë kompetentë në fushën e caktuar për të cilën edhe janë zgjedhur.

Nëse e marrim një analizë të Inspektoratit, diku 70% të profileve që ekzistojnë aty nuk janë përputhje me atë që e kërkon modeli apo Ligji për Inspektorat dhe pajtohem plotësisht me zotin Hamiti kur thotë që jo performansë, por kompetentë për fushën e caktuar, sepse ka ndodhur, e marr si shembull edhe në Gjakovë, kur njeriu që ka inspektuar e ka të kryer historinë e ka shkuar në matematikë apo në kimi apo diku tjetër, vetëm që e ka quajtur veten inspektor. Dhe, në këtë drejtim, ne mund të krijojmë ligje çfarë të doni, mund të thirreni edhe në Bashkimin Evropian, por nëse nuk e ndryshojmë mendësinë tonë politike dhe strikte në fusha të caktuara, mendoj që e kemi gabim dhe mendoj që këtij segmenti duhet t'i jepet një rëndësi e veçantë dhe të zgjidhen njerëzit kompetentë, por duke mos e konsideruar veten që ata janë forcë ekzekutive dhe të përzihen në ligjet e qeverisjes lokale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ke kërkuar sërish fjalën, edhe pse ka folur.

MYTAHER HASKUKA: Thënë të drejtën, nuk pata për të diskutuar më shumë, pos asaj që folëm në fillim, por pasi që foltoret e Kuvendit të Kosovës po keqpërdoren për t'u diskutuar gjëra që nuk janë të lidhura me këtë ligj, edhe unë më duhet të reagoj për disa keqinformime, ose tentime që të thuhet që në të gjitha komunat e Kosovës arsimi është i politizuar edhe në të gjitha komunat është njëjtë.

Bile-bile u fol edhe për Komunën e Prishtinës. Unë dua vetëm që të theksoj që faktikisht, siç u tha më parë, ky ligj është për Inspektoratin e Arsimit, pra si mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë në arsim dhe është dashur të diskutohen këto gjëra, por pasi u diskutua Prishtina desha t'i informoj kolegët këtu që Komuna e Prishtinës është komuna e vetme në Kosovë e cila i ka hapur intervistat për publikun dhe ku kandidatët për drejtorë paraqesin plane zhvillimore për zhvillimin e shkollës se çka do të bëjnë gjatë mandatit të tyre nëse zgjidhen drejtorë.

Në këto prezantime zakonisht marrin pjesë, pos atyre që është paraparë me ligj, po ashtu pjesëtarë të shoqërisë civile, vëzhgues nga prindërit, mësimdhënësit e kështu me radhë dhe është procesi i vetëm i hapur në Kosovë gjatë përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave.

Por, po ashtu edhe për mësimdhënësit, Komuna e Prishtinës ka mundësuar që të ketë edhe vëzhgues edhe nga prindërit dhe mësimdhënësit gjatë procesit zgjedhor dhe në atë aspekt është munduar që me çdo hap ta depolitizojë procesin e përzgjedhjes së drejtorëve dhe mësimdhënëseve nëpër shkollat e Prishtinës dhe nuk është e vërtetë që të gjitha komunat i kanë problemet e njëjta me politizimin e edukimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, po? Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Ajo çka e thashë që zgjedhjet 2013 e kanë dhënë shëmbëlltyrën se të gjitha partitë politike pa përjashtim kanë bërë ndikimet e tyre në përcaktimet e drejtorëve të shkollave, e theksova edhe në Prishtinë për arsye se nëse subjektet tjera politike nëpër komunat tjera kanë caktuar drejtorë të shkollave nga komuna e tyre, "Vetëvendosje" Prishtinë ka marrë militantë edhe nga komunat tjera për t'i bërë drejtorë në Prishtinë. Domethënë, ia ka tejkaluar në ndikimin politik që nga

çerdhja e deri në sistemin parauniversitar komplet në Prishtinë. Edhe në çerdhe, “Vetëvendosja” i shikon se fëmijët e kujt janë për t’i pranuar në çerdhe dhe nësej anë militantë partiakë, apo jo.

Mbulesa për t’u mbuluar nga disa organizata joqeveritare, të themeluara nga “Vetëvendosja” është vetëm një hedhje syve sa për opinion, por qytetarët e përjetojnë këtë çdo ditë në kryeqytet, prandaj ky është sistemi. Thashë diçka për të vlerësuar, për diçka për më shumë përtej kësaj që po ndodh, për ta ngrehur cilësinë në arsim, në të gjitha nivelet, në të gjitha komunat. Prandaj, nuk e thashë në ndonjë kuptim që ta godas një subjekt politik apo tjetër, por fola në tërësi për të gjitha komunat, duke filluar nga Prishtina dhe deri te komuna më e vogël, është sistemi i njëjtë, është shëmbëlltë e njëjtë. Prandaj, këtë çështje duhet ta rregullojmë me ligj që t’ua heqim këtë mundësi mundësi partive politike për të dërguar militantë partiakë nëpër shkolla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Haskuka.

MYTAHER HASKUKA: Pa e përmendur emrin e askujt, s’di se si u bë replikë kjo! Por, përndryshe po vërehen edhe rezultatet e drejtorive të arsimit nëpër të gjitha komunat.

Komuna e Prishtinës është e vetmja komunë ku ka mësim gjithëditor, ku prindërit mund t’i lënë fëmijët e tyre gjatë gjithë ditës dhe në fund të ditës t’i marrin ata nga shkolla. Po, në përgjithësi, edhe përzgjedhja e mësimdhënësve, edhe përzgjedhja e drejtorëve, siç thashë, është proces publik i hapur, gjë që nuk ndodh në shumicën e komunave të Kosovës. Duhet marrë shembull këtë, e jo për ta kritikuar. Njësoj është edhe me përzgjedhjen e nxënësve dhe fëmijëve nëpër shkolla apo çerdhe, ku të gjitha shkojnë nëpërmjet kriterëve të caktuar dhe askush nuk mund të dalë jashtë kriterëve për ta futur djalin ose vajzën “pak me të njohur”, domethënë nuk ka “me të njohur” në komunën e Prishtinës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë u inspirova nga parafolësit, veçanërisht nga kolegët e PDK-së, për t’i thënë një dy-tri fjalë.

Jo se s’ka ligj dhe s’ka pasur ligj deri më tash, por faktikisht dal te ajo që e thashë në fillim të kësaj seance, se ka munguar llogaridhënia për të qenë të përgjegjshëm, domethënë në pozicionet dhe detyrat që janë të caktuar njerëz të caktuar.

Disa nga kolegët e PDK-së, veçanërisht ma krijuan përshtypjen e “meleqeve” edhe “të gJORËT”, si të mos ishin deri më tash në pushtet. Unë vetëm pse jam i drejtpërdrejtë, jam konkret, edhe prandaj për shumëkënd jam i keq. Inspektorati në shumicën e rasteve e ka kryer punën. Unë do ta përmend një rast shumë konkret në komunën prej nga vij. Inspektorati para dy vjetësh e ka çuar në Prokurori lëndën e një personi të caktuar, që ka pasur pozicione menaxhuese në arsim. Kryetari i Komunës, jo që nuk e ndëshkon, por e bën drejtor të DKA-së. Këtu është problemi. Pra, problemi nuk është te inspektorët, nuk është te ligji, por te zbatuesit e ligjit.

Kështu që unë nuk e shoh shumë problem njerëzit në politikë, se unë shumë pak, për të mos thënë asnjë në Kosovë, është apolitik. Problemi është te njerëzit profesionistë, të përgjegjshëm, llogaridhënës dhe zbatues të ligjit. Pak rëndësi ka i cilës parti është. Në fund të fundit, edhe në

rast se partia e cakton, në raport të barabartë edhe me dikë të partisë tjetër, kjo është normale, por në rast se partia e cakton një person analfabet për të menaxhuar vetëm pse është i partisë, aty është defekti.

Kështu që, zoti ministër, ne natyrisht se do t'i mbështetim ndryshimet e këtij projektligji, por problemi është se po të mund të përcaktoheshin mekanizma monitorues dhe llogaridhënës për moszbatuesit e ligjit, sepse ne jo që s'kemi ligje në Kosovë, por shtrohet problemi se kush t'i zbatojë ato ligje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Ju lus që t'i zini vendet tuaja! Zonja Osmani, ju lus që të vini për votim!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 73 deputetë, 71 janë për, asnjë kundër, 2 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Inspektoratin e arsimit në Republikën e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

A po marrim pauzë, apo dëshironi të vazhdojmë?

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj që në emër të Komisionit Funkcional ta marrë fjalën zoti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Komisija za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju, na osnovu člana 72 Poslovnika Skupštine, na sednici održanoj 19. 7. 2016. godine razmatra

la je godišnji izveštaj rada za 2015-u godinu RAEPK-a i odlučila da skupštini podnese sledeće preporuke:

Usvojiti godišnji izveštaj rada za 2015-u godinu Regulativnog Autoriteta za Elektronsku i Poštansku Komunikaciju za 2015-u sa sledećim preporukama:

1. Vlada Kosova RAEPK i Telekomunikacija Kosova “Vala” treba da preuzmu potrebne mere u cilju za dalje konsolidacije javnog operatora u oblasti proširenja proizvoda i usluga u skladu sa tehnološkim razvojem i promenama u tržišnoj strukturi.

2. RAEPK i Kosovski Autoritet za Konkurenciju trebaju da razmotre strukturu tržišta proizvoda operatora za obezbeđivanje jednake konkurencije i za eliminisanje eventualne nejednakosti u određenim segmentima tržišta, kao što su mobilna telefonija, kablovska televizija i internet.

3. RAEPK da radi na platformi i da obezbedi sprovođenje potrebnih tehničkih i menažerskih mera za merenje standarda kvaliteta usluga operatora prema potrošaču u elektronskoj i poštanskoj komunikaciji.

4. RAEPK u saradnji sa ostalim institucijama treba da preduzme sve potrebne mere za eliminisanje prisustva operatora bez licenca na tržištu Kosova.

5. Zahteva efektivni način sprovođenja postignut sporazum u Briselu o poštanskom kodu Kosova.

Komisija je ocenila da godišnji izveštaj za 2015-u godinu podnesen od RAEPK-a u skladu sa članom 11. Zakona br. 04-L/109 o elektronskoj komunikaciji i preporučuje Skupštini usvajanje sa preporukama. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet, zoti Naser Osmani. Nuk është. Atëherë, zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015 brenda afatit ligjor dhe sipas të dhënave, të cilat i kërkon ligji.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, duke bërë krahasimin edhe me vitin paraprak.

Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike ka marrë mjete për vitin 2015 nga Buxheti i Kosovës prej 663 783 euro. Buxheti nuk është ndryshuar me rishikimin e buxhetit, kurse buxheti përfundimtar është 648 862 euro. Nga kjo shumë janë shpenzuar 617 944 euro, apo 95, 23%.

Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike ka realizuar të hyra në shumën prej 19 278 967 euro nga 4 030 mijë euro, sa kanë qenë të planifikuara, të cilat mjete janë depozituar sipas ligjit në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Të hyrat më të larta janë realizuar si rezultat i autorizimeve për brezat e rinj frekuencorë për dy operatorët e telefonisë mobile, Postë-Telekomi i Kosovës dhe IPKO.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë:

- paga dhe mëditje janë realizuar 100%;
- mallra dhe shërbime 86% dhe
- shpenzime komunale 98,81%.

Në bazë të analizës së raportit financiar shohim se kjo organizatë buxhetore e ka realizuar buxhetin sipas planifikimeve të cilat janë bërë, pasi shpenzimi i buxhetit është 95,23%. Një realizim i mirë vërehet edhe në të gjitha kategoritë ekonomike.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 1.8.2016, pasi e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015 vlerësoi se raporti përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për të gjithë ju, kolegë deputetë dhe deputete!
Ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje raportin vjetor të punës për vitin 2015 të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Raporti ofron informata të detajuara. Bazuar në atë që thuhet në raportin e vitit 2015 shihet se ka pasur mjaft vështirësi në telefoninë fikse dhe mobile për shkak të teknologjisë së avancuar.

Në këtë rast, Qeveria dhe Kuvendi duhet të kenë përgjegjësi në politikat e zhvillimit të operatorit publik, siç është rasti me PTK-në, pasi kjo është ndërmarrje publike, ashtu që t'i rrisë shërbimet publike të tjera, të internetit, siç janë shërbimet kabllorë. Veç tjerash, në raport përmenden edhe 46 rastet e ankesave të qytetarëve - konsumatorëve ndaj operatorëve. Disa ankesa janë të shqyrtuara, disa operatorë edhe kanë marrë ndëshkime.

Ajo që vlen të theksohet se këtij raporti të punës i është bashkëngjitur edhe raporti i auditimit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet rekomandimet, si në vijim:

1. Qeveria e Kosovës ARKEP dhe Telekomunikime të Kosovës “Vala” duhet t'i ndërmarrin masat e nevojshme për konsolidimin e mëtejshëm të operatorit publik në fushën e zgjerimit të produkteve dhe shërbimeve në harmoni me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në strukturën e tregut.

2. ARKEP-i dhe Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës duhet ta shqyrtojnë strukturën e tregut dhe të produkteve tek operatorët për të siguruar konkurrencë të barabartë dhe për t'i evituar pabarazitë eventuale në segmente të caktuara të tregut të ndërlidhur, siç është telefonia mobile, televizion kabllor dhe internet.

3. ARKEP-i të punojë një platformë dhe të sigurojë zbatimin e masave të nevojshme teknike dhe menaxheriale për matjen e standardeve të cilësisë së shërbimeve të operatorëve ndaj konsumatorëve me komunikimet elektronike e postare.

ARKEP-i, në bashkëpunim me institucionet tjera duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për evitimin e pranisë së operatorëve pa licencë në tregun e Kosovës dhe në fund të kërkohet në mënyrë efektive zbatimi i marrëveshjes së arritur në Bruksel lidhur me kodin telefonik të Kosovës.

Edhe një herë po e përsëris, si grup parlamentar e mbështetim këtë raport. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Blerim Grainca.

BLERIM GRAINCA: Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin dhe mendimi i grupit parlamentar është se ky raport është i strukturuar mirë. Përmbajtja e tij është konform autorizimeve dhe kompetencave që ka ARKEP-i, i cili kryesisht aktivitetin e vet e ka zhvilluar në fushën e rregullimit të tregut të komunikimeve elektronike në Kosovë.

Mendojmë se ARKEP-i, përkatësisht institucioni i ARKEP-it e ka kryer mirë punën e tij gjatë vitit 2015, megjithatë kemi dy sugjerime dhe rekomandime, veçanërisht me fushën që ka të bëjë me liberalizimin e tregut dhe instalimin e një fryme më të mirë të konkurrencës së lirë dhe përmirësimit të shërbimeve të operatorëve ndaj qytetarëve, për arsye se e kemi një numër të madh të ankesave, që lidhen me shërbimet ditore, që ofrojnë operatorët në këto fusha.

Me këtë rast, Grupi Parlamentar i LDK-së voton për dhe ju rekomandojmë që ta votojmë si raport.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, fjalën e ka Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Lidhur me materialin që po diskutojmë kam disa vërejtje kryesore, që dalin nga ky raport.

Dua të them që nuk ka mbaruar procesi i matjes së tregut të telefonisë mobile, diçka që e ka disfavorizuar operatorin publik. Interaksioni ndërmjet operatorëve në fushën e telefonisë, veçanërisht asaj mobile, nuk është i mirë. Për shembull, nuk ka interaksion ndërmjet operatorëve mobilë në shërbimin e SMS-ve, te numeracioni i telefonisë fikse ka shpërputhje. IPKO instalon numeracion të Prishtinës në secilin qytet tjetër të Kosovës, gjë që gjithashtu nuk është në rregull.

Matja e tregut të telefonisë mobile tregon angazhim bindshëm më të madh në fushën e komunikimeve elektronike, gjë nuk është bërë ende, rrjedhimisht nuk janë përcaktuar operatorët me ndjeshmëri në treg si bazë për rregullimin e këtij tregu.

Nga kjo do të favorizohet në njëfarë mënyre IPKO, kurse pëson operatori publik. Ky proces ka filluar vetëm në tremujorin e dytë të vitit 2016. Nuk ka imponim të një tarife sociale, diçka që një set i domosdoshëm i shërbimeve për një jetë të dinjitetshme të një familjeje të jetë brenda çmimit të përballueshëm.

Pra, këto janë disa vërejtje. Kam edhe dy çështje të tjera, të cilat duhet t'i shtoj. Ndikimi politik që ka Qeveria e Kosovës që rregullatorët të mos e kryejnë funksionin dhe aspekti i sigurisë për shkak të marrëveshjeve që Qeveria e Kosovës bën në dëm të kësaj sigurie. Përkundër faktit që veprimtaria e Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare duhet të ketë qasje dhe ndikim në gjithë vendin, nuk e ka të shtrirë autoritetin në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, as në fushën e komunikimeve elektronike, as në fushën e shërbimit postar.

Deklaratat pompoze të Qeverisë për futjen e veriut nën autoritetin e Republikës së Kosovës po na dalin edhe në rastin e komunikimeve elektronike dhe postare si një flluskë e madhe, por e zbrazët në përmbajtjen e saj. Nuk e di se çfarë sovraniteti dhe integriteti i vendit është siguruar, kur posta e Serbisë kalon nëpërmes Prishtinës për të shkëmbyer postën ndërmjet Graçanicës dhe Bardhoshit, dikur Devet Jugoviq, dhe kur në Kosovë veprojnë pa pengesa Telekom i Serbisë, Telenor, Mob-Tel dhe VIP.

Ajo që dihet dhe që thotë edhe raporti, për të cilin ne po diskutojmë, është fakti se në Kosovë janë identifikuar gjithsej 22 stacione transmetuese, të cilat operojnë në mënyrë të paautorizuar në brendi të territorit të Republikës së Kosovës.

17 stacione ndodhen në pjesën veriore të vendit, Mitrovicën Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin-Potok, një në fshatin Drejë, komuna e Istogut, ndërsa 5 stacione janë instaluar në objektet e kulte fetare, në lokacionet, respektivisht hapësirat e brendshme të Manastirit të Deçanit, Manastirit të Hoçës së Madhe, Manastirin e Devičit, Patrikanën e Pejës dhe Manastirin e Graçanicës.

Atëherë, shtrohet pyetja, si ta kryejë rregullatori punën e vet, kur nuk ka fare qasje?

Qeveria e Kosovës, në vend që sot të krijonte mundësinë që Autoriteti Rregullator ta kryejë punën e tij, ajo e bën të kundërtën dhe i legalizon mekanizmat e shtetit të Serbisë në Kosovë nëpërmjet marrëveshjes së datës 25 gusht 2015 të kryeministrit Mustafa në Bruksel, nëpërmjet së cilës Serbisë i lejohej që në fushën e telekomunikacionit të veprojë në Kosovë. Pra, edhe në këtë fushë po ndiqet logjika e njohur qeveritare në raport me veriun dhe Serbinë. Legalizo krimin, legalizo parregullsinë dhe thuaj “e zgjidha problemin” dhe deri dje diçka që ishte kundër normave, tani me një nënshkrim dhe papritur kthehet në normë dhe bëhet legale.

Unë tani nuk po dua të flas edhe për dëmet ekonomike dhe përmasat e tyre, sepse ato janë shumë të mëdha, por kam parasysh edhe aspektin e sigurisë. Vallë, çfarë do të thotë për sigurinë e Kosovës, kur brenda saj, brenda territorit të saj veprojnë operatorë, të cilët qasjen në informacionet e vendit tonë e kanë të lehtë, por që qendrën e kanë në Beograd? Kjo shtrirje, përveç aspektit ekonomik, përveç shkeljes së sovranitetit të Republikës së Kosovës, është arritja më e madhe e sigurimit sekret të shtetit serb për t'i vjelë informacionet e nevojshme për të në Republikën e Kosovës.

Nuk po flasim për një shtet mik, nuk po flasim për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk po flasim për Bashkimin Evropian, por po flasim për një vend i cili na konsideron si vend armik, për një vend që nuk e njeh sovranitetin e vendit tonë, për një vend që Kosovën e konsideron me rregullim kushtetues si pjesë të Serbisë, për një vend që nuk dëshiron të na i shohë as tabelat e makinave, as pasaportat, ndërsa Isa Mustafa i lejon fushëveprim të plotë. Ndoshta Isa Mustafa, kryeministër i Kosovës, nuk ka çka i fsheh Serbisë, sepse si duket kurrë në jetën e tij nuk i ka fshehur asgjë, por shteti i Kosovës ka mjaft çfarë duhet të fshehë karshi një vendi, i cili vendin tonë e konsideron si vend armik.

Unë e falënderoj Autoritetin Rregullator për raportin e bërë. Nuk them se mund të krenohen me punën që është bërë, por them që ky raport tregon mjaft shumë për punën që nuk është bërë dhe kjo është një bazë e mjaftueshme për të shikuar se ku jemi dhe çfarë duhet të bëjmë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar në detaje këtë raport dhe ajo çfarë kemi vërejtur është se nuk përputhet me realitetin në hapësirën apo fushëveprimin e gjithë asaj që është shkruar, sepse ka mjaft defekte dhe nuk është paraqitur realisht gjendja në Kosovë.

Ne e dimë edhe gjithë atë fushëveprimin që e bëjnë në mënyrë ilegale dhe këtu nuk precizohet pse është bërë kjo, pse nuk ka kontroll në shumë pika. Prandaj, ne si grup jemi detyruar që të mos e përkrahim këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Hvala!

Parlamentarna Grupa “6+” je razmatrala godišnji izveštaj i ona će podržati isti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar “Nisma” e ka trajtuar me vëmendje raportin e ARKEP-it dhe kemi konstatuar se disa çështje vetëm janë bartur nga raporti i vitit të kaluar, siç po shihet qartë që nuk ka mundur të shtrihet dhe të bëhet parandalimi i operatorëve jo të licencuar. Po ashtu, këtu hasim edhe në çështje të tjera, se nuk po sigurohet një konkurrencë e lirë, ose për më tepër operatorë. Për më tepër, ka edhe avancime, siç është rasti i IPKO-s.

Të gjitha këto na dëshmojnë edhe një herë se në sferën e tillë ka qasje dhe ndërhyrje të politikës dhe parapolitikës, prandaj ne nuk do ta përkrahim si të tillë, sepse ARKEP-i dhe institucionet tjera nuk ka mundur t'i realizojnë detyrat e tyre, të cilat duhet dhe i kanë të obliguara për t'i realizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Raif Qelaj e ka fjalën.

RAIF QELAJ: Të nderuar deputetë,

Gjatë shqyrtimit të raportit vjetor të punës për vitin 2015 të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri janë shtruar edhe disa çështje të tjera, të cilat nuk janë futur në rekomandim. Ndër to kanë qenë edhe në pikën 5 të rekomandimeve, ku përmendet kodi telefonik i Kosovës. Në të vërtetë është bërë gabim teknik se është folur për kodin postar të Kosovës, është dashur të jetë kodi telefonik i Kosovës, sepse për këtë ka qenë pjesa më e madhe e debatit dhe pastaj kur janë futur rekomandimet nuk është shikuar me kujdes.

Dy prej çështjeve me rëndësi, që nuk i përfshin raporti, sado që raporti është mjaft vëllimor dhe ka mjaft informata, janë këto:

- rënia e të hyrave të Telekomit të Kosovës përpiqet të paraqitet se është vetëm si pasojë e aplikacioneve pa pagesë nëpërmjet internetit, gjë që nuk është ashtu, janë edhe një sërë faktorësh të tjerë që kanë ndikuar në rënien e të hyrave në Telekomin e Kosovës;

- ARKEP-i nuk e përmend faktin se është vonuar në dhënien e frekuencave shtesë për 1 800 megaherc për dy operatorët e licencuar në Kosovë, si pasojë e së cilës qytetarët e Kosovës janë dëmtuar, sepse nja nëntë muaj më herët kanë pasur mundësi që t'i shijojnë të gjitha mundësitë që ofron interneti i shpejtë që jepet nëpërmjet telefonisë mobile dhe kjo si pasojë e vonës nga ARKEP-i. Kjo nuk figuron askund në raport dhe këtë desha ta ndaja me ju si informacion.

Pra, ka edhe mungesë informacionesh aty-këtu, por marrë në përgjithësi informacionet janë të bollshme në këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit!

Meqenëse, po e diskutojmë raportin vjetor të punës së ARKEP-it, pra agjencisë që merret me rregullimin e tregut të telekomunikimit, është e domosdoshme që të flitet për një marrëveshje të vitit 2015, pra për këtë periudhë që ky raport pretendon ta mbulojë, në të cilën ARKEP-i ka qenë i përfshirë dhe e cila është jashtëzakonisht e dëmshme për Republikën e Kosovës, po për të cilën raporti nuk flet fare.

Po, e pashë këtu në rekomandim të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, që pika 5 po rekomandon që kjo marrëveshje të zbatohet sa i përket kodit të telefonisë, që pretendohet se do t'i jepet Kosovës. Natyrisht se duhet të flasim për këtë kod dhe t'ia qartësojmë opinionit publik se çfarë është e vërteta pra rreth këtij kodi, përkundër mashtrimeve që i ka bërë deri tash Qeveria e Republikës së Kosovës në deklaratimet e veta publike.

Pra, sipas marrëveshjes së 25 gushtit, kushdo që e ka lexuar e ka parë që aty kodi telefonik, që quhet shtetëror 3+3 do, t'i jepet Kosovës sipas një marrëveshje, në të cilën thuhet që aplikimin do ta bëjë Austria për këtë kod, ndërkohë që aplikimi bëhet kështu, po e lexoj tekstualisht: “në emër të Serbisë dhe të Kosovës...”, pra kërkohet që Unioni Ndërkombëtar i Komunikimeve ta

fillojë procesin e alokimit të kodit thirrës treshifror për Kosovën. Ndërsa, sa i takon vënies në përdorim, pra botimit në buletin të ITU-së, thuhet se teksti i buletinit të ITU-së me pajtimin e Administratës së Republikës së Serbisë dhe drejtori i TSB-së ia cakton Kosovës kodet ndërkombëtare, si në vijim.

Po ashtu, sipas marrëveshjes, Qeveria e Kosovës në kundërshtim me ligjin e urdhëron ARKEP-in që të lejojë brenda territorit të Kosovës operimin e një kompanie të re, që do të regjistrohet deri në hapjen e tenderit ndërkombëtar për operatorin e radhës. E ky operator, i cili do të licencohet, është Telekom i Serbisë, pra “Telekom Srbija”.

Marrëveshja për telekomunikacion ka kaluar nëpër fshehtësi të mëdha nga Qeveria e tanishme dhe nga ky fakt nënshkruesit e marrëveshjes në emër të Kosovës kanë kaluar nëpër një vështirësi të madhe po ashtu për ta fshehur faktin nga publiku në Kosovë, ndër të tjera edhe për vetë Bashkimin Evropian dhe Administratën e Republikës së Austrisë.

Republika e Kosovës është shtet i pavarur, i njohur nga 111 vende të botës, ose më shumë se gjysma e anëtarësisë së ITU-së. Serbia, jo vetëm që nuk e njeh Republikën e Kosovës, por Kushtetuta e saj konsideron këtë republikë të jetë territor i sovranitetit të Serbisë. Ky fakt e përjashton Serbinë për ta pasur ndonjë rol në caktimin e numrave ndërkombëtarë për shërbime telefonike për Republikën e Kosovës.

Me marrëveshjen me Serbinë, kësaj të fundit i njihet kompetenca në qeverisje në sektorin e telekomunikimit në Kosovë. Posta dhe Telekom i Kosovës është ndarë nga Serbia, siç e dimë, 55 vjet më parë. Tani, për herë të parë pas 55 vjetëve, me nënshkrim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, operatori shtetëror serb kthehet në Kosovë dhe kjo bëhet pjesë për kodin telefonik, për të cilin aplikon Austria me pëlqimin e Kosovës dhe Serbisë.

Te kodet kemi aplikuesin, titullarin ose pronarin dhe shfrytëzuesin. Pra, në këtë rast, nga teksti kuptohet se aplikuesi është Austria, shfrytëzuesi është Kosova, ndërkohë që titullari ose pronari, sipas marrëveshjes, i bie të jetë Serbia.

Operatori i ri në Kosovë do të jetë një operator që është regjistruar në dhjetor të vitit të kaluar dhe që quhet Telefonja mobile e Serbisë. Marrëveshja për telekomunikacionin, fazat e saj si dhe forma e aplikimit për kod kanë qenë jotransparente dhe në kundërshtim me interesin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Në kundërshtim me këtë, duke pranuar rolin e Serbisë në këtë proces, në mënyrë të pashmangshme do të interpretohet nga ana e Serbisë, por edhe nga ana e ITU-s, se e ka pranuar qëndrimin e Serbisë në lidhje me Republikën e Kosovës. Pra, ITU-ja pas kësaj marrëveshjeje, për sa i përket statusit të Kosovës, mendon njëjtë siç mendon edhe Serbia.

Pasojat e përfshirjes së Serbisë në këtë proces shihen në planin e zbatimit, të cilin e ka nënshkruar kryeministri Mustafa për këto kode.

Ky dokument e tregon qartë çmimin e rëndë që Republika e Kosovës ka për të paguar për shkak të autoritetit të dhënë në Serbi për të caktuar kodet. Serbia e përdor një autoritet të tillë që ta

diktojë politikën e telekomunikacionit, funksionet rregullative dhe operacionale në sektorin e telekomunikacionit të Republikës së Kosovës, të tilla siç janë licencimi, tarifat dhe të tjera.

Kjo është një arsye tjetër pse kodet ndërkombëtare duhet të caktohen nga ITU-ja direkt në Republikën e Kosovës dhe jo me ndërmjetësim ose nëpërmjet Serbisë.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Kosova betonohet në një rajon që formalisht gjendet nën sovranitetin e Serbisë, të paktën në sektorin e telekomunikacionit, ngase kodi merret me leje të Serbisë dhe Kosova vetëm do të ketë të drejtën e shfrytëzimit të këtij kodi.

Kuvendi i Kosovës më 6 shtator të vitit 2012 miratoi me shumicë votash Rezolutën Nr. 04-R-07 për zëvendësimin e kodeve aktuale në Kosovë.

Kjo rezolutë u miratua pas argumentimit dhe pranimit nga përfaqësuesit e shumicës dhe të Qeverisë, se kjo është rruga e duhur dhe e volitshme përpara. Në të shprehet qartë detyrimi që e ka pasur dhe ende e ka Qeveria e Kosovës për sa i takon zëvendësimit të kodeve telefonike që përdoren në Kosovë.

Sipas kësaj rezolute të Kuvendit, Qeveria duhet të marrë vendim për zëvendësimin e këtyre kodeve aktuale që i ka Kosova në shfrytëzim, pra +381, plus +386, + 377 me kodin telefonik të Republikës së Shqipërisë +355, dhe në funksion të realizimit të këtij qëllimi brenda një kohe shumë të shkurtër t'i iniciojë negociatat me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Natyrisht, kjo gjë nuk ka ndodhur asnjëherë.

Kanë kaluar pra 4 vjet dhe ende Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i ka hapur as negociatat, as nuk e ka konkretizuar këtë zëvendësim me ndonjë marrëveshje me Republikën e Shqipërisë.

Pyetjeve të deputetëve përgjatë këtyre viteve, ministrat e Qeverisë së kaluar nuk u janë përgjigjur fare.

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës e kishte këtë detyrim, nga i cili nuk mund të shmanget përballë Kuvendit të Republikës, kryeministri Isa Mustafa dhe ministrat e tij vepruan në kundërshtim të plotë me të dhe nënshkruan marrëveshje me kryeministrin e Serbisë, Vuçiq, për çështje të kodeve telefonike.

Megjithatë, marrëveshja, edhe pse është hartuar në dëm të Kosovës ndërmjet Mustafës dhe Vuçiqit, ende nuk ka hyrë në fuqi dhe as nuk po implementohet. Sigurisht për shkak se Serbia nuk është e interesuar për këtë version, ndërsa as ITU-ja nuk ka kthyer ende përgjigje për aplikimin që autoritetet austriake kanë bërë pranë ITU-s për këtë kod.

Edhe një herë dua të përsëris se mënyra si është arritur marrëveshja, në tekstet përcjellëse të marrëveshjes - anekset e kësaj marrëveshjeje, tregojnë qartë që kodi nuk do të jetë kod shtetëror i Kosovës, por kodi e ka statusin e kodit gjeografik, për të cilin pronar formal do të jetë Serbia, ndërkohë që Serbia obligohet t'ia japë këtë në shfrytëzim Kosovës.

Pra, kjo është e vërteta prapa këtij kodi, ndërkohë atë që e thotë Qeveria e Kosovës është mashtrim për të maskuar këtë dëm të madh që ia kanë shkaktuar fushës së telekomunikimit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Dërguti.

AIDA DËRGUTI: Të nderuar deputetë!

Më 8 shkurt të këtij vit i jam drejtuar me letër ITU-së që ka të bëjë me kodet ndërkombëtare për shërbimet telefonike në Republikën e Kosovës. Prandaj, po e shfrytëzoj rastin që t'ua lexoj edhe juve këtë letër, të dërguar gjatë muajit shkurt.

“I nderuar zoti Sekretar i Përgjithshëm,

Po ju shkruaj me përzemërsi për të sjellë në vëmendjen tuaj shqetësimet lidhur me zgjidhjen e papërfunduar të burimeve ndërkombëtare të numrave për Republikën e Kosovës.

Është bërë e ditur se një proces është duke u zhvilluar për caktimin nga ITU-ja të kodeve ndërkombëtare për shërbime telefonike për vendin tonë.

Ajo çka nuk i është thënë publikut të vendit tonë është fakti se këto do të jenë kode gjeografike që do t'i caktohen Republikës së Serbisë, për të vazhduar të shpërndahen nga Serbia tek ajo çka Serbia konsideron të jetë krahina e saj e Kosovës.

Iniciatorët e këtij procesi kanë kaluar nëpër vështirësi të mëdha për t'i fshehur këto fakte nga publiku, ndër të tjera, duke e përfshirë BE-në dhe administratën austriake.

Nga ajo që është bërë publike, është e qartë se qëllimi i tyre është edhe ta përdorin ITU-n, duke parashkruar njoftime dhe lajmërimi të ITU-s lidhur me këtë proces.

Shpresoj dhe pres që ITU-ja të refuzojë të jetë pjesë e këtij konspiracioni për ta mashtruar popullin e Republikës së Kosovës dhe të reflektojë të vërtetën e plotë në të gjitha dokumentet dhe njoftimet lidhur me këtë proces.

Republika e Kosovës është vend i pavarur, i njohur nga 111 ende të botës apo më shumë se gjysma e anëtarësisë së ITU-s.

Serbia jo vetëm që nuk e njeh, por Kushtetuta e saj e konsideron Republikën e Kosovës të jetë territor i saj.

Ky fakt i vetëm e përjashton Serbinë për të pasur ndonjë rol në shpërndarjen e numrave ndërkombëtarë për shërbime telefonike për Republikën e Kosovës.

Duke e pranuar rolin e Serbisë në këtë proces, në mënyrë të pashmangshme do të interpretohet se ITU-ja pranon qëndrimin e Serbisë lidhur me Republikën e Kosovës.

Ne besojmë se nuk është në asnjë mënyrë qëllimi i ITU-s dhe për këtë arsye ITU-ja duhet të caktojë kodet ndërkombëtare drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Pasojat e përfshirjes së Serbisë në këtë proces mund të shihen më së miri në planin e zbatimit për këto kode.

Ky dokument tregon qartë çmimin e lartë që Republika e Kosovës duhet të paguajë për shkak të autoritetit dhënë Serbisë për të shpërndarë kodet e caktuara nga ITU-ja.

Serbia përdor një autoritet të tillë për të diktuar politikën e telekomunikacionit, funksionet rregullative dhe operacionale në sektorin e telekomunikacionit të Republikës së Kosovës, siç janë licencimi, numrat, interkoneksioni, tarifat, e tjerë. Kjo është një tjetër arsye pse kodet ndërkombëtare duhet të caktohen nga ITU-ja drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe jo në Serbi.

Nëse ka qëllim të vërtetë për të zgjidhur çështjen e kodeve të vendit, atëherë kjo nuk duhet të paraqesë problem, por nëse Serbia ka një agjendë tjetër, siç është minimi i sovranitetit të vendit fqinj, atëherë ne shpresojmë dhe presim që ITU-ja do të refuzojë të jetë pjesë e saj.

Në dokumentet e bëra publike deri tani është propozuar emërimi antikushtetues për vendin tonë në të gjitha dokumentet e ITU-s dhe njoftimet lidhur me këtë proces.

Ne shpresojmë dhe presim që ITU-ja nuk do të pranojë një propozim të tillë, sepse kjo do të thotë pranim nga ITU-ja i qëndrimit të Serbisë lidhur me Republikën e Kosovës.

Për shkak të gjitha të lartpërmendurave, ekziston një kundërshtim i fortë publik për qasjen e marrë për caktimin e burimeve ndërkombëtare numerike për vendin tonë, e shprehur ndër të tjera në një peticion të nënshkruar nga më shumë se 200 mijë qytetarë.

Në emër të tyre dhe në emër të 30 anëtarëve të Parlamentit, unë me përzemërsi po i sjell këto shqetësime në vëmendjen tuaj, me shpresën se ITU-ja do t'i marrë ato në konsideratë”.

Faleminderit për kohën dhe mirëkuptimin tuaj!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Regjia, ju lutem, t'i bini ziles për t'i ftuar deputetët!

Aktualisht kemi kuorum të mjaftueshëm. Në sallë janë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të vazhdojmë votimin e raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015, me rekomandimet e Komisionit Funksional, dhe votojmë tani:

Kanë votuar 69 deputetë! A ka ndokush që është pa kartelë? Janë 2 vota pa kartelë, që bëhen 71 vota. Do të thotë, janë 52 vota për, 15 vota kundër dhe 4 abstenime.

Pra, konstatoj se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015.

7. Emërimi i një anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Kuvendit i ka rekomanduar për emërimin njërin nga kandidatët e propozuar.

Lidhur me këtë ia jep fjalën kryetares së Komisionit Funkcional, zonjës Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2016, shqyrtoi propozimet e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, zotit Fejzullah Hasani, për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Për këtë pozitë Gjykata Supreme i ka propozuar dy emra, zoti Abdullah Aliu, ligjërues në Fakultetin Juridik të Universitetit "Hasan Prishtina", me përvojë akademike dhe zonjën Drita Rexha, gjyqtare në Gjykatën Themelore të Prishtinës, me përvojë nga praktika gjyqësore.

Komisioni, pasi shqyrtoi propozimet, vendosi që zoti Abdullah Aliu të emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.

Propozimi për emërimin e Abdullah Aliut anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore është në pajtim me nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

Prandaj, duke marrë parasysh bazën ligjore të propozuesit, kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe obligimin e Kuvendit për emërimin e anëtarit të Komisionit të theksuar, i rekomandojmë Kuvendit të emërojë anëtarin, kandidatin e propozuar, zotin Abdullah Aliu.

Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore është një vit dhe fillon nga data 24 tetor 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga grupet parlamentare dhe deputetët nuk është paraqitur askush.

Atëherë shkojmë drejtpërdrejt në votim. Vazhdojmë me votimin e rekomandimit të Komisionit Funkcional për emërimin e zotit Abdullah Aliu anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

Në sallë janë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Kanë votuar vetëm 53 deputetë. Nuk mjafton, duhet të votojnë 61 deputetë.

A ta përsërisim votimin edhe një herë? Faleminderit!

Pra, e përsërisim edhe një herë votimin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten edhe një herë për votim, sepse si duket elektronika s'ka funksionuar, votojmë tani:

Atëherë, sipas tabelës sime të votimit nuk kalon, sepse nuk kemi vota të mjaftueshme të deputetëve.

Do të thotë kanë votuar 57 deputetë. 56 janë për, por duhet të jenë 61.

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2016 ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtar të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e mandateve për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie.

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtar të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Ftoj kryetarin e Grupin Parlamentar të PDK-së që të propozojë një deputet për kryetar të Komisionit dhe një deputet për anëtar të Komisionit.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e propozon zonjën Xhevahire Izmaqu dhe zonjën Selviqe Halimi dhe zonja Halimi të jetë kryetare, ndërsa zonja Xhevahire Izmaqu anëtare.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka paraqitur dy kandidatët e saj, Sadri Feratin dhe Agim Kikajn.

Radha është e Grupit Parlamentar Vetëvendosje që të paraqesë propozimin për kandidatin e vet. Urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e propozon deputeten Shqipe Pantina.

Dhe një çështje tjetër, nëse më lejohet, nuk e di se sa herë kemi komisione ad hoc, kryetarin e merr Partia Demokratike. Rregullorja e Kuvendit nuk e përcakton ashtu, për shkak se këto janë komisione ad hoc dhe Kuvendi ose Kryesia e Kuvendit vendos se kush e udhëheq këtë komision. Nuk është e drejtë që gjithnjë, kur ka komisione të tilla, të udhëhiqet nga PDK-ja.

KRYESUESI: Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së që ta propozojë një deputet për zëvendëskryetar të parë të Komisionit.

PAL LEKAJ: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon zotin Lahi Brahimaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj Grupin Parlamentar të Listës serbe që ta propozojë një deputet për zëvendëskryetar të dytë të komisionit.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

I Poslanička grupa Srpske liste za člana ad hoc komisije predlaže gospodina Sašu Milosavljevića. Hvala!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+” e propozon deputetin për anëtar të komisionit.

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa “6+” predlaže poslanika Danusha Ademi.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma” ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit!

ENVER HOTI: Grupi Parlamentar “Nisma” e propozon zotin Zafir Berisha!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, procedojmë me votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Kanë votuar 66 deputetë. Për janë 65. Ka abstenuar 1.

Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me nenin 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t’i paraqesë raportin me rekomandime.

9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2016, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën plenare, më 22 shtator 2016 t’i propozojë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. Ftoj kryetarët dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtar të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së që ta propozojë një deputet për kryetar të komisionit dhe një deputet për anëtar të komisionit.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i PDK-së propozon të njëjtën përbërje që të punojë edhe në këtë grup ad hoc për Radiotelevizionin e Kosovës. Pra, zonja Selvije Halimi dhe zonja Xhevahire Izmaqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka propozuar zotin Salih Morina dhe Doruntina Maloku-Kastrati.

Ftoj Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes” që ta propozojë një deputet për zëvendëskryetar të parë të Komisionit.

BESA BAFTIJA: Radiotelevizioni i Kosovës, apo siç po i referohen edhe qytetarët tani, “Radiotelevizioni i Kadrisë” tash është me probleme të mëdha dhe zgjedhja apo ndërrimi i dy anëtarëve të Bordit nuk e zgjedh situatën atje, prandaj Lëvizja “Vetëvendosje” propozon që të shkarkohet i gjithë Bordi, bashkë me menaxhmentin, e pastaj të ulemi dhe të gjejmë një zgjidhje se si ta kthejmë në normalitet këtë institucion.

Prandaj, Lëvizja Vetëvendosje bojkoton Komisionin ad hoc dhe nuk dëshiron të marrë pjesë në çfarëdo lloj pazarllëku që mund të bëhet atje për Bordin e RTK-së.

KRYESUESI: Është dëshirë juaja, por për ta përmirësuar gjendjen mund të kontribuoni duke qenë brenda, e jo duke qenë jashtë.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

PAL LEKAJ: Ne e propozojmë të njëjtin deputet, Lahi Brahimaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj Grupin Parlamentar të Listës serbe që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Srpske liste predlaže poslanika Bojana Mitića! Hvala!

KRYESUESI: Ftoj Grupin Parlamentar “6+” që të propozojë një deputet për zëvendëskryetar të dytë të komisionit.

DUDA BALJE: Hvala! Parlamentarna grupa “6+” predlaže gospodina Kujtima Pačaku!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj Grupin Parlamentar të Nismës që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

ENVER HOTI: Grupi ynë i “Nismës” e propozon prapë zotin Zafir Berisha.

KRYESUESI: Zenun, urdhëroni, merreni fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit! Meqenëse duhet të respektohet tash puna e rregullore, të mos i ndryshojmë anëtarët brenda grupit. Pra, Grupi Parlamentar i LDK-së le ta caktojë kryesuesin dhe është në rregull.

KRYESUESI: Zoti Zemaj, e keni fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Pasi u kërkua të krijohet një praktikë e re e përcaktimit me rotacion të kryetarëve, ne e propozojmë Salih Morinën të jetë udhëheqës i këtij grupi (Komisioni) ad-hoc.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, sipas propozimeve të shefave të grupeve parlamentare, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për kryetar të Komisionit caktohet Salih Morina.

Tani shkojmë në votim dhe lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim. Në sallë janë 62 deputetë dhe votojmë tani:

E përsërisim edhe një herë votimin, dhe votojmë tani:

A kemi ndonjë pa kartelë? Janë dy vota, a janë për apo kundër? Atëherë, me elektronikë i kemi 60 vota, 2 pa kartelë. Do të thotë kanë votuar 62 deputetë, 60 janë për, asnjë s'është kundër dhe 2 abstenojnë.

Prandaj, konstatoj se Kuvendi e emëroi Komisionin ad hoc për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc që të përzgjidhen dy anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit dhe të veprojnë në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

E kemi edhe një pikë të rendit të ditës, dhe besojmë shpejt do ta kryejmë.

Lëvizja “Vetëvendosje” nuk e ka anëtarin e vet, sidoqoftë, vendi është i hapur, nëse ata i bien pishman, por nuk është votuar.

10. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka propozuar zonjën Xhevahire Izmake për kryetare të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në vend të kryetarit të deritashëm të këtij komisioni, zotit Zenun Pajaziti.

Grupi Parlamentar i AAK-së e ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare si në vijim:

Deputeti Pal Lekaj propozohet anëtar i Komisionit për Punë të Jashtme.

Deputeti Lahi Brahimaj propozohet anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në vend të deputetit Pal Lekaj.

Deputeti Ali Berisha propozohet anëtar i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Time Kadrijaj propozohet anëtare në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Deputeti Pal Lekaj propozohet anëtar i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Deputeti Rustem Berisha propozohet anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Industri, në vend të deputetit Pal Lekaj.

Deputeti Ali Berisha propozohet anëtar i Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në vend të deputetit Rustem Berisha.

Edhe LDK-ja e ka propozimin e vet:

Duke u mbështetur në nenin 63 të Rregullores së punës të Kuvendit lidhur me emërimet e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve parlamentare, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në mbështetje të autorizimeve dhe kompetencave të veta, më 22. 9. 2016 propozon deputeten Kimete Bytyqi, anëtare të Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, deputetin Agim Kikaj në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie.

Atëherë konsideroj se propozimet janë miratuar. Votimi është formal.

Faleminderit dhe mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*